

DITURIA ISLAME

KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE



VAKËFI Prishtinë, 8-9 dhjetor 2025
TE SHQIPTARËT

histori – trashëgimi – perspektivë



“VAKËFI TE SHQIPTARËT – HISTORI –
TRASHËGIMI – PERSPEKTIVË”

MËSIMET DHE DOBI NGA LEXIMI I
NDODHISË SË ISRASË DHE MIRAXHIT

MANIPULIMI INFORMATIV SI
NXITËS I KONFLIKTIT SHOQËROR

“VAKËFI TE SHQIPTARËT – HISTORI – TRASHËGIMI – PERSPEKTIVË”



EDITORIALI

- 4 Israja dhe Miraxhi një test ripërtëritës i imanit

FETARE

- 5 Vakëfi – amaneti dhe tradita jonë që jeton dhe frymëzon
Kumtesa e Myftiut, Naim ef. Tërnavë
- 10 Dallimet ndërmjet dijetarëve – mëshirë e umetit, jo arsye për përçarje
Rushit Musallari
- 15 Ç'është akaidi dhe përse ta studiojmë atë?
Shejh Hasan el Hindi
- 20 Përgatitja për Ditën e Kiametit
Muhamed Atiye
- 24 Islami dhe moderniteti – pikëprerjet, kundërshtitë dhe sfidat e reja epistemologjike
Vladimir Kera
- 27 Kontratat juridike që përmbajnë kushte të palejuara në Islam
Bashkim Aliu
- 31 Mësime dhe dobi nga leximi i ndodhisë së Israsë dhe Miraxhit
Muhamed B. Sytari
- 36 Vlera e Natës së Beratit dhe mesazhet e saj
Ajet Aliu

FAMILJA DHE EDUKIMI

- 40 Gruaja mes joshjes për ekspozim dhe ftesës hyjnore



Zamira Bushati – Puka

- 44 Familja myslimane përballë modernizimit dhe sfidave të kohës
Mimoza Sinani
- 48 Rritje e krizave sociale në kohën e zhvillimit global - konteksti socio-historik
Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi
- 53 Manipulimi informativ si nxitës i konfliktit shoqëror
Enis Reçica

HISTORI DHE CIVILIZIM

- 56 Zbulimet e myslimanëve që ndryshuan botën
Nehat Shehu

REPORTAZH

- 60 "Vakëfi te shqiptarët – histori – trashëgimi – perspektivë"
- 63 40-vjet nga botimi i përkthimit të plotë të Kuranit në shqip – kujtesë, mirënjohje, reflektim
Ramadan Shkodra
- 66 "Kujtesa në fotografi – xhamitë e shkatërruara në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë gjatë viteve '90 – sakralocid i planifikuar"

AKTIVITETE

- 69 Myftiu Tërnavë mori pjesë në Konferencën e Tretë Botërore të Këshillit të Emirateve për Fetvanë Sheriatike



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 422 • viti 39 • Janar 2026
• Rexheb 1447
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Printing Press", Prishtinë



Israja dhe Miraxhi një test ripërtëritës i imanit

“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e barti-lëvizi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabesë) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejt el Makdis), rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëjmë këtë udhëtim) për t’ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Ai me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.”

(El Isra, 1)

Të gjitha ngjarjet në jetën e Muhamedit a.s. mbesin rezistente ndaj pluhurit historik. Ato refuzojnë të mbesin nën hijen e harresës njerëzore, dhe sigurisht që secila prej tyre ka ndikim të thellë në besimin e pasuesve të Islamit. Megjithatë, ajo e Israsë dhe Miraxhit, cilësohen si ndodhitë reale më ekskluzive, që ripërtërisht testojnë imanin e secilit mysliman gjer në Kiamet. Të pa rëndomtat e kësaj ngjarjeje janë të shumta, andaj numri i atyre që mbetën të hamendësuar përballë saj gjatë gjithë historisë kanë qenë rëndom jo të paktë.

Duke qenë se ajo erdhi si një përkrahje e pashembullt “qiellore” për të Dërguarin e Zotit a.s., në kohën kur banorët e tokës kishin ngushtuar litarin në fytnin e tij, ne s’mund ta konsiderojmë këtë ngjarje si krejt të rëndomtë pa u ndalur për meditim rreth efekteve të saj. Ato të dyja (Israja-Miraxhi), nëse veç bëjmë fragmentarizmin e tyre, pasqyrojnë piedestalin më të lartë të nderimit hyjnor, për bartësin e mesazhit të fundit nga qielli për banorët e tokës. Si të tilla, vijojnë, pas një cikli të pareshtur të cjtjeve, mundimeve, vuajtjeve të nduarduarshme e tentativave për likuidim fizik që banorët e tokës po planifikonin për të dashurin e Zotit, Muhamedin a.s.. Megjithatë, në vend të meditimimit në mësimet, urtësitë dhe porosinë e një rrugëtimi fiziko-shpirtëror të Muhamedit a.s. nga Meka në Jerusalem-Mesxhid el Aksa (Israja), e pastaj nga Jerusalemi mbi lartësinë e shtatë qiejve (Miraxh), skeptikët dhe deficitarët e besimit të vërtetë zgjodhën të hedhin dyshime së pari në mundësinë e këtij rrugëtimi, e pastaj në formën dhe mënyrën e tij. Sëshhtë çudi, ngase shikuar më thellë, në testin imanor të kësaj ngjarjeje do të ngelin të përhumur gjithnjë ata, që veprimet e Krijuesit të Plotfuqishëm, i matin dhe i krahasojnë me veprimet e njeriut, si krijesë që ka aftësi dhe kapacitete relative.

Duke qenë ngjarje e përmasave të jashtëzakonshme, madje e ngritur në gradën e mrekullisë për Muhamedin a.s., Allahu në mënyrë ekskluzive rrëfeu ndodhinë dhe vërtetësinë e saj, paçka se për të iu kishte rrëfyer edhe Muhamedi a.s. bashkëkohësve të tij besimtarë, por dhe të tjerëve. Ai, në ajetin e parë të kaptinës së emërtuar me emrin e kësaj ngjarjeje El Isra, iu drejtohet gjithë njerëzve, e veçanërisht besimtarëve duke thënë: *“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e barti-lëvizi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabesë) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejt el Makdis), rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëjmë këtë udhëtim) për t’ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Ai me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.”* (El Isra, 1).

Në formën mahnitëse, tefsirologu bashkëkohor, Muhamed M. Sharavij, vë në pah mjeshtërinë e diskursit kuranor kur rrëfen këtë ngjarje, duke thënë: “Shprehja “Subhane (i pa të meta qoftë Ai)”, vije këtu për të sinjalizuar se ngjarja që do të vijojë së rrëfyeri është e natyrës së të mbinatyrshmes-mrekulli dhe jashtë kapaciteteve mendore dhe fizike të njeriut, andaj kur ta dëgjosh, kujdes se mos po e mohon ose mos po thua: “Si ka mundur të ndodhë ajo?” Ngase Allahu këtu ka bërë diferencën në mes të veprimeve të Tij dhe veprimeve njerëzore. Kështu që, Zoti yt nuk tha: “Ka lëvizur vet Muhamedi”, por tha: “Është bartur ai (nga dikush tjetër).” Pra, ajo nuk ishte vepër e Muhamedit, por ishte veprim i Zotit, andaj mos tento ta matësh me njësitë matëse kohore që matin njerëzit me to, sepse veprimet e Zotit nuk iu nënshtrohen atyre fare...” (Tefsir Esh Sharavij, 6/8310).

Mbase Israja dhe Miraxhi mbesin ndër ngjarjet që në thelb të tyre e fshehin sprovenë e besimit, e cila e ka testuar brezin e parë të besimtarëve – sahabët e Muhamedit a.s., dhe përgjigjja e më besnikut prej tyre, Ebu Bekr es Sidikut, kur është pyetur për këtë ngjarje, gjersa ai ende nuk e kishte dëgjuar vetë nga Muhamedi a.s., ishte: “Nëse ai e ka thënë këtë, atëherë të vërtetën e ka thënë. Unë e besoj për lajmet që i vijnë nga qielli brenda një çasti, a të mos e besoj për këtë?” (El Bidaje ve en Nihaje – Ibën Kethir, 3/108).

Testet e tilla besimore, as nuk kanë filluar e as nuk mbarojnë me Isranë dhe Miraxhin, ndonëse dallojnë në përmasa dhe në kohën e ndodhisë së tyre, por dhe përgjigjet ebubekriane, gjithashtu nuk duhet të mungojnë nga ana e besimdrejtëve asnjëherë për to gjer në Ditën kur do të kthehemi te Zoti ynë.

Mr. Driton Arifi

Fjala e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, në hapjen e Konferencës Shkencore “Vakëfi te shqiptarët, histori – trashëgimi – perspektivë”

Vakëfi – amaneti dhe tradita jonë që jeton dhe frymëzon

Falënderimi i takon Zotit xh.sh., i Cili na bëri të mundur që të jemi së bashku edhe sot në këtë Konferencë Ndërkombëtare, të organizuar nga Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame nën patronatin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës.

Më lejoni që të përshëndes organizatorin, njëherësh drejtorin e IHSHI-së, z. Sabri Bajgora, Këshillin Organizativ dhe të gjithë ata që punuan në përgatitjen e kësaj Konference që të jetë sa më e suksesshme.

I nderuar kryetar i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, z. Ajni Sinani,

Të nderuar anëtarë të Kryesisë, Kuvendit, Këshillave të BI-ve, Të nderuar profesorë të FSI-së dhe të Medresesë,

Të nderuar efendilerë, studiues, mysafirë nga Shqipëria, Maqedonia e Mali i Zi,

Më lejoni që në emër të gjithë ju të përshëndes mysafirët e nderuar, të cilët kanë ardhur nga disa shtete islame, Arabia Saudite, Turqia, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Katari.

Me këtë rast përshëndes:

z. Haled Shahin al Ghanim, zëvendësministër në Ministrinë e Vakëfeve në Katar,

z. Mohamed al Blooshi, drejtor ekzekutiv në Ministrinë e Çështjeve Islame në Emiratet e Bashkuara Arabe,

z. Hajrullah Çelebi, zëvendës drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Vakëfeve në Republikën e Turqisë

z. Fahad al Majhid, zëvendës guvernator i Autoritetit të Vakëfeve në Arabinë Saudite,

I nderuari ambasador i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë z. Fejsal el Hifdhi,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,



Kam kënaqësinë e veçantë të jem sot para jush në këtë Konferencë shkencore, për të diskutuar për vakëfin dhe rolin thelbësor që ai ka luajtur në hapësirat dhe shoqërinë shqiptare. Të flasësh për vakëfin nuk është thjesht të përshkruash një institucion juridik; do të thotë të flasësh për një traditë të gjatë dhe të thellë të popullit tonë, për një amanet të çmuar që na kanë lënë paraardhësit tanë – njerëz

të mirë, bujarë dhe fisnikë – të cilët kanë synuar jo vetëm t'i ruajnë pasuritë materiale, por edhe të krijojnë një ndikim të qëndrueshëm shoqëror dhe shpirtëror. Madje, ky amanet nuk është vetëm një trashëgimi e së kaluarës, por vazhdon të jetojë dhe të frymëzojë edhe në ditët e sotme përmes veprave të reja të lëna vakëf.

Duhet pasur parasysh se, vakëfi nuk është vetëm një strukturë juridike, por një vlerë e lartë shpirtërore dhe një mekanizëm fisnik i organizimit shoqëror, që ka ndihmuar në mbajtjen e balancës dhe solidaritetit brenda komuniteteve dhe popullit shqiptar. Përmes vakëfit, paraardhësit tanë, jo vetëm që siguronin burime për bamirësi, por edhe kultivonin ndjeshmërinë, përgjegjësinë dhe lidhjet e forta shoqërore dhe vëllazërore, të cilat mbeten të vlefshme edhe sot.

Prandaj, me lejoni të shpreh mirënjohjen time organizatorit, Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame në kuadër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, për organizimin dhe mbajtjen e kësaj Konference, e cila ka një rëndësi të veçantë për studimin e vakëfit dhe për thellimin e kuptimit të rolit të tij në shoqërinë shqiptare. Kjo iniciativë, jam i bindur se do të ofrojë një hapësirë të vlefshme për studiuesit e fushave përkatëse që të ndajnë njohuritë, analizat dhe rezultatet e tyre kërkimore, duke pasuruar diskursin shkencor mbi një traditë të thellë dhe me ndikim të vazhdueshëm ndër ne.

Po ashtu, më lejoni që, para se të paraqes disa vlerësime të mia lidhur me vakëfin, rolin dhe rëndësinë e tij, si dhe disa aspekte të veprimtarisë dhe personaliteteve të vakëflënësve të shquar shqiptarë gjatë historisë, të konstatoj se, edhe pse disa dijetarë e gjejnë gjenezën e vakëfit që në kohën e Ibrahimit a.s., historia e tij si institucion i strukturuar nis qartë nga periudha e Pejgamberit të fundit Muhamedit a.s. dhe vazhdon përgjatë shekujve të mëvonshëm, duke u formësuar si në aspektin fetar ashtu edhe në atë juridik.

Vakëfi u mbështet në parimet kuranore dhe në praktikën pejgamberike, e më pas mori përmasa të qarta ligjore në traditën islame klasike, deri në ditët tona, ku ruan rolin e vet, ani pse funksionon në rrethana të ndryshuara historiko-shoqërore. Rëndësia e vakëfit në Islam nuk kufizohet vetëm në anën fetare, por shtrihet edhe në të gjitha aspektet e jetës. Vakëfi, përgjatë shekujve islamë, ka qenë një mjet i fuqishëm për mbështetjen e dijes, kujdesin ndaj të varfërve dhe sigurimin e burimeve për jetesë.

Zoti xh.sh., thotë: “Thuaj: “Me të vërtetë, Zoti im i jep begati të bollshme kujt të dojë nga robërit e Tij dhe ia pakëson kujt të dojë. Ai ua zëvendëson atë që e ndani ju; Ai është Dhuruesi më i mirë.” (Es Sebe, 39).

Vakëfi në kohën e Muhamedit a.s., ishte themeli mbi të cilin u ndërtuan vlerat e solidaritetit shoqëror në Islam. Pejgamberi a.s., i nxiste myslimanët të investonin pasurinë e

tyre në vepra bamirësie, nga të cilat përfitimi vazhdon pa ndërprerje edhe sot.

Një nga shembujt më të spikatur është udhëzimi i tij për sahabiun e nderuar Othman ibën Afanin, Allahu qoftë i kënaqur me të, që të blinte pusin e Ruvms për ta bërë vakëf për myslimanët.

Në atë kohë, vakëfi shprehte shpirtin e thellë të një besimtarit, i cili synonte kënaqësinë e Allahut përmes veprave që mbeten me ndikim të vazhdueshëm te shoqëria islame. Brenda këtij spektri hyn edhe ajeti i 92-të, i kaptinës Ali Imran, në të cilin Allahu xh.sh. thotë:

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.” (Ali Imran, 92).

Ky ajet lidhet ngushtë me konceptin e vakëfit, sepse merr për bazë dorëzimin e vlerës më të dashur në shërbim të së mirës së përhershme. Andaj vakëfi në Islam është një nga format më fisnike të dhurimit bamirës, që pasqyron shpirtin e solidaritetit dhe ndihmës së ndërsjellë në formën më të bukur. Vakëfi përkufizohet si bamirësi dhe vënia e përfitimit të saj në shërbim të një çështjeje të përgjithshme ose private, me qëllim fitimin e shpërblimit të vazhdueshëm prej Allahut të Madhëruar.

Muhamedi a.s. e komentoi këtë parim me hadithin e njohur: “Kur vdes njeriu, pushojnë të gjitha veprat e tij përveç në tri raste: nëse lë një sadaka (të vazhdueshme) të përhershme, nëse lë një dituri që e përdor dikush tjetër, dhe nëse lë një fëmijë të mirë, i cili bën dua për të.”

Dijetarët islamë, duke u bazuar në këtë hadith, e kanë quajtur “sadikanë rrjedhëse” – sadakatul xharije – formën më të bukur dhe më të dobishme të vakëfit në ruajtjen e fesë dhe të thelbit të saj brez pas brezi. Kështu, lënia e vakëfit është një nga sadakatë më të mëdha të vazhdueshme, mirësia e të cilit vazhdon të rrjedhë edhe pas largimit të njeriut nga kjo jetë.

Këto parime i nxitën shokët e Pejgamberit a.s. që të garonin për të dhuruar vakëfe. Tregohet se edhe vetë Pejgamberi a.s., ka vakëfnuar shtatë kopshtet e hurmave në Medinë. Ky model i dhurimit të vazhdueshëm krijoi një kulturë të veçantë të mirësisë, që përfshinte jo vetëm njerëzit, por edhe kafshët, shpezët dhe natyrën.

Në shumë qytete islame, përfshirë edhe ato shqiptare, pranë çezmave vakëfnore shpesh vendoseshin edhe enë uji për kafshët – një dëshmi e qartë se koncepti i solidaritetit dhe bamirësisë përfshinte të gjithë krijesat.

Të nderuar të pranishëm,

Vakëfi ndikoi thellësisht në jetën fetare, morale, ekonomike, arsimore dhe urbane të shoqërive islame. Përmes vakëfit u ndërtuan xhami, medrese, biblioteka, ura, rrugë, hane,



spitale, mejtepe, si dhe struktura të panumërta shërbimesh publike. Ky ndikim u shtri fuqishëm përgjatë shekujve edhe ndër shqiptarët. Thënë shkurt, nuk ekziston asnjë aspekt i jetës së popujve myslimanë, qoftë aspekt fetar, moral, ekonomik, politik apo social, ku vakëfi të mos ketë pasur ndikim të thellë.

Me pranimin e fesë islame, i cili ndodhi për arsye të ndryshme fetare, kulturore, politike dhe shoqërore nga shumica e popullsisë shqiptare që nga fundi i shekullit XIV, shqiptarët u njohën edhe me institucionin e Vakëfit. Ky institucion u shndërrua në një nga mekanizmat më të rëndësishëm të organizimit dhe zhvillimit shoqëror. Përmes tij u mundësua arsimimi, u ndërtuan institucione kulturore dhe fetare, u ngritën ura dhe rrugë, u krijuan tregje dhe strehimore, si dhe sisteme ujitjeje dhe çezma publike, duke ndikuar ndjeshëm në formësimin e historisë urbane të qendrave shqiptare.

Kësisoj, shqiptarët, të frymëzuar nga tradita islame, lanë vakëfe jo vetëm në vendlindjet e tyre, por edhe në qendra të tjera, që nga Stambolli, Damasku, Kajroja e deri në Mekën e shenjtë dhe në Medinën e ndritur, disa prej të cilave ruhen dhe janë të njohura edhe sot e kësaj dite.

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Duke dashur që të mos zgjatet shumë në pjesën historike, pasi për këtë do të kenë mundësi të flasin studiuesit e nderuar me kumtesat e tyre gjatë kësaj Konference, më lejoni që të them edhe dy fjalë se çfarë në të vërtetë është vakëfi nga pikëpamja juridike islame.

Vakëfi përbën një institucion juridik dhe shoqëror, që i takon së drejtës islame (Sheriatit) dhe më gjerë traditës kulturore të botës islame.

Në thelbin e tij, vakëfi paraqet një akt institucionalizimi të bamirësisë, i cili synon të sigurojë vazhdimësinë e dhurimit, të ndihmës dhe të bamirësisë si shprehje e mëshirës, dhembshurisë dhe dashurisë ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Në aspektin praktik, vakëfi nënkupton dhurimin e një pasurie për Allahun xh.sh., çka përfshin heqjen dorë nga pronësia private, me qëllimin që ajo pasuri të përdoret përjetësisht për objektiva fetare, shoqërore ose humanitare.

Si i tillë, vakëfi përfaqëson një nga mënyrat më të larta të shfaqjes së mëshirës dhe humanizmit në Islam.

Qëllimi themelor i themelimit të një vakëfi është fitimi i kënaqësisë së Allahut xh.sh., shpërblimi prej Tij, si dhe arritja e shpëtimit në jetën e përtejme (Ahiret). Ky dimension shpirtëror është përmbledhur shkurtimisht në shprehjen “et tekarrub ilall-llah” – pra, një mënyrë afrimi tek Allahu (mëshira e Tij). Juristët islamë e kanë pranuar këtë parim si një nga kushtet themelore të vlefshmërisë së një vakëfi.

Në traditën juridike islame, dijetarët kanë dhënë përkufizime të ndryshme për vakëfin, të cilat megjithëse dallojnë në formulim, përputhen në thelb. Sipas përkufizimit të përgjithshëm të fikhut, vakëfi është veçimi dhe ndarja e një pasurie nga pronësia e individit për një qëllim të caktuar, në mënyrë që frytet (të ardhurat) e asaj pasurie të përdoren në vazhdimësi për qëllime fetare, shoqërore, arsimore, ekonomike ose bamirëse.

Nga pikëpamja ekonomike, vakëfi duhet të jetë i tillë që esenca e pasurisë të ruhet, ndërsa të ardhurat e saj të shfrytëzohen në mënyrë të vazhdueshme – koncepti i njohur tradicionalisht si sadakatul xharije, pra bamirësi që vazhdon edhe pas jetës së themeluesit.

Me pak fjalë, vakëfi është një akt fetar, juridik dhe shoqëror me funksion afatgjatë, që synon përjetësimin e bamirësisë përmes dhurimit të një pasurie për interes të përgjithshëm. Ai shfaq parimet më të larta morale të Islamit – mëshirën, përkujdesjen dhe solidaritetin, duke i kthyer ato në struktura të qëndrueshme që shërbejnë brez pas brezi.

Të nderuar të pranishëm,

Duke pasur parasysh këtë qëllim dhe të mirat që sjell kjo vepër, shqiptarët, që nga takimi i tyre i parë me fenë islame, u njohën me praktikën e vakëfit dhe gradualisht filluan t'i zbatojnë ato në jetën e përditshme. Kështu, ata mbi baza vakëfi, themeluan një sërë institucionesh fetare, arsimore, kulturore, ekonomike dhe sociale: xhami, medrese, biblioteka, hamame, bezistane (treg i mbuluar – pazar i vjetër), hane, ura, imarete, çezma e të ngjashme.

Të gjitha këto institucione, të financuara nga pasuria e vakëfeve të lëna për këtë qëllim, luajtën një rol të rëndësishëm në përhapjen dhe Islamit dhe në zhvillimin e kulturës dhe qytetërimit islam në trevat tona.

Vakëfi i parë i dokumentuar ndër shqiptarë është ai i Manastirit, që e vakëfnoi Sungur Çauš Beu, në vitin 1434. Pastaj vakëfi i Is'hak Beut, i themeluar në Shkup në vitin 1444, vakëfi i Suzi Çelebiut në Prizren në vitin 1513, vakëfi Kuklibegut në Prizren në vitin 1538, vakëfi i pesë herë sadriazemit Koxha Sinan Pashës dhe lista vazhdon me vakëfet e personaliteteve dhe familjeve të shquara shqiptare, si Bushatlinjve të Shkodrës, Mahmudbegollëve të Pejës, Kurtpashajve të Gjakovës, Bargjinollëve të Tiranës, Biçaqçinëve të Elbasanit, Derallajve të Tetovës, Ngurzajve të Beratit, Alihajdarbegollëve të Kavajës, Rrotllajve të Prizrenit, Gjinollajve të Prishtinës dhe shumë e shumë të tjerëve që është e pamundur të përmenden të gjithë këtu.

Sikundër që është e pamundur të përmenden dhe të renditen edhe të gjitha llojet e vakëfeve të themeluara në trojet shqiptare, si dhe fushat e shërbimit të tyre, sepse ato përfshijnë të gjitha aspektet e jetës fetare, po ashtu edhe kulturore, sociale dhe humanitare.

Për më tepër, roli i vakëfit ka qenë vendimtar në formimin, ndërtimin dhe zhvillimin e shumë lagjeve, kasabave dhe qyteteve shqiptare. Dhe kur jemi këtu, duhet thënë se në historinë e urbanizimit islam në trevat shqiptare, vakëfi ka qenë një faktor themelor, jo vetëm në aspektin fetar e social, por edhe në procesin e vetëformimit të qendrave urbane. Një numër i konsiderueshëm qytetesh shqiptare u krijuan ose morën formë të plotë si kasaba orientale pikërisht përmes

themelimit të vakëfeve të mëdha, të cilat nxitën zhvillimin ekonomik, social dhe demografik përreth tyre. Kaçaniku, Gjakova, Korça, Tirana, Kavaja, Elbasani, Peqini, Zinova, Rogova etj., u themeluan plotësisht, ose u organizuan në formën përfundimtare të tyre si kasaba orientale pikërisht mbi bazën e vakëfit.

Prandaj, të rralla janë vendbanimet tona, që të mos ketë të paktën një vakëf ose një hajrat. Në vendbanimet urbane, numri i tyre është edhe më i madh, andaj edhe sot, shumë vendbanime mbajnë ende emra vakëfesh, dëshmi e trashëgimisë së vakëflënësve të dikurshëm.

Megjithatë, numri i vakëfeve të mbetura sot është vetëm një pjesë shumë e vogël e atyre që ekzistonin dikur, sepse një pjesë e konsiderueshme e tyre është shkatërruar përgjithmonë si pasojë e faktorëve natyrorë dhe njerëzorë dhe sidomos në shekullin e kaluar, kur shumë vakëfe u shkatërruan, u konfiskuan, u kolonizuan, u nacionalizuan, ose iu ndryshua destinacioni nga ish-sistemi okupues komunist-ateist në vendin tonë. Duhet të theksojmë se nuk ekziston asnjë institucion fetar që të ketë pësuar kaq shumë goditje dhe shkatërrime sa vakëfi. Kjo ka ndodhur për shkak të sistemeve politike, dhe qëndrimeve të tyre ndaj fesë në përgjithësi dhe ndaj Islamit në veçanti.

Vetëm gjatë luftës së fundit në Kosovë (1998–1999) u shkatërruan, u dogjën, ose u dëmtuan 218 xhami, rreth 40% e xhamive ekzistuese në atë kohë në Kosovë, pa përmendur këtu edhe shkatërrimin e trashëgimisë tjetër islame me vlera të çmuara historike dhe kulturore, biblioteka, arkiva, dorëshkrime etj..

Në Shqipëri, pas vitit 1967, regjimi komunist shkatërroi qindra objekte fetare, përfshirë xhami monumentale. Edhe në Maqedoni u shkatërruan dhjetëra xhami gjatë regjimit komunist dhe luftës së vitit 2001 (ku u shkatërruan 56 xhami të rrënuara).

Në këtë drejtim, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka angazhuar të gjitha forcat e veta për të bërë një rivlerësim të plotë, për të riaktualizuar dhe për të rikthyer rolin e vakëfit në jetën fetare, kulturore dhe shoqërore të vendit.

Organizimi dhe mbajtja e kësaj Konference janë pjesë e kësaj përpjekjeje, duke ofruar një hap konkret për të diskutuar dhe reflektuar mbi rëndësinë e këtij institucioni.

Për ta rikthyer rolin e vakëfit, kemi gjetur mbështetje të vërtetë nga besimtarët dhe popullata jonë. Nuk ka munguar as ndihma dhe gatishmëria edhe e institucioneve tona shtetërore, ndonëse jo gjithmonë e mjaftueshme. Një mbështetje e rëndësishme ka ardhur edhe nga miqtë tanë nga disa shtete kryesisht islame, të cilët nuk kursyen kohën, dijen dhe kontributin e tyre material për ta ndihmuar institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës. Ky bashkëpunim dhe solidaritet, brenda dhe jashtë vendit, tregon qartë se vakëfi



nuk është vetëm një institucion historik, por një vlerë, që mund të bashkojë popujt dhe të frymëzojë veprime të mira.

Edhe sot, vakëfi ndihmon në ruajtjen dhe forcimin e traditës së mirësisë dhe përgjegjësisë shoqërore.

Dhe me këtë rast, do të veçoja ndihmën nga disa shtete islame, si: Arabia Saudite, Turqia, Emiratet e Bashkuara Arabe, Katari, Kuvajti dhe nga të gjitha vendet e tjera, që i qëndruan Kosovës pranë në ditët më të errëta të historisë sonë, në kohën e luftës së fundit, kur shumë vakëfe shekullore u shkatërruan nga kriminelët serbë, vakëfe me vlera të pallogaritshme historike, fetare dhe kulturore.

Andaj, për ndihmën tuaj në ruajtjen, restaurimin dhe ngritjen e vakëfeve të cilat sot qëndrojnë si simbol i qëndrësës së popullit tonë dhe i lidhjes së pathyeshme me botën islame, ju falënderojmë nga zemra dhe ju shprehim mirënjohjen tonë të thellë dhe të përhershme. Ngase miqësia juaj e sinqertë dhe ndihma juaj në momentet kur kombi ynë kishte më së shumti nevojë, është dëshmi e solidaritetit që nuk shuhet nga koha.

Prania juaj sot në këtë Konferencë ndërkombëtare, të organizuar me përkushtim nga Instituti për Hulumtime Islame pranë Bashkësisë Islame të Kosovës, është nder i madh për ne. Ajo përfaqëson jo vetëm respektin e ndërsjellë, por edhe konsolidimin e bashkëpunimit tonë të qëndrueshëm në shërbim të vakëfit, si një institucion i shenjtë, i cili ndër

shekuj ka luajtur rol thelbësor në zhvillimin shoqëror, kulturor, fetar dhe historik të shqiptarëve.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Në përmbyllje të kësaj fjale, edhe njëherë konstatoj se, institucioni i Vakëfit ka qenë dhe mbetet faktor kyç në zhvillimin e jetës islame në trojet shqiptare, duke mbështetur shërbime arsimore, sociale dhe publike, dhe duke ruajtur vlerën e tij edhe sot si një shembull i qëndrueshmërisë, solidaritetit shoqëror dhe bamirësisë, që duhet të studiohet, të vlerësohet dhe të rivitalizohet për brezat e ardhshëm.

Në fund të fjalës sime, ju uroj suksese në punimet e kësaj Konferencë shkencore. Jam i bindur se do të dalim edhe më të begatuar në dije dhe frymëzim shpirtëror, duke forcuar lidhjen tonë me trashëgiminë e vakëfit dhe vlerat që ai përcjell. Prandaj, edhe sot, të bashkuar në këtë tubim të nderuar, shprehim mirënjohjen tonë të thellë dhe zotimin për të forcuar institucionet, për ta mbrojtur trashëgiminë dhe për të ngritur vakëfe që do t'i shërbejnë shoqërisë sonë për brezat e ardhshëm.

Prishtinë, më 8 dhjetor 2025

Myftiu i Kosovës,

Naim ef. Tërnavë

Dallimet ndërmjet dijetarëve – mëshirë e umetit, jo arsye për përçarje

DIVERSITETI SI LIGJ HYJNOR DHE TREGUES I MADHËSHTISË SË ALLAHUT

Rushit Musallari

Diversiteti është ligj hyjnor, është një nga faktet e madhështisë së Allahut dhe një fenomen i natyrshëm në umetin islam. Allahu xh.sh., thotë: *“Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t’i bashkonte në një bashkësi të vetme, por ata vazhdojnë të kenë mospajtime, përveç atyre, që i ka mëshiruar Zoti yt. Për këtë qëllim Ai i krijoi ata.”* (Hud, 117-118). Allahu i ka krijuar njerëzit me aftësi arsyetuese të ndryshme, gjë

që ka si rezultat dallime në perceptim, në ide dhe mendime të ndryshme, gjykime dhe përfundime të ndryshme. Diversiteti në të gjitha këto aspekte manifeston madhësinë e Allahut në përsosmërinë e krijimit të njeriut, që përveç dallueshmërisë dhe larmishmërisë në fizik, racë dhe gjuhë, i ka dalluar njerëzit edhe në kapacitetet intelektuale, për rrjedhojë edhe në frutin e mendimeve dhe ideve të tyre. Diversiteti në mendime dhe dialektika në



Allahu i ka krijuar njerëzit me aftësi arsyetuese të ndryshme, gjë që ka si rezultat dallime në perceptim, në ide dhe mendime të ndryshme, gjykime dhe përfundime të ndryshme.

veprime është ligj hyjnor dhe shoqëror për ndërtimin e jetës në tokë dhe për lulëzimin e saj.

DALLIMET NDËRMJET DIJETARËVE JANË FENOMEN I NATYRSHËM NË UMETIN ISLAM

Mendimi ndryshe, diversiteti dhe dallimet në qasje, kanë qenë dhe janë fenomene më se normale edhe në umetin islam qysh nga koha profetike dhe do të vazhdojnë deri në Ditën e Kiametit. Nëse dallimet ndërmjet dijetarëve nuk i kapërcejnë kufijtë e natyrshmërisë dhe respektohen etiket e diversitetit në mendime, atëherë ky fenomen është pozitiv, përbashkues dhe manifestues i mëshirës së Allahut xh.sh.. Madje dallimet ndërmjet dijetarëve janë gurrë e pashteruar e fikhut islam, e cila manifestohet edhe me larmishmërinë e shkollave juridike islame, ku më kryesore janë katër shkollat tradicionale sunite (hanefi, maliki, shafi dhe hanbeli).

DIVERSITETI NË MENDIME DHE VEPRIME NË KOHËN PROFETIKE DHE TË SAHABËVE

Në epokën profetike hasen disa raste mospajtimesh mes sahabëve, ku më i njohuri është ngjarja mes sahabëve, të cilët ishin nisur drejt fisit Benu Kurejdha dhe ishin urdhëruar nga Pejgamberi a.s., që namazin e ikindisë ta falnin sapo të arrinin tek ai fis. Koha e namazit të ikindisë hyri kur ata ishin rrugës. Kështu, një grup e fali namazin e ikindisë gjatë rrugës, ndërsa grupi tjetër e fali atë, kur arriti te fisi Benu Kurejdha, ndërkohë që koha e ikindisë kishte kaluar. I Dërguari i Allahut a.s. i miratoi veprimet e të dy grupeve.¹

Në epokën e sahabëve zgjerohet më shumë rrethi i diversitetit në mendime. Sahabët kishin konsensus mes tyre, se dispozitat nxirren nga Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Tij. Sahabët jepnin mendimin e tyre dhe bënin ixhtihad për çdo ngjarje, për të cilën nuk kishte tekst shariatik kategorik. Në disa raste, sahabët kishin mendim unanim për ndonjë çështje. Në disa raste të tjera, secili prej sahabëve i përmbahej mendimit të tij dhe çështja mbetej e debatueshme, pasi kishte nevojë për më shumë kërkim, hulumtim, diskutim dhe konsultim.

SHKAQET E DIVERSITETIT MES SAHABËVE

Shkaqet e diversitetit në mendime dhe në veprime të sahabëve janë të shumta, por shkaqet kryesore janë tri:

1- Mospajtimet rreth kuptimit të Kuranit, burimit të parë të argumenteve shariatike. Ky diversitet pasqyrohet në: ixhtihadin e tyre për të harmonizuar dy tekste kuranore që në pamje të parë duken kontradiktore; në rastin kur fjala e përmendur në ajet është përgjithësuese ose shumëkuptimore; në kuptimin literal të një ajetit dhe objektivit për të cilin është zbritur ajeti dhe dispozita e tij; në interpretimet e ndryshme të një teksti të përgjithshëm kuranor, etj..

2- Mospajtimet rreth kuptimit të Sunetit, burimit të dytë të argumenteve shariatike. Ky diversitet pasqyrohet në: mospasjen informacion për një hadith të caktuar; në kriteret rigoroze të pranimit të një hadithi; në zbatimin e një hadithi të anuluar; në ndryshimin e kushteve të jetesës; në përcaktimin e dispozitave që burojnë nga urdhëresat, ndalesat, miratimet dhe mosveprimet e Pejgamberit a.s., etj..

3- Mospajtimet për shkak të ixhtihadit të tyre. Pejgamberi a.s. i kishte mësuar sahabët r.a. të bëjnë ixhtihad. Ai a.s. i ka trajnuar ata në praktikë dhe i ka nxitur që të bëjnë ixhtihad, madje edhe në prezencë të tij. Pejgamberi a.s. ka vendosur një metodologji unike në nxitjen për të bërë ixhtihad, por për atë që përmbush kriteret e ixhtihadit. Ai a.s. ka thënë: “Kur gjykatësi përpiqet në maksimum dhe gjykon drejt do të shpërblehet dyfish. Kur gjykatësi përpiqet në maksimum dhe gabon në gjykimin që jep, do të marrë vetëm një shpërblim”² Pasi Pejgamberi a.s., ndërroi jetë, sahabët ndoqën metodën e tij në nxjerrjen dhe deduktimin e ligjeve shariatike, duke edukuar dhe trajnuar brezin pasues për të bërë ixhtihad. Ata e kishin të qartë metodologjinë e skicuar dhe të aplikuar nga Pejgamberi a.s.. Metodologjia e sahabëve është e trupëzuar në hadithin e Muadhrit r.a.. Kur i Dërguari i Allahut a.s. e dërgoi Muadhin r.a. në Jemen, e pyeti: “Si do të veprosh, nëse përballësh me një çështje?” Muadhi r.a., i tha: “Do të gjykoj me Librin e Allahut.” I Dërguari i Allahut a.s., e pyeti: “Po nëse nuk e gjen në Librin e Allahut?” Muadhi r.a., i tha: “Do të gjykoj me Sunetin e të Dërguarit të Allahut.” I Dërguari i Allahut a.s., e pyeti: “Po nëse nuk e gjen as në Sunetin e të Dërguarit të Allahut?” Muadhi r.a., i tha: “Do të jap maksimumin, për të dhënë mendimin tim të saktë.” I Dërguari i Allahut a.s. i rrahu gjoksin dhe i tha: “Falënderimi i takon Allahut, i Cili i dha sukses përfaqësuesit të të Dërguarit të Allahut me atë që e kënaq të Dërguarin e Allahut.”³ Janë të shumta rastet kur sahabët kanë bërë ixhtihad dhe për rrjedhojë ka pasur dallime të ndryshme në mendimet që kanë dhënë për çështje të njëjta apo të ndryshme.

DIVERSITETI NË BREZAT VIJUES DHE LINDJA E “TEORISË SË INTERPRETIMIT TË DALLIMEVE JURIDIKE”

Tabiinët ndoqën metodologjinë e sahabëve për të bërë ixhtihad dhe shkaqet e dallimeve mes tyre janë të përafërta me shkaqet e diversitetit mes sahabëve. Në këtë kohë u hodhën bërthamat e para të shkollave juridike, si shkolla e Medinës, e Mekës, e Kufës, e Basrës, etj.. Gjatë kësaj periudhe filluan të shfaqen edhe më qartë disa nga burimet e debatueshme mes myslimanëve, si analogjia e ligjit shariatik (kijasi), interesi i pacilësuar (maslaha), status quo-ja (istis`hab) e gjërave etj.. Në shekullin e dytë dhe të tretë hixhri (VII dhe VIII) shkenca e Fikhut u stabilizua dhe shkollat juridike morën formën e tyre përfundimtare. Kështu, u



përcaktuan parimet, bazat, mënyrat e deduktimit të ligjeve, krahasimet, nxjerrja e ligjeve nga parimet, apo nxjerrja e ligjeve nga çështjet praktike sheriatike dhe, bashkë me to, u kristalizua edhe “Fikhu `l-Ihtilaf – Teoria e interpretimit të dallimeve juridike”, si një shkencë e mirëfilltë e begatë dhe pasuruese e Fikhut islam.

Është e rëndësishme të theksohet se, ashtu siç ka pasur mospajtime mes sahabëve në çështjet dytësore të fesë, po ashtu ka pasur mospajtime edhe mes tabiinëve, dijetarëve dhe juristëve myslimanë. Myslimanët i kanë pranuar mospajtimet e dijetarëve në çështjet e Fikhut, përderisa ato kanë qenë të konsiderueshme. Jo vetëm kaq, por ato janë të mirëpritura, pasi janë porta në të cilat kalohet për të arritur tek e vërteta. Gjithë kjo trashëgimi e fikhut, që buron nga mospajtimet e konsiderueshme të dijetarëve, është dëshmi për shkëlqimin e civilizimit islam, gjë që është e dëshmuar dhe pranuar.

SFERA DHE OBJEKTI I DALLIMEVE NDËRMJET DIJETARËVE

Dijetarët kanë thënë se dispozitat e Sheriatit janë dy llojesh:

1- Dispozita thelbësore, që kuptohen dhe konceptohen nga të gjithë, si: pesë shtyllat e Islamit, gjashtë shtyllat e imanit, ndalimi i alkoolit, ndalimi i imoralitetit, etj.. Këto çështje nuk kanë nevojë për studim të thelluar, pasi të gjithë myslimanët

janë të aftë t'i perceptojnë dhe t'i kuptojnë ato pa ndonjë sforcim apo hulumtim.

2- Dispozita që konceptohen vetëm nëpërmjet metodologjive hulumtuese, siç janë detajet e adhurimeve, marrëdhënieve mes njerëzve etj.. Ky është objekti i hulumtimit dhe mund të ketë mendime të ndryshme mes dijetarëve.

DALLIMET NDËRMJET DIJETARËVE JANË MËSHIRË

Ky pohim është i mirëqenë në mesin e myslimanëve, pasi bazohet në trashëgiminë historike të fikhut islam. Në një transmetim profetik thuhet: “Pozita e sahabëve në umetin tim është si pozita e yjeve në qiell. Këdo që të ndiqni prej tyre, jeni të udhëzuar. Ju duhet ta dini se dallimet që kanë sahabët me njëri-tjetrin janë mëshirë për ju.”⁴

Omer ibën Abdulazizi ka thënë: “Fakti që shokët e Muhamedit a.s. kanë pasur mospajtime, më gëzon më shumë sesa pasuria e të gjithë botës. Nëse zbatojmë mendimin e njërit prej tyre, kemi zbatuar të vërtetën dhe nëse zbatojmë mendimin e tjetrit, përsëri kemi zbatuar të vërtetën.”⁵

Kasim ibën Muhamed ibën Ebu Bekri ka thënë: “Allahu i Madhëruar u ka sjellë dobi njerëzve nëpërmjet mospajtimeve të shokëve të Muhamedit. Kur ndonjë person zbaton një mendim të tyre, gjen në të qetësi dhe rehati, pasi bindet se dikush tjetër më i mirë se ai e ka zbatuar më parë atë

mendim.”⁶ Ai gjithashtu ka thënë: “Dijeni se mospajtimet që kanë pasur sahabët e të Dërguarit të Allahut a.s. janë mëshirë për njerëzit.”⁷

Sufjan Theuri ka thënë: “Në lidhje me çështjet për të cilat dijetarët kanë pasur mospajtime, nuk ndaloj asnjë nga vëllezërit e mi që t'i zbatojë ato.”⁸

Jahja ibën Said Ensariu ka thënë: “Dijetarët që kanë dhënë fetva, kanë pasur gjithmonë mendime të ndryshme. Ndonjëri prej tyre lejonte këtë gjë dhe ndalonte atë gjë. Ai që ndalonte, nuk e shikonte të shkatërruar atë që kishte lejuar tjetri dhe ai që kishte lejuar nuk e shikonte si të shkatërruar atë që tjetri kishte ndaluar.”⁹

Abdulvarith ibën Saidi ka thënë: “Shkova në Meke dhe takova Ebu Hanifen, Ibën Ebi Lejlan dhe Ibën Shubrumen. Iu drejtova Ebu Hanifes: “Çfarë mund të thuash për një person, i cili shet një mall, duke vendosur një kusht?” Ebu Hanife tha: “Shitblerja është e pavlefshme dhe kushti është i pavlefshëm.” Ibën Ebi Lejla tha: “Shitblerja është e vlefshme, ndërsa kushti është i pavlefshëm.” Ibën Shubrume tha: “Shitblerja është e vlefshme dhe kushti është i vlefshëm.” Unë u thashë: “I Lartësuar qoftë Allahu! Ju jeni tre dijetarë nga Iraku dhe keni mendime të ndryshme për të njëjtën çështje!” Më pas Abdulvarithi përmend hadithet, ku secili prej tyre bazohej në dhënien e mendimit të tij.¹⁰

Ibën Tejemije ka thënë: “Selefët debatonin për çështje të ndryshme të diturisë dhe praktikave, por duke ruajtur dashurinë, mbrojtjen e dinjitetit dhe vëllazërinë e fesë. Nëse për çdo çështje të debatueshme myslimanët do t'i kthenin shpinën njërit-tjetrit, nuk do të mbetej mes myslimanëve as dinjitet dhe as vëllazëri.”¹¹

Jo vetëm kaq, por hasim dallime edhe mes një shkolle, siç janë mospajtimet mes imam Ebu Hanifes dhe nxënësve të tij, imam Malikut dhe nxënësve të tij, apo mendimet e ndryshme të një dijetari për të njëjtën çështje, ku thuhet se imam Ahmed ibën Hanbeli ka pasur mbi dhjetë mendime për të njëjtën çështje, apo ndryshim metodologjie për shkak të rrethanave, siç ka vepruar imam Shafiu, i cili ka pasur dy medhhebe; një në Irak dhe një tjetër në Egjipt.

Imamët e fesë nuk kanë qenë fanatikë ndaj idesë së tyre, pasi dashuria, dashamirësia dhe devocioni i bënte ata objektivë në qëndrime. Imam Ebu Hanife ka thënë: “Njeriu më i ditur është ai që i njeh mirë mospajtimet mes dijetarëve. Kur një person i ditur e studion çështjen në të gjitha dimensionet e saj, ka

aftësinë të gjykojë atë që është e drejtë apo e gabuar në këtë çështje.”¹²

Ai ka thënë: “Kjo që themi (fetvaja) është përfundimi më i mirë që kemi arritur. Nëse dikush thotë diçka më të mirë, atëherë le ta ndjekë atë.”¹³

KRITERI LEGJITIMIUES I MOSPAJTIMEVE NDËRMJET DIJETARËVE

Dallimet dhe mendimet ndryshe nuk janë të vlefshme në çështjet madhore dhe aksiomatike të fesë (usul), pasi bëhen shkak për zhbërjen e fesë, ndërsa në sferën e zbatimit të fesë (furu`), dallimet ndërmjet dijetarëve janë më se normale, përderisa nuk bëhen shkak për përçarje, ndasi dhe armiqësi. I Dërguari i Allahut a.s. ka përcaktuar një kriter madhështor për të dalluar rastet kur mospajtimi është shkak për përçarje dhe kur është shkak për bashkim, unitet dhe harmoni. Ai a.s. ka thënë: “Lexojeni Kuranin përderisa ua përbashkon zemrat, nëse bëhet shkak për mospajtime mes jush, atëherë mos e vazhdoni leximin e tij.”¹⁴ Ky hadith është një postulat që përfshin të gjitha fushat e Sheriatit islam. Nëse dallimet mes dijetarëve shfaqen në çështjet e fikhut, hadithit, tefsirit, apo çështjet dytësore të akides, etj., dhe shoqërohen me qetësi të shpirtit, zemrës dhe mendjes, me qëllimin e vetëm, kuptimin e drejtë të teksteve shariatike dhe dobinë për njerëzit, atëherë këto dallime janë të lavdëruara, madje të kërkuara dhe duhet

të zhvillohen vazhdimisht pasi janë gurrë për fikhun islam. Nëse mospajtimet bëhen shkak për ndasi, grindje, prishje të qëllimit të synuar, apo kur mendja errësohet me fanatizma të ndryshme në trajtimin e çështjeve të tilla, atëherë nuk duhet të vazhdohet më në mospajtime të tilla, pasi janë sherr dhe nuk janë të legjitimuara.

DIVERSITETI ËSHTË SHKAK PËR BASHKIM DHE JO URREJTJE


Dijetarët kanë përcaktuar dy rregulla për këtë çështje:

Rregulli i parë: “Nuk ka vend për refuzimin (akuzimin, mospranimin) dhe urrejtjen mes njëri- tjetrit, në çështjet e debatueshme.”¹⁵

Rregulli i dytë: “Kur dijetarët kanë debate për një çështje, vetë çështja nuk lejohet të cilësohet si kufër, devijim apo bidat, ndërsa ai dijetar që ka dhënë fetva për çështjen dhe ai që e pason atë, nuk lejohet të cilësohen si qafirë, të devijuar apo bidatçin.”¹⁶

Dallimet ndërmjet dijetarëve të fikhut nuk kanë qenë dallim mes të vërtetës apo të pavërtetës, por kanë qenë dallime ndërmjet të mirës dhe më të mirës, apo në rastin më

Imamët e fesë nuk kanë qenë fanatikë ndaj idesë së tyre, pasi dashuria, dashamirësia dhe devocioni i bënte ata objektivë në qëndrime. Imam Ebu Hanife ka thënë: “Njeriu më i ditur është ai që i njeh mirë mospajtimet mes dijetarëve.



ekstrem mund të thuhet se kanë qenë dallime ndërmjet të saktës dhe të gabuarës, prandaj nuk ka vend për akuzime dhe etikektime.

Sharani ka thënë: “Sheriati islam është ligj i dëlirë, ligj tolerant, ligj që ka aftësinë e gjithpërfshirjes së mendimeve dhe dallimeve të dijetarëve të këtij umeti. Secili prej tyre, në dijeninë dhe bindjen e tyre, kanë qenë në rrugë të drejtë, ndërsa mospajtimet që kanë pasur, ato janë mëshirë për umetin. Këto dallime burojnë nga urtësia dhe dituria e të Gjithëditurit dhe të Urtit.”¹⁷

Sujuti ka thënë: “Dije se, shumëllojshmëria e medhhebeve (mendimeve) është një mirësi e çmuar, një vlerë shumë e madhe dhe për këtë ka një sekret, të cilin e konceptojnë vetëm të diturit... Dihet se pejgamberët që u dërguan te popujt e mëparshëm kishin vetëm një ligj dhe një gjykim të formës së prerë, madje edhe në çështjet dytësore ata nuk kishin të drejtë përzgjedhjeje, ndryshe nga ligjet tona... Feja jonë ka hapësira dhe kjo gjë vë në pah një nga cilësitë dhe specifikat e të Dërguarit tonë, Muhamedit a.s. ndaj pejgamberëve të tjerë. Të gjithë pejgamberët e tjerë janë dërguar me një ligj fik, ndërsa Muhamedi a.s. është dërguar me të njëjtën fe, por që ka alternativa praktike të ndryshme; të gjitha ato zbatohen, për të gjitha ka shpërblim, si dhe ato janë udhëzuese dhe orientuese.

Duke pasur parasysh ato që u thanë më lart, kemi bindjen se të gjitha medhhebet janë të vërteta, mospajtimet mes tyre ndodhin në suaza të së lejuarës dhe vetëm për të gjetur atë që është më e mira. Mendimet e ndryshme ndërmjet

medhhebeve nuk janë mospajtime mes të vërtetës dhe të pavërtetës.¹⁸

Për sa më sipër, dallimet dhe diversiteti në çështjet dytësore janë të domosdoshme dhe të pashmangshme. Nuk ka dyshim se parimet e Islamit, ajetet, hadithet dhe praktikat fetare konceptohen në varësi të kapacitetit mendor dhe botëkuptimeve të njerëzve. Mospajtimet kanë qenë prezentë qysh në kohën e sahabëve r.a. dhe kjo çështje do të vazhdojë kështu deri në Ditën e Kiametit, por e rëndësishme është të ruhet dashuria, vëllazëria, liria e mendimit dhe uniteti mes myslimanëve. Jusuf Sadefiu ka thënë: “Nuk kam parë njeri më të arsyetueshëm dhe më të mençur se Shafiu. Një ditë debatova me të për një çështje dhe më pas u ndamë. Kur më takoi, mu afrua më kapi për dore dhe më tha: “O Ebu Musa! A nuk duhet të jemi vëllezër, megjithëse nuk pajtohemi për çështje të caktuara?”¹⁹

- 1 Transmeton Imam Buhariu, hadithi nr. 946; dhe Imam Muslimi, hadithi nr. 1770.
- 2 Transmeton Imam Buhariu, hadithi nr. 7352; Imam Muslimi, hadithi nr. 1716; dhe Imam Tirmidhiu, hadithi nr. 1326.
- 3 Transmeton Ebu Davudi, hadithi nr. 3592; Imam Tirmidhiu, hadithi nr. 1327; dhe Imam Ahmed, vëll. 5, f. 230.
- 4 Bejhakui, *El Medkhal ila Ilmi's Sunen*, (Xhide, Darul Minhaxh, 2017), nr. 1248, 1249. Bejhakui thotë: “Teksti është më se i njohur, ndërsa vargjet e transmetimit janë të dobëta.”
- 5 Ahmed ibën Ali, Khatib Bagdadi, *El Fakihu ue'l Mutefakkih*, (Damam: Dar Ibën Xhevzi, 1996), nr. 743, 744, 745.
- 6 Jusuf ibën Abdulberri, *Xhâmiu Bejani'l Ilmi ue Fadlih*, (Damam: Dar Ibën Xhevzi, 2013), nr. 1686.
- 7 Muhamed ibën Sadi, *Tabekatu Ibni Sad*, (Kajro: Mektebe Khanxhi, 2001), v. 7, f. 188, botim i Mektebe Khanxhi, Kajro.
- 8 Ahmed ibën Ali, Khatib Bagdadi, *El Fakihu ue'l Mutefakkih*, nr. 760.
- 9 Jusuf ibën Abdulberri, *Xhâmiu Bejani'l Ilmi ue Fadlih*, nr. 1691.
- 10 Sulejman ibën Ahmed Taberani, *El Muxhemu'l Eusat*, (Kajro, Darul Haramjeni, 1995), (4361).
- 11 Ahmed ibën Tejmije, *Mexhmuatu'l Fetava*, (v. IV, Mensura, Darul Vefa, 2002), f. 172.
- 12 Muhamed ibën Ahmed Dhehebiu, *Sijeru Ealami'n Nubela*, (v. VI, Bejrut, Muesese Risale, 1996), f. 258.
- 13 Ahmed ibën Tejmije, *Mexhmuatu'l Fetava*, (v. XX), f. 211.
- 14 Transmeton Imam Buhariu, hadithi nr. 5060; Imam Muslimi, hadithi nr. 2667; dhe Imam Hamedi, hadithi nr. 18816.
- 15 Jahja ibën Sheref Nevevi, *El Minhaxh Sherh Sahih Muslim*, (v. II, Kajro, El Metbaatul Misrije, 1929), f. 23; Xhelaludin Sujuti, *El Eshbahu ue'n-Nadhair*, “*El Kaidetu 35*”, (Bejrut, Darul Kutubil Ilmije, 1983), f. 158.
- 16 Për më shumë shiko: Ibrahim ibën Musa Shatibi, *El Itisam*, (v. II, Bejrut, Darul Marife, 1405 H), f. 108; Muhamed ibën Ahmed Dhehebiu, *Sijeru Ealami'n Nubela*, (v. XIV, Bejrut, Muesese Risale, 1996), f. 40.
- 17 Abdulvehab Sharani, *El Mizanu'sh Sharanije*, (v. I, Bejrut: Alemul Kutub, 1989), f. 74.
- 18 Xhelaludin Sujuti, *Xhezilu'l Mevahib*, (Darul Itisam, 1992), f. 25-34, me shkurtime.
- 19 Muhamed ibën Ahmed Dhehebiu, *Sijeru Ealami'n Nubela*, (v. X, Bejrut, Muesese Risale, 1996), f. 16.

Ç'është akaidi dhe përse ta studiojmë atë?

Shejh Hasan el Hindi

Ndonëse secila prej shkencave islame ka temat e veta specifike të kërkimit dhe hetimeve të hollësishme, një student mund ta gjejë veten duke humbur vëmendjen e qëllimit, rëndësisë dhe veçorive dalluese të një shkence kur merret me studimin e hollësive dhe imtësitë e saj. Për shembull, një student mund të studiojë teorinë e bazave juridike (usul'ul-fikh) nën një mësues, duke mbuluar tema të tilla si kuptimi gjuhësor, analogjia dhe konsensusi, por ky student mund të mos e dijë ende se çfarë është në të vërtetë teoria juridike, përfitimet që fitohen nga studimi i saj, qëllimi i tij përfundimtar, mënyra se si duhet të studiohet dhe mënyra se si ajo dallohet nga shkencat e tjera. Për shkencën e akaidit, një kuptim i tillë gjithëpërfshirës dhe universal është i nevojshëm përpara se të zhytet në hetimet e saj të hollësishme. Ai vazhdon të japë një pasqyrë të tillë duke iu përgjigjur një sërë pyetjesh.

Ç'ËSHTË AKAIIDI?

Termi akaid ka dy kuptime. I pari i referohet aspekteve të besimit, që janë të detyrueshme për një person që t'i vendosë në zemrën e tij dhe të ketë besim në të. Këto janë konceptet dhe idetë që një person adopton në lidhje me Krijuesin, universin, qëllimin e krijimit, këtë botë, botën tjetër e kështu me radhë. Ky është akaidi, që është i detyrueshëm për të gjithë myslimanët ta dinë. Kuptimi i dytë i referohet lëndës që mësohet në seminare, përkatësisht

Termi akaid përkufizohet si njohuri, përmes së cilës besimet fetare vendosen me anë të provave që janë vendimtare dhe të sigurta.

shkencës aktuale të akaidit, e cila përfshin përkufizimin e parë të përmendur më lart, por shtrihet përtej tij. Në këtë kontekst, termi akaid përkufizohet si njohuri, përmes së cilës besimet fetare vendosen me anë të provave që janë vendimtare dhe të sigurta.

Dëshmitë e përdorura për të përcaktuar pikat e akaidit janë rationale dhe tekstuale dhe nuk ka asnjë kontradiktë midis këtyre dy burimeve. Ka disa pika të akaidit, që evidentohen kryesisht në bazë të provave rationale, të tjera në bazë të provave tekstuale, e megjithatë disa të tjera që bazohen në të dyja këto burime.


MARRËDHËNIA NDËRMJET AKAIIDIT DHE DITURISË NË PËRGJITHËSI

Marrëdhënia ndërmjet akaidit dhe diturisë në përgjithësi është një nga dallimet e përgjithshme-specifike, d.m.th., i gjithë akaidi është dituri, por jo e gjithë dituria është akaid. Një çështje konsiderohet një pikë e diturisë nëse ajo është vendosur në bazë të provave që janë të bazuara në njohuri dhe dijetarë.

Një pikë specifike e diturisë quhet akaid nëse përveç kësaj Zoti i jep atij një rëndësi të veçantë që kërkon besimin në të.

Akaidi islam mund të ndahet në dy lloje:

1) Ato aspekte të njohura në detajet e tyre, si p.sh. Zoti është i Gjithëfuqishëm, i Gjithëdijshëm, Dëgjues dhe Shikues, ose



emrat specifike të pejgamberëve të dërguar njerëzimit të përmendur në Kuran, ose emrat e engjëjve etj..

2) Një besim i përgjithshëm në gjithçka që është përcjellë në mënyrë autentike nga Zoti dhe Pejgamberi i Tij. Kështu, ka çështje që nga myslimani kërkohet t'i pohojë në një bazë të përgjithshme dhe të tjera që ai duhet t'i pohojë dhe të mësohet në një bazë më specifike dhe të detajuar.

Ndonjëherë na kërkohet të shprehim pikat e përgjithshme të besimit në një mënyrë më të hollësishme. Për shembull, librat e akaidit nuk detajojnë krijimin e Ademit a.s.. Myslimanët mjaftohen me Kuranin dhe tekstet e tjera për të pohuar si një pikë të përgjithshme besimi se ai u krijua nga balta dhe ishte qenia e parë njerëzore. Megjithatë, sot është e nevojshme që kjo çështje të diskutohet më në detaje për shkak të dyshimeve të ndryshme, që kanë lindur në lidhje me tregimin e krijimit islam.

NJË SHKENCË INTELKTUALE KUNDREJT NJË REALITETI EKSPERIENCIAL

Një mënyrë tjetër në të cilën akaidi ndahet është midis të qenit një veprimtari dijetare dhe intelektuale dhe midis të qenit një realitet eksperiencial. E para i referohet akaidit si një angazhim me tekste, duke detajuar dhe interpretuar pika të ndryshme të besimit, duke shpjeguar provat e tyre, duke mbrojtur besimin, e kështu me radhë. Nga ana tjetër, akaidi si një realitet eksperiencial përfshin transformimin dhe transferimin e këtyre pikave të besimit në vetëdijen dhe qenien e dikujt.

Të dyja këto dimensionet janë të ndara, por të lidhura ngushtë. Të ndara sepse ato e përfshijnë lëndën nga dy këndvështrime të dallueshme – njëra intelektuale dhe tjetra

praktike. Dhe të lidhura ngushtë sepse plotësojnë njëra-tjetrën.

AKAIDI SI NJË SHKENCË E GJALLË

Në mënyrë që çdo gjë të ruajë gjendjen e saj të jetesës, ajo kërkon dy gjëra: ushqim që e lejon atë të rritet dhe të mbajë ekzistencën e saj dhe një ilaç/mbrojtje që e pengon atë të dëmtohet.

Ushqimi i besimit gjendet në aktet e adhurimit, të tilla si: namazi, përmendja e Zotit, lutja, shoqëria e të drejtëve, e kështu me radhë. Ky lloj ushqimi është i nevojshëm për të gjithë.

Për sa i përket mjekësisë, këtë e kërkojnë vetëm ata që vuajnë nga një sëmundje ose dikush që është i prirë/eksponuar ndaj saj. Çfarë është ky ilaç? Është dy llojesh:

Mund të jetë një ilaç për të trajtuar një sëmundje aktuale që është e panishme, ose;

Mund të jetë një ilaç për të trajtuar një sëmundje që mund të ndodhë, pra mjekësi parandaluese.

Në rastin e pikës së dytë nga pikat e lartpërmendura, është e nevojshme që kushdo që mendon se është i prirë ndaj sëmundjes së dyshimit, të mësojë provat dhe provat e përgjithshme të akaidit. Mirëpo, nëse dikush ka dyshime për një çështje të caktuar, është e detyrueshme që ai person të mësojë provat e duhura për atë çështje akaidi në mënyrë specifike dhe të kërkojë përgjigje për dyshimin e tij.

SUBJEKTI - LËNDA E AKAIDIT

Janë tri tema kryesore me të cilat merret akaidi:

Hyjniteti (ilahijjat): çfarë është e nevojshme, e mundshme dhe e pamundur për Zotin.

Pejgamberia (nubuvvet): çfarë është e nevojshme, e mundshme dhe e pamundur për pejgamberët.

Çështjet e padukshme (sem'ijjat): tema që kanë të bëjnë me çështje të tilla si Dita e Gjykimit, Xheneti, Xhehenemi, engjëjt, shejtanët, shenjat e ditës së fundit, e kështu me radhë. Secila prej këtyre çështjeve përfshihet në një parim thelbësor: gjërat që intelektet i konsideron të mundshme që tekstet zbuluese i pohojnë dhe i vërtetojnë.

Dijetarët përmendin tema të tjera që përfshihen në tekstet e akaidit. Disa nga këto tema janë diskutime hyrëse, të tilla si përgjegjësia morale (teklif) ose besimi i pasuesit të verbër (mukal-lid). Temat e tjera shihen si diskutime ndihmëse, të tilla si ekspozimet e detajuara të provave për ekzistencën e Zotit.

OPINIONET SE PSE QUHET KELAM

Shkenca e akaidit quhet edhe Shkenca e Kelamit.¹ Ka mendime të ndryshme në lidhje me arsyen pse termi i fundit është përdorur për të përshkruar këtë shkencë. Disa menduan se ai iu kthye pyetjeve në lidhje me natyrën e Kuranit dhe fjalimit të Zotit (d.m.th. kelam) që ishin ndër temat teologjike më të hershme dhe më të debatuar. Një opinion tjetër thoshte se shkenca e Akaidit përfshinte një angazhim të vazhdueshëm ndërmjet palëve të ndryshme, që shpesh përfshinte debate verbale (d.m.th. kelam).

Këtu është një këshillë e rëndësishme për mësuesit. Dikush që i udhëzon të tjerët në akaid duhet të jetë plotësisht i hapur ndaj studentëve të tij dhe pyetjeve të tyre. Kjo është për shkak se mësuesi ka për detyrë t'ua mësojë atyre njohuritë mbi të cilat qëndron besimi dhe mosbesimi, dhe ai duhet t'i udhëzojë nxënësit në një mënyrë që të sigurojë se ata e kanë kuptuar plotësisht materialin dhe janë të bindur në të. Prandaj, është e nevojshme që një mësues të angazhojë pyetjet e nxënësve, dyshimet e tyre dhe të durojë me to. Kjo nuk duhet parë si një e metë e nxënësit dhe as si mungesë respekti ndaj një mësuesi.

Dikush që i udhëzon të tjerët në akaid duhet të jetë plotësisht i hapur ndaj studentëve të tij dhe pyetjeve të tyre. Kjo është për shkak se mësuesi ka për detyrë t'ua mësojë atyre njohuritë mbi të cilat qëndron besimi dhe mosbesimi, dhe ai duhet t'i udhëzojë nxënësit në një mënyrë që të sigurojë se ata e kanë kuptuar plotësisht materialin dhe janë të bindur në të.

VENDIMI MBI STUDIMIN E SHKENCËS SË AKAITIT OSE KELAMIT

Në lidhje me vendimin e studimit të kësaj shkenca nuk ka mosmarrëveshje se është e nevojshme të njihet Zoti, engjëjt, të dërguarit, librat, Dita e Fundit, e kështu me radhë. Mosmarrëveshja lind në lidhje me shkencën formale të kelamit, të cilën disa e kanë konsideruar si risi. Ky mendim i fundit është i pasaktë për faktin se shfaqja e shkencës së Kelamit pasqyron zhvillimin e të gjitha shkencave të tjera, si gramatika apo hadithi.

Terminologjia e veçantë e përdorur në kelam, si "atributet negative" (sifat selbije) ose "atributet permanente" (sifat luzumije) nuk është akaidi në vetvete dhe as me karakter specifik fetar, por etiketa dhe kategori që shpjegojnë një diskutim të caktuar në akaid dhe e paraqesin atë si një shkencë të kodifikuar dhe sistematike. Ky është thjesht një zhvillim organik që përjetojnë të gjitha shkencat.

Një pikë tjetër e lidhur me këtë është mënyra në të cilën Islami u përhap dhe ndërveproi me sisteme të tjera të mendimit, siç është filozofia greke. Studiuesit morën detyrën e vlerësimit dhe kritikës së këtyre sistemeve, si Imam Gazaliu në tre nga veprat e tij të famshme: "Makasid'ul-Felasifa", "Mahak'ul-Nadhar", "Tehafu'ul-Felasifa".

Dijetarët e kelamit formuluan parime, prova dhe argumente të hollësishme e tjera për të zhdukur idetë e gabuara dhe të devijuara dhe për ta kthyer besimin në gjendjen e tij të pacenuar. Prandaj, kjo shkencë jo vetëm që e shpjegoi akaidin, por veçoi si një pengesë që pengonte idetë e korruptuara të depërtonin në të.

SI E DALLON AKAITIN ISLAM NGA BESIMET E TJERA?

Mënyrat në të cilat akaidi islam e veçon veten nga besimet dhe sistemet e tjera të besimit janë si më poshtë:

1. Akaidi islam është nga Zoti dhe i Dërguari i Tij;

2. Akaidi islam është tevfiki, pra nuk pranon shfuqizimin, ndryshimin, transformimin, e kështu me radhë. Përkundrazi, akaidi i mësuar nga Pejgamberi a.s. është e njëjta që

besimtarët selefë vazhdojnë të pranojnë deri më sot;

3. Akaidi islam përputhet me natyrën (fitra) fillestare të njerëzve. Për këtë arsye, kur një mysliman flet për akaidin islam, ajo bëhet me dy burime ndikimi dhe autoriteti: një i jashtëm dhe një i brendshëm. E jashtëm lidhet me forcën e provës dhe dëshminë racionale/tekstuale, ndërsa e brendshme lidhet me natyrën primordiale të qenieve njerëzore;

4. Akaidi islam nuk bie ndesh me arsyen apo intelektin e shëndoshë. Deklarata e përsëritur shpesh se mutezilët ishin të gabuar, sepse ata arbitruan në bazë të arsyes dhe intelektit, nuk është e saktë. Përkundrazi, nëse ata do t'i kishin shfrytëzuar këto burime në një mënyrë të shëndoshë, ata nuk do të ishin devijuar;

5. Akaidi islam është i thjeshtë dhe i qartë;

6. Akaidi islam e lidh njeriun me Krijuesin e Tij pa ndërmjetësim;

7. Akaidi islam nuk përmban kontradikta. Kontradiktat e perceptuara janë rezultat i mungesës së të kuptuarit. Ndonjëherë, një pikë akaidi mund të hutojë mendjen, por nuk është kurrë diçka që intelektin e konsideron racionalisht të pamundur. Kështu, intelektin e konsideron fronin e Zotit dhe engjëjve si racionalisht të mundshëm edhe pse nuk është në gjendje ta kuptojë plotësisht realitetin e tyre;

8. Akaidi islam është një besim gjithëpërfshirës për të gjitha kohët, popujt dhe vendet;

9. Akaidi islam është i përshtatshëm për të gjitha kohët, popujt dhe vendet;

10. Akaidi islam është një besim i moderuar që zë një terren të mesëm midis ekstremeve. Nuk është as një besim i thatë racional dhe as i bazuar në sentimentalizëm emocional. Përkundrazi, ai tërheq zemrën dhe mendjen;

11. Akaidi islam është themeli i mirëqenies personale dhe të përbashkët, i veprimit të drejtë dhe i korigjimit. Kjo është arsyeja pse shumë tradita pejgamberike fillojnë me: "Kushdo që beson në Zotin dhe në Ditën e Fundit...". Këto vepra dhe tipare të mira janë fryt i besimit të shëndoshë.

PSE TË STUDIOJMË SHKENCËN E AKAJDIT?



Moskuptimi i arsyeve që mbështesin nevojën për të studiuar një shkencë të caktuar shpesh përfshin zhvlerësimin e asaj shkence dhe mos angazhimit të duhur me të. Ka një sërë arsyes pse ne duhet të angazhohemi në studimin e shkencës së akajdit.

1. Të prezantohet akaidi në mënyrë të qartë, shkencore dhe sistematike. Kjo i mbron njerëzit nga besimet e gabuara që mund të adoptohen pa vetëdije në një kontekst ku akaidi mësohet organikisht në një mënyrë të përgjithshme. Një prezantim i tillë i akajdit e vendos atë gjithashtu si një shkencë me faza të përcaktuara fillimi, mesi dhe fundi, nëpër të cilat studentët mund të përparojnë gradualisht.

2. Të mbështesim pikat e akajdit me prova dhe argumente, që ndihmojnë në parandalimin e dyshimeve nga ndikimi i besimit tonë.

3. Për ta forcuar dhe për ta bërë të fortë akaidin tonë kundër përgënjeshtimeve që bëhen kundër tij. Kjo është veçanërisht e vërtetë në një epokë ku edhe aksiomat më themelore mbi të cilat bazohet akaidi janë objekt dyshimi, siç është pamundësia e regresit të pafund. Këtu, është një detyrim i përbashkët të prodhohen dijetarë, që kanë njohuri dhe aftësi për të shmangur dyshime të tilla nga komuniteti në përgjithësi dhe për të mbrojtur besimin e njerëzve.

4. Shkenca e akaidit na lejon të zotërojmë besimin se është i shëndoshë, i cili është një parakusht për lumturinë në jetën e ardhshme. Nëpërmjet besimit të shëndoshë, njeriu është në gjendje të konceptojë siç duhet botën dhe qëllimin e ekzistencës.

5. Shkenca e Akaidit e vendos një individ në një gjendje qetësie dhe paqeje me kushtin që dikush të ketë një lidhje të vërtetë me Zotin.

SI E STUDION INDIVIDU AKAJDIN?

Parazjedhja është se çdo individ është përgjegjës për studimin e akaidit. Megjithatë, akaidi u prezantohet njerëzve bazuar në aftësitë dhe gatishmërinë e tyre përkatëse. Prandaj, nuk ka asnjë mënyrë të vetme për t'ua mësuar akaidin njerëzve. Për sa i përket mësimin të njerëzve të akaidit, nxënësit ndahen në kategoritë e mëposhtme:

Fëmijët e vegjël. Akaidi u mësohet atyre duke përsëritur vazhdimisht pikat themelore të besimit, si Zoti është Një, Zoti është i Fuqishëm, Zoti na jep gjithçka, e tjera, në mënyrë që këto ide të nguliten në mendjet e tyre. Kur një fëmijë bën një pyetje, atij ose asaj duhet t'i jepet një përgjigje e qartë, e thjeshtë dhe e shëndoshë. Fëmijët mund të mos e kuptojnë plotësisht një ide të caktuar, por ata e ruajnë atë dhe shumë nga idetë që mbajnë në moshë të re trajtohen si aksiomatike prej tyre kur rriten.


Laikët e përgjithshëm. Atyre u mësohet akaidi si një shprehje e përgjithshme e doktrinës së besimit pa diskutime të hollësishme dhe teknike. Kjo duhet t'u mësohet atyre jo në bazë të teksteve të besimit apo terminologjisë së kelamit, të cilat laikët nuk janë të detyruar t'i dinë, por më tepër përmes tefsirit, sires, ajeteve kuranore dhe haditheve, duke përdorur një gjuhë të qartë, por jo teknike.

Njerëz të mirëarsimuar që nuk janë specialistë të akaidit. Atyre u mësohet akaidi në një kuptim të përgjithshëm dhe gjithashtu gradualisht ekspozohen ndaj disa prej diskutimeve më të hollësishme në lidhje me besimin. Megjithatë, këto diskutime nuk prezantohen, por u mësohet ajo që është e rëndësishme për ta në kohën dhe vendin e tyre, d.m.th., diskutimet mbi ateizmin, për shembull, në krahasim me mutezilët.

Studentët që janë specialistë. Ata që janë të specializuar në akaid u kërkohet të studiojnë gjithçka që lidhet me shkencën. Kjo përfshin një planprogram gjithëpërfshirës të teksteve klasike – të hershme dhe të mëvonshme – si dhe ideologjitë dhe sektet e kaluara dhe moderne.

NJË SHËNIM PËR STUDENTËT E AKAJDIT

Studentët që janë të specializuar në këtë shkencë duhet të ngrenë shiritin. Ata nuk duhet të mjaftohen me vepra ndërmjetëse, por përfundimisht të zhyten në veprat më të



avancuara dhe më kryesore të shkencës pasi të kenë zotëruar mjetet e nevojshme për t'i aksesuar dhe kuptuar ato.

Ne duhet të forcojmë aftësitë tona dhe zotërimin e provave që mbështesin akaidin, në mënyrë që ato t'u jepen njerëzve në mënyrë të përshtatshme në bazë të aftësive dhe gatishmërisë së tyre përkatëse.

Ne duhet të kuptojmë periudhën në të cilën po jetojmë për të paraqitur një diskurs më bashkëkohor akaidi, që është i përshtatshëm dhe adekuat për kulturën dhe mjedisin e sotëm.

Ne duhet të jemi të vetëdijshëm për ideologjitë dhe sektet moderne, si dhe dyshimet e ngritura kundër Islamit, dhe të formulojmë përgjigje të shëndosha kundrejt tyre.

Përktheu:²

Nexhat Ibrahim

1 Në fakt, akaidi është shkencë mbi besimin, kurse kelami është metodologjia e shkencës mbi besimin. Ka disa metodologji, racionale, tradicionale, sufiste etj.. Në përgjithësi termi akaid dhe kelam trajtohen si sinonime. (përkthyesi)

2 Shaykh Hassan al Hindi, What is Aqida and Why Study It?, në: <https://seekersguidance.org/articles/knowledge/what-is-aqida-why-study-it/>.

Përgatitja për Ditën e Kiametit

Muhamed Atiye

Në jetën e njeriut ka stacione që secili kërkon përgatitje të veçantë. Stacioni i lindjes kërkon nga familja dhe shoqëria përgatitje për ta pritur ardhjen e krijesës së re. Stacioni i provimeve shkollore kërkon përgatitje nga nxënësi dhe nga shkolla që nga fillimi i vitit shkollor, madje që para se ai të fillojë. Po ashtu, stacioni i kalimit nga jeta e kësaj bote në jetën e botës tjetër kërkon përgatitje. Kjo përgatitje fillon që në fëmijëri, me vetëdijen e njeriut për konceptin e përgjegjësisë dhe të llogaridhënies, si dhe me kuptimin e bazave mbi të cilat do të jepet llogari, duke përfshirë edhe të mëdhenjtë edhe të vegjlit.

TË KUPTUARIT E NATYRËS SË JETËS SË KËSAJ BOTE

Nëse duam të flasim për përgatitjen për Ditën e Kiametit, së pari duhet ta kuptojmë natyrën e kësaj jete tokësore dhe se ajo është arë për jetën e përtejme. Kjo do të thotë se, nëse i mbjellim farat në vendin e duhur, ndjekim ciklin e mbirjes dhe bëjmë përpjekjen e nevojshme, do të fitojmë një vend më të mirë në një jetë të përjetshme pa fund. Por, nëse e humbasim këtë dhuratë hyjnore,

“Sa për atë që
dëshiron
botën tjetër
dhe përpiqet
për të me
gjithë shpirt e
duke qenë
besimtar,
përpjekja e tij
do të
shpërblehet.”
(El Isra, 19).

atëherë do të privohemi nga çdo mirësi që nuk mund të zëvendësohet kurrë.

Nga mirësia e Allahut të Lartësuar ndaj nesh është se Ai na i ka sqaruar ngjarjet e Ditës së Fundit në Kuran dhe në Sunet. Ky sqarim na thërret që të jemi vazhdimisht të përgatitur për një takim të tillë. Kjo përgatitje nuk është e kufizuar vetëm për të moshuarit, apo për ata që preken nga ndonjë sëmundje që ua bënë ta ndiejnë se afati i tyre po afrohet, por është detyrë e çdo njeriu, pa marrë parasysh moshën apo gjendjen e tij: “Sa për atë që dëshiron botën tjetër dhe përpiqet për të me gjithë shpirt e duke qenë besimtar, përpjekja e tij do të shpërblehet.” (El Isra, 19).

ASPEKTET E PËRGATITJES PËR DITËN E KIAMETIT

Aspektet e përgatitjes për Ditën e Fundit përfshijnë të gjithë rrjedhën e jetës, por ne prej tyre, do t'i zgjedhim disa fusha kryesore:

FUSHA E ZEMRËS

Zemra është vendi ku drejtohet vështrimi i Allahut të Lartësuar. Pejgamberi a.s., ka thënë: “Vërtet Allahu nuk shikon pamjet tuaja as pasuritë tuaja, por shikon zemrat tuaja dhe veprat tuaja.” (Sahihu i Muslimit). Prania e së

mirës në këto zemra është shkak për mirësi si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër. Nëse Allahu di se ka mirësi në zemrat tuaja, Ai do t'ju japë më të mirën. Kur këto zemra mbushen me mirësi, ato lëvizin në kënaqësinë dhe mëshirën e Allahut të Lartësuar. Abdullahu, i biri i Imam Ahmedit, i tha babait të tij: “Më këshillo!” Ai i tha: “O bir, syno të mirën, sepse ti do të jesh gjithnjë në mirësi përderisa synon të mirën.” (Meritat e Imam Ahmedit nga Ibnu'l- Xhevzi).

MBIKËQYRJA E ZEMRËS DHE PËRMIRËSIMI I SAJ

Zemrat kanë nevojë për mbikëqyrje të vazhdueshme, për të vërejtur çdo mangësi që i godet dhe çdo ndryshim që u ndodh. Abdullah bin Revaha ka thënë: “Zemra është më e shpejtë në ndryshim sesa tenxherja kur e arrin pikën e vlimit.” (Ez Zuhd ver Rekaik – nga Ibën Mubareku). Po ashtu, zemrat kanë nevojë për përmirësim të pandërprerë, sepse shpirti që nxit në të keqen dhe shejtanët e njerëzve dhe të xhinëve punojnë ditë e natë për t'i prishur ato. Kur zemra prishet, prishen edhe nijeti, fjala dhe vepra, e përfundimi është që njeriu të dalë përpara Allahut të Lartësuar ose pa asnjë vepër të mirë, ose me shumë vepra të mira që shpërndahen te kundërshtarë të shumtë.

MARRËDHËNIET SHOQËRORE DHE NDIKIMI I TYRE

Kjo botë funksionon mbi bazën e lidhjes së interesave të njerëzve me njëri-tjetrin. Nëse këto interesa themelohen në kujdesin për etikën dhe fenë, atëherë ato do të kenë vazhdimësi, qëndrueshmëri dhe dobishmëri për pronarët e tyre, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Ndërsa nëse themelohen vetëm në përfitimet e kësaj bote, ato shpejt kthehen në armiqësi ose, në rastin më të mirë, në ftohtësi dhe ndërprerje (të marrëdhënieve). Këto marrëdhënie kanë ndikimin më të madh në përgatitjen tonë për Ditën e Fundit. Njerëzit që do të shkëlqejnë (do të fitojnë) tek Allahu i Lartësuar janë ata që kanë themeluar marrëdhënie të shëndosha, në të cilat bëhet këshillimi (porositja) reciprok për të vërtetën dhe për durimin: “Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.” (El Asr, 2-3).

Banorët e Zjarrit përmalohen për mungesën e mikut të ngushtë: “Tashmë ne nuk kemi asnjë ndërmjetësues (tek Allahu), e as ndonjë mik të ngushtë!” (Esh Shuara, 100-101).

PËRMBUSHJA E PREMTIMEVE

Premtimi realizohet përmes një kontrate të shkruar ose një premtimi verbal për diçka në të ardhmen, dhe përmeshja e tij paraqet sinqeritetin e besimit dhe nderin e fjalës. Kjo fillon nga premtimi i prindit ndaj fëmijëve për të blerë diçka që e duan ose për një shëtitje ku do të argëtohen; deri te besëlidhja



që kanë marrë përsipër të dy bashkëshortët për ta ruajtur ndërtesën e familjes në shëndet dhe sëmundje, në vështirësi dhe lehtësi, si dhe në gjendje gëzimi apo zemërimi, dhe mbështetja e njëri-tjetrit në momentet e dobësisë dhe paaftësisë; deri te përmeshja e tregtarit ndaj konsumatorit për specifikimet e shënuara në mall dhe dorëzimi në kohën e rënë dakord; deri te përmeshja e punëdhënësit me atë që u ka premtuar punëtorëve si shuma financiare apo pushime që i përfitojnë ose marrin pagesën gjatë tyre, dhe moszgjatja e orarit të punës përveçse me pëlqim reciprok dhe dhënien e kompensimit të përshtatshëm për punëtorin; - dhe përmeshja e punëtorit me kryerjen e punës së tij me përpikëri, mos shpenzimi i kotë i kohës, kujdesi për institucionin ku punon, reputacionin dhe interesat e tij, si dhe arritja e epërsisë (udhëheqjes) për të mes institucioneve konkurrenente.

Përmeshja e premtimeve na shpëton nga një turpërim i madh në Ditën e Kiametit. I Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Për tradhtarin në Ditën e Kiametit do të ngrihet një flamur që tregon tradhtinë e tij, e do të thuhet: “Ky është flamuri i tradhtisë së filanit.” (Musnedi Imam Ahmedit. Verifikuesit e tij (të haditheve) thanë: Hadithi është sahih (i saktë).

VËZHGIMI I KATËR PYETJEVE TË DITËS SË KIAMETIT

I Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Nuk do të lëvizin këmbët e robit Ditën e Kiametit, derisa të pyetet: për jetën e tij si e harxhoi, për dijen e tij se çfarë veproi me të, për



pasurinë e tij nga e fitoi dhe ku e shpenzoi dhe për trupin e tij ku e ka përdorur.” (Sunenut Tirmidhi. Ky është hadith hasen sahih - hadith i mirë dhe i saktë).

Këto pyetje na ftojnë që ta vëzhgojmë jetën tonë dhe ta mbushim me vepra, që na sjellin dobi në këtë botë dhe në botën tjetër; të përfitojmë nga dituria jonë duke e zbatuar atë në përmirësimin e jetës sonë, si në aspektin fetar ashtu edhe në atë jetësor; të jemi të kujdesshëm për burimet e të ardhurave dhe mënyrën e shpenzimit, a janë ato në përputhje me hallallin që sjell dobi dhe shpërblim, apo përfshijnë tepricë, mburrje e dëshirë për famë; dhe ta ruajmë këtë amanet që na e ka dhënë Allahu – trupin dhe shëndetin tonë – duke i përdorur në atë që e kënaq Atë, e jo në dëm të krijesave apo në mendjemadhësi ndaj tyre.

RUAJTJA E VEPRAVE TË MIRA

Njeriu i mbron pasuritë e tij dhe i mbron ato me shpirtin e tij, por a i mbron ai edhe veprat e tij të mira me të njëjtin zell?

Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a., se vërtet i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “A e dini se kush është i falimentuar?” Ata thanë: “I falimentuar te ne është ai që nuk ka para dhe

Të jemi të kujdesshëm për burimet e të ardhurave dhe mënyrën e shpenzimit, a janë ato në përputhje me hallallin që sjell dobi dhe shpërblim, apo përfshijnë tepricë, mburrje e dëshirë për famë.

nuk posedon asgjë.” Ai tha: I falimentuari i vërtetë nga umeti im do të vijë Ditën e Kiametit me namaz, agjërim e zekat. Vjen, por e ka fyer këtë, ka shpifur për këtë, e ka ngrënë pasurinë e këtij, e ka derdhë gjakun e këtij, e ka rrahur tjetrin. Atëherë ju jepet atyre nga të mirat e tij, e nëse përfundojnë të mirat e tij para sa t'i shpagojë këto padrejtësi, merren nga gjynahet e atyre që ju ka bërë padrejtësi dhe i hidhen atij, dhe pastaj hidhet në Zjarr.” (Transmeton Muslimi).

Transmetohet nga Thevbani, nga Pejgamberi a.s., se ai ka thënë: “Unë i njoh disa popuj nga umeti im që do të vijnë Ditën e Kiametit me vepra të mira të bardha sa malet e Tihames, por Allahu i Plotfuqishëm do t'i bëjë ato pluhur të shpërndarë.” Thevbani tha: “O i Dërguari i Allahut, na i përshkruaj ata, na i sqaro karakteristikat e tyre, që të mos bëhemi prej tyre pa e ditur!” Ai tha: “Ata janë vëllezërit tuaj dhe janë nga lëkura juaj. Ata falen gjatë natës ashtu siç faleni ju, por ata janë njerëz që, kur gjenden vetëm me gjërat që i ka ndaluar Allahu, i shkelin ato.” (Suneni i Ibni Maxhes).

Një prej momenteve më të rënda të dëshpërimit (kujtesës së trishtë) për njeriun është t'i hiqet diçka që e do, dhe dëshpërimi

shtohet kur ai bëhet i paaftë ta kompensojë atë që i është hequr. Për t'iu shmangur dëshpërimit të dyfishtë, humbjes së veprave të mira dhe humbjes së kënaqësisë së Allahut të Lartësuar dhe Xhenetit të Tij, vjen paralajmërimi i Pejgamberit a.s. për humbjen e tyre (veprave të mira) në Ditën e Kiametit, në një çast kur nuk mund ta kompensojmë atë që kemi humbur. Prandaj, një prej përgatitjeve më të mëdha që bëjmë për takimin me Allahun e Lartësuar është ruajtja e veprave të mira që i kemi kryer.

RËNDËSIA E INICIATIVËS PËR VEPRAT TË MIRA

Iniciativa është një nga shkaqet e suksesit në këtë botë dhe në botën tjetër. I Dërguari a.s., ka thënë: “Nxtoni (bëhuni iniciatorë) me vepra (të mira) para se t’ju godasin sprovat si copa të natës së errët. Njeriu gdhin besimtar dhe ngryset jobesimtar, ose ngryset besimtar, duke e shitur fenë e tij për një vlerë të kësaj bote.” (Sahihu i Muslimit).

Kjo iniciativë na thërret gjithmonë që t’i shfrytëzojmë mundësitë para se të humbasin, dhe para se përtacia të na pengojë ose sprovat të na ndajnë nga puna. I Dërguari i Allahut a.s., i tha një burri, derisa po e këshillonte: “Shfrytëzoji pesë gjëra para pesë të tjerave: rininë tënde para pleqërisë sate, shëndetin tënd para sëmundjes sate, pasurinë tënde para varfërisë sate, kohën tënde të lirë para angazhimeve tua, dhe jetën tënde para vdekjes sate.” (El Mustedrik ale’ Sahihajn).

Kjo iniciativë është para Orës (së Kiametit), para asaj kohe kur njeriu do të thotë me keqardhje: “Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobesimtarëve), ai thotë: “O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë!” Kurrsesi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai (kot) e thotë! Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse, deri në ditën kur do të ringjallen.” (El Mu’minun, 99–100).

SI TË PËRGATITEMI PËR DITËN E KIAMETIT PËRMES VEPRAVE TONA TË PËRDITSHME?

Përgatitja për Ditën e Kiametit nënkupton shtimin e punës së dobishme në Tokë, sepse kjo botë është ara e Ahiretit dhe burimi i veprave të mira: një fjalë e mirë dhe një shprehje e butë, një bimë që e madhëron Allahun e Lartësuar, e pastron ajrin dhe siguron ushqim për nevojtarët; një ndërtesë që u jep mbrojtje dhe strehë bijve të Ademit; një mjekësi që shëron të sëmurin; një shkollë që mëson të vërtetën, të mirën dhe të bukurën; si dhe gjithçka që rrjedh prej tyre: si industrinë që kujdesen për plotësimin e nevojave të njeriut duke ruajtur njëkohësisht mjedisin; profesionet, ekonomia, administrimi dhe mundësia për punë. Të gjitha këto përcaktohen nga fjala e Allahut të Lartësuar: “Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam



urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij.” (El Enam, 162–163).

Ne ndihemi të mangët kur i shikojmë veprat dhe mëkatet tona, megjithatë shpresojmë që Zoti ynë të na fusë në Xhenet me njerëzit e mirë. Ndërsa, ai që shpreson në ndërmjetësimin e Pejgamberit a.s., duhet ta ndjekë rrugën e tij në jetë: rrugën e dashurisë, mëshirës, forcës, drejtësisë dhe bamirësisë; ai duhet të përpiqet për ndërmjetësimin e mirë, përmes të cilit i zoti i së drejtës e merr të drejtën e tij. E kush shpreson në ndërmjetësimin e Kuranit fisnik, duhet të jetë prej atyre që i përkasin atij dhe e kryejnë si duhet të drejtën e tij.

Përgatitja për botën tjetër do të thotë që ne ta rishikojmë vetveten para se ta fillojmë një vepër, gjatë kryerjes së saj dhe pasi ta kemi përfunduar; duke pyetur veten: Për kë po e bëjmë këtë vepër? Për Allahun e Lartësuar, apo për kënaqësinë e vetvetes, apo për kënaqësinë e të tjerëve? Dhe, a ecën kjo vepër në rrugën që Allahu na ka urdhëruar të ecim, apo i ndjek hapat e shejtanit?

Përgatitja për botën tjetër nuk e pengon njeriun që ta marrë pjesën e tij nga furnizimi i Allahut të Lartësuar, ashtu siç thotë Ai: “Thuaj: “Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?” Thuaj: “Ato janë për besimtarë (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të jenë vetëm për besimtarët.” (El Araf, 32).

Përktheu nga gjuha arabe: Miftar Ajdini

Islami dhe moderniteti – pikëprerjet, kundërshtitë dhe sfidat e reja epistemologjike

Vladimir Kera

“Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t'i bashkonte në një bashkësi të vetme, por ata vazhdimisht janë në kundërshtime.” (Hud, 118).

Raporti ndërmjet Islamit dhe modernitetit është një nga çështjet më komplekse të debatit bashkëkohor, duke prekur dimensionet fetare, filozofike, sociologjike dhe politike. Moderniteti, produkt i transformimeve ideore që ndodhën qysh nga shekulli XVII, krijoi një paradigmë të re, në të cilën racionalizmi, autonomia njerëzore, dekonstruksionizmi, sekularizimi dhe individualizmi përbëjnë shtyllat bazë. Ky model shpesh shihet si i “përkundërt” me botëkuptimin islam, i cili vendos shpalljen hyjnore, normativitetin dhe lidhjen midis etikës, shoqërisë dhe transcendencës në qendër të jetës. Kështu, marrëdhënia ndërmjet Islamit dhe modernitetit nuk është thjesht një dialog, por një dialektikë dinamike që përfshin pikëprerje dhe transformime.

Nga pikëpamja historike, moderniteti evropian u konsolidua mbi një akt radikal të

Nga pikëpamja historike, moderniteti evropian u konsolidua mbi një akt radikal të sekularizimit, duke përjashtuar autoritetin hyjnor nga jeta publike dhe duke afirmuar qasjen racionaliste në organizimin e botës.

sekularizimit, duke përjashtuar autoritetin hyjnor nga jeta publike dhe duke afirmuar qasjen racionaliste në organizimin e botës. Iluminizmi e zhvendosi njeriun në qendër të universit moral e politik, duke krijuar një “kornizë imanente”, ku transcendenca shihet si opsionale.¹ Në këtë kontekst, Islami sfidon premisat e modernitetit, sepse ruan një rend etik dhe juridik të lidhur ngushtë me burimin hyjnor. Debatet bashkëkohore nënvizojnë se sfida nuk qëndron vetëm në mospërputhjen normative, por edhe në pretendimin universalist të epistemologjisë moderne, i cili kundërshton dimensionet e shpalljes islame që tejkalojnë kufijtë e arsyes autonome.²

Reformatorët myslimanë të shek. XIX dhe XX, u përpoqën të artikulonin përgjigje ndaj modernitetit, duke rivlerësuar traditën (turath), por pa rënë në imitim të verbër. Mendimtarë si Muhamed Abduhu dhe Rashid Ridaja e panë modernitetin si sfidë, por edhe si mundësi për të rikthyer vitalitetin moral dhe juridik të Islamit.³ Sfidat kryesore lidhen me ndërtimin e një etike islame, e cila komunikon me racionalitetin modern, duke

pasur parasysh se moderniteti nuk është thjesht teknologji, por një ndërgjegje kulturore me parime thelbësisht të ndryshme nga perspektiva islame mbi njeriun, epistemën dhe shoqërinë.⁴

Moderniteti, ndoshta pa e kuptuar (ne si “masë” fetare) ka ndikuar gjithashtu edhe në fragmentimin e autoritetit fetar dhe në pluralitetin e interpretimeve, duke krijuar sfida epistemike. Kjo gjë ka sjellë mbizotërimin e dekonstruksionit në studimet islame. Dekonstruksionizmi, sipas Jacques Derrida, analizon tekste për të zbuluar tensionet e brendshme dhe pamundësinë për kuptim unik.⁵ Përdorimi i kësaj metode edhe në studimet islame ka hapur mundësi për interpretim kritik, por gjithashtu ka relativizuar hermeneutikën tradicionale, duke zhvendosur kuptimin nga autoriteti i transmetimit te subjektiviteti i komentuesit. Ky zhvillim përbën sfidë për epistemologjinë klasike islame, e cila bazohet mbi objektivitetin e burimeve dhe jo mbi interpretimin arbitrar.⁶

Një dimension i ri është ndikimi i teknologjisë digjitale në dijen dhe praktikën islame. Komunikimi digjital dhe platformat online kanë lehtësuar qasjen individuale në tekste dhe komentime, duke decentralizuar autoritetin tradicional. Ky fenomen fuqizon individin, por krijon edhe sfida epistemike: interpretimet bëhen më të shpërndara, humbet konteksti tradicional dhe autoriteti i dijes së strukturuar dobësohet, ku si pasojë zhvillohet qasja ndaj informacionit, por jo ndaj dijes. Përdorimi kritik i teknologjisë mund të pasurojë dialogun, pa e reduktuar shpalljen në informacione fragmentare dhe të pjesshme.⁷

Nga një këndvështrim, moderniteti shfaqet jo vetëm si zhvillim teknologjik, por edhe si hegjemonizim kulturor dhe socio-politik. Autorë bashkëkohorë argumentojnë se ai imponon modele unike globalisht, duke riformësuar marrëdhëniet e pushtetit përmes sekularizimit dhe kontrollit të mekanizmave të diskursit publik.⁸ Kjo krijon tension me traditën islame, e cila e sheh rendin hyjnor si themel të jetës morale dhe sociale.

Historia tregon se qytetërimi islam ka zhvilluar nivele të larta të racionalitetit, shkencës, etikës dhe kulturës, duke ndërvepruar me traditën të ndryshme intelektuale. Problemi shfaqet kur moderniteti kërkon monopolin epistemik, ndërsa përgjigjet myslimane ndeshen nga refuzimi absolut ose adoptimi i pakushtëzuar. Qasja më e shëndetshme mbetet rikonceptimi i traditës brenda parimeve metodologjike, pasi siç vëren me të drejtë Taha Abdurrahmani, moderniteti në nivel konceptual ka relativizuar absoluten dhe ka absolutizuar relativen.⁹


Megjithatë, raporti ndërmjet Islamit dhe modernitetit nuk është një konflikt i pashmangshëm, por një dialog i domosdoshëm dhe i vazhdueshëm. Në këtë dialog,



pikëprerjet janë të qarta: Islami ka nxitur historikisht arsyen, shkencën, eksperimentimin dhe kërkimin e së vërtetës nëpërmjet ixhtihadi dhe mendimit kritik. Në anën tjetër, moderniteti, pavarësisht krizave të tij, ka arritur të prodhojë vlera universale si drejtësia sociale, dinjiteti njerëzor, barazia para ligjit dhe respektimi i të drejtave themelore, të cilat nuk janë të huaja për traditën islame, përkundrazi, gjenden në Kuran dhe Sunet në formën më të lartë të tyre.

Kundërshtitë, megjithatë, mbeten reale dhe të thella. Moderniteti shpesh absolutizon autonominë njerëzore, duke e shkëputur atë nga çdo referencë transcendentale dhe duke e kthyer njeriun në masën e çdo gjëje. Në këtë mënyrë, ai minimizon ose mohon rendin hyjnor që Islami e sheh si themelin e çdo morali, ligji dhe kuptimi. Kjo nuk është thjesht një ndryshim filozofik, por një përplasje ontologjike: një botë që e sheh Zotin si qendër absolute, kundrejt një bote që e sheh njeriun si qendër relative dhe të vetëkrijuar.

Sfida e vërtetë e kohës sonë nuk është as refuzimi i plotë i modernitetit, as dorëzimi i pakushtëzuar ndaj tij, por ndërtimi i një qasjeje të balancuar. Kjo qasje kërkon:



- një kritikë të thellë dhe të paanshme të modernitetit me instrumente intelektuale serioze, duke përdorur si mjetet e vetë arsyes moderne ashtu edhe trashëgiminë e mendimit islam;

- një lexim të gjallë dhe dinamik të traditës islame, jo si muze të së shkuarës, por si burim i gjallë i kuptimit dhe zgjidhjeve për problemet e sotme;

- një hermeneutikë bashkëkohore, që respekton autoritetin e teksteve të shenjta dhe metodologjinë klasike, por që njëkohësisht i hap ato ndaj pyetjeve aktuale;

- një angazhim aktiv në hapësirat publike, kulturore dhe shoqërore për të ofruar alternativa islame ndaj krizave të modernitetit të vonë; rreth etikës dhe moralit, ripërkufizimi i koncepteve sipas pikëpamjes fetare dhe ballafaqimi me humbjen e kuptimit.

Vetëm duke ecur në këtë rrugë, Islami mund të paraqitet si një alternativë. Nuk bëhet fjalë për të filluar një betejë kundër modernitetit, por për të kontribuar për një botë më të drejtë, më të kuptueshme dhe më të lidhur me burimin e saj hyjnor. Kjo është detyra akute e mendimit islam sot, jo të mbrohet nga moderniteti, por të dialogojë me të, ta sfidojë, ta pasurojë dhe, në fund të fundit, ta tejkalojë atë me një vizion më të plotë të njeriut dhe botës.

Islami mund të paraqitet si alternativë jo duke luftuar modernitetin, por duke dialoguar me të: ta sfidojë, ta pasurojë dhe ta tejkalojë me një vizion më të plotë për njeriun dhe botën, duke kontribuar për një shoqëri më të drejtë, më të kuptueshme dhe më të lidhur me burimin hyjnor.

Fusnota:

¹ Albert Hourani, *Arabic Thought in the Liberal Age, 1798–1939* (Cambridge: Cambridge University Press, 1983), 15–18. — Mendimi arab në epokën liberale, 1798–1939.

² Sejid Husein Nasr, *Traditional Islam in the Modern World* (London: KPI, 1987), 33–36. — Islami tradicional në botën moderne.

³ Muhamed Abduh dhe Rashid Rida, *Tefsīr al-Manār* (Kajro: Dār al-Manār, 2004), 12–20. — Komentari i dritës (Tefsiri al-Manār).

⁴ Ibrahim Kalin, *Reason and Rationality in the Quran* (Amman: Royal Islamic Strategic Studies Centre, 2016), 45–48. — Arsyeja dhe racionaliteti në Kur'an.

⁵ Jacques Derrida, *Of Grammatology*, trans. Gayatri Chakravorty Spivak (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1997), 59–63. — Për gramatologjinë.

⁶ Wael B. Halak, *Authority, Continuity and Change in Islamic Law* (Cambridge: Cambridge University Press, 2001), 102–105. — Autoriteti, vazhdimësia dhe ndryshimi në ligjin islam.

⁷ Gary R. Bunt, *Hashtag Islam: How Cyber-Islamic Environments Are Transforming Religious Authority* (Chapel Hill: University of North Carolina Press, 2018), 78–82. — Hashtag Islam: Si mjediset kibernetike islame po transformojnë autoritetin fetar.

⁸ Abdel Vahhab el Mesiri, *Al-'Almāniyya al-juz' iyya ʿa al-'almāniyya al-shāmila* (Kajro: Dār al-Shurūq, 2002), 145–150. — Sekularizmi i pjesshëm dhe sekularizmi i plotë.

⁹ Taha Abdurrahman, *Rūh al-ḥadātha* (Bejrut: Al-Markaz al-Thaqāfi al-'Arabī, 2006), 22–28; *Bu's al-dahrāniyya* (Bejrut: Al-Markaz al-Thaqāfi al-'Arabī, 2014), 55–60. — Shpirti i modernitetit; Mjerimi i kohëzimit.

Kontratat juridike që përmbajnë kushte të palejuara në Islam

Bashkim Aliu

HYRJJE

Kontratat janë gurthemel i marrëdhënieve ndërmjet njerëzve, qofshin këto marrëdhënie të karakterit ekonomik, tregtar, civil apo të ndonjë karakteri tjetër. Në të drejtën islame, kontratat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të fushës së “*m u a m e l a t e v e*” - marrëdhënieve ndërnjerëzore, dhe në këtë drejtim liria e kontraktimit paraqet parimin bazë në legjislacionin islam. Megjithatë, liria e kontraktimit në legjislacionin islam nuk paraqet parim absolut, i cili nuk i nënshtrohet asnjë rregulli dhe kushti, por kontratat u nënshtrohen rregullave dhe kushteve të cilat synojnë të sigurojnë kornizë ligjore stabile që do t'i mbrojnë ato nga padrejtësitë, jo transparenca dhe dëmtimi i palëve. Në këtë kontekst, një hapësirë meritore në legjislacionin islam, zënë edhe kushtet që i shoqërojnë kontratat, si: kushtet bazë nga të cilët varet vlefshmëria e kontratës, kushtet që e prekin esencën e kontratës dhe ato që nuk e prekin esencën e kontratës, kushte që e dëmtojnë apo e favorizojnë njëren palë, etj.. Marrë parasysh se kuadri ligjor i Islamit në përgjithësi ka lejesa, ndalesa, preferenca dhe gjëra jo të pëlqyeshme, këtij kuadri i nënshtrohen edhe kontratat, ashtu që

Kushtet në kontrata në përgjithësi, dhe në kontratën e shitblerjes në veçanti, janë të shumta dhe u takojnë kategorive të ndryshme, dhe për të gjitha kategoritë e kushteve të kontratave, vlejné dispozita adekuate.

vlefshmëria e kontratave varet nga përmbajtja e kushteve të ndaluara apo jo të vlefshme, gjegjësisht kushteve që janë të pa pranuar në legjislacionin islam.

ZBATIMI I KONTRATAVE

Zbatimi i kontratave dhe përmbushja e kushteve është kategori fetare e rrënjëzuar në burimet bazë të Islamit: Kuran dhe Sunet. Në Kuran qëndron: “O ju që besuat! Zbatoni premtimet (obligimet)...”¹ Kushtet në kontrata në përgjithësi, dhe në kontratën e shitblerjes në veçanti, janë të shumta dhe u takojnë kategorive të ndryshme, dhe për të gjitha kategoritë e kushteve të kontratave, vlejné dispozita adekuate. Kështu, ka kushte që janë pjesë përbërëse të kontratës, gjegjësisht që kërkohet nga kontrata, kushte që nuk kërkohen nga kontrata por është përcaktuar nga legjislacioni islam, kushte që bien ndesh me natyrën e kontratës dhe nuk sjell dobi për askënd, kushte që nuk kërkohen nga kontrata, nuk përshtaten nga kontrata, por sjell dobi për njëren palë.²

Por, ndodh që kontratat të përmbajnë edhe kushte jo valide, të cilat e influencojnë kontratën, ashtu që zbatimi i tyre do të ndikonte drejtpërdrejt në statusin ligjor të kontratës në të drejtën islame. Për rrjedhojë, juristët islamë kanë debatuar rreth validitetit



të kontratës në rast se shoqërohet me kushte, të cilat bien ndesh me parimet e legjislacionit islam për kontratat.

Dy qëndrime gjenerale në lidhje me kushtet e kontratave

Në lidhje me kushtet e kontratave, ka dy qëndrime gjenerale për sa i përket aspektit parimor të kushteve në raport me kontratat.

Qëndrimi i parë: Parimisht, kushtet në kontrata janë të ndaluara, ashtu që lejohen vetëm ato kushte që janë përmendur në tekstet fetare dhe që i ka lejuar legjislacioni islam. Në krye të mbështetësve të këtij qëndrimi është shkolla dhahirite (literariste).³

Qëndrimi i dytë: Parimisht, kushtet në kontrata janë të lejuara. Më pas, mbështetësit e këtij qëndrimi parimor janë ndarë në dy tabore:

Kushtet në kontrata parimisht janë të lejuara pa kufizime, ashtu që çdo kusht që legjislacioni islam nuk e ka ndaluar, është i lejuar. Ky është qëndrimi i shkollës juridike hanbelite. Në veçanti është shquar Ibën Tejmije, i cili ka qenë shumë liberal në fushën e kushteve, duke i përjashtuar vetëm kushtet që tekstet fetare i kanë ndaluar.⁴

Kushtet në kontrata, në parim janë të kufizuara, ashtu që çdo kusht që bie në kundërshtim me legjislacionin islam ose natyrën e kontratës është i pavlefshëm. Çdo kusht tjetër që nuk është i kësaj natyre, është i vlefshëm. Ky është qëndrimi i hanefive, shafive dhe malikive. Këta dallojnë mes veti në lidhje me kriteret e vlefshmërisë së kushteve.⁵

Ebu Zehre thekson se mendimi i dytë është më fleksibil, më i gjerë dhe më i begatë në lidhje me kushtet, ndërsa Vehbe

Zuhejli dhe disa dijetarë të tjerë, janë të mendimit se qëndrimi i dytë ka përparësi të merret vetëm në kontratat financiare, por jo edhe në kontratën e martesës, ngase me këtë realizohen nevojat e njerëzve dhe merren parasysh interesat e tyre dhe zhvillimet e zakonit që shfaqen në kushte me zgjerimin e llojeve të kontratave.⁶

KUSHTET E PALEJUARA SIPAS LEGJISLACIONIT ISLAME NË KONTRATA

Juristët islamë kanë përdorur dy terme për kushtet jo të lejuara në kontrata: “fasid” dhe “batil”. Shkollat juridike islame kanë përkufizime për këto dy nocione, si dhe qëndrime të caktuara për pasojat që dalin nga këto kushte. Në përgjithësi, këto kushte trajtohen si jo valide sipas legjislacionit islam, duke e pasur parasysh dallimin në efektet dhe pasojat që i gjenerojnë për kontratat.

Kushtet “faside” (të prishura) në kontrata, janë kushte që kundërshtojnë thelbin e kontratës, e pengojnë atë, ose janë të ndaluara nga Sheriati.⁷ Ndërkaq, kushtet “batile” (të pavlefshme) janë kushtet që nuk i takojnë ndonjërit nga llojet e kushteve të sakta, nuk sjellin dobi për ndonjërin nga palët kontraktuese dhe as për ndonjë palë tjetër, por në to ka dëm për ndonjërin palë.⁸ Disa prej këtyre kushteve e prishin kontratën plotësisht, ndërsa disa të tjera e prishin vetëm kushtin, por jo kontratën, gjegjësisht **veprimi juridik mbetet i vlefshëm**, pavarësisht pavlefshmërisë së kushtit.

Kushte që e prishin kontratën tërësisht:



Caktimi i një afati të panjohur: si p.sh. të dakordohen shitblerësit për një afat të paqartë për dorëzimin e mallit ose pagesën e çmimit.

Kushti që bie ndesh me Sheriatin: si p.sh. kushti që përmban kamatë (riba) në rast vonese të pagesës.⁹

Kriteret e këtyre kushteve:¹⁰

Kushtet të cilët e prishin kontratën tërësisht, u nënshtrohen disa kriterëve, në të cilat kriteret shkollat juridike kanë dallime. Në vazhdim do t'i përmendim kriteret e këtyre kushteve.

Sipas hanefive, kriteret e kushteve që e prishin kontratën janë:

vendosja e një kushti që çon në një pasiguri (garar) të konsiderueshme,

ose vendosja e një kushti të ndaluar,

ose vendosja e një kushti që nuk e kërkon natyrë e kontratës dhe që sjell përfitim për njërin palë ose për objektin e kontratës,

dhe kur kushti nuk përputhet me qëllimin e kontratës,

as me atë që zakonisht praktikohet mes njerëzve,

dhe nuk ka dëshmi nga Sheriati që e lejon një gjë të tillë.

Kushte që nuk e prishin kontratën, por kushtin:

Kushti që bie ndesh me Sheriatin: si p.sh. kushti që përmban kamatë (riba) në rast vonese të pagesës.

Kushti që ndalon blerësin të disponojë mallin: p.sh. nëse shitësi i kushtëzon blerësit të mos e shesë mallin, sepse kjo bie ndesh me thelbin e kontratës së shitjes, e cila i jep blerësit të drejtën e disponimit.

Kushti i humbjes së mallit: p.sh. kushti që blerësi t'ia kthejë mallin shitësit nëse ai pëson humbje prej tij.

Kushtet e këtij lloji ndahen në **dy kategori**:¹¹

Kategoria e parë:

Veprimi juridik konsiderohet i vlefshëm vetëm nëse vendosësi i kushtit e heq atë. Këtë e kanë përmendur malikitë në kategoritë e kushteve të pavlefshme.

Kriteret e këtyre kushteve janë:


– vendosja e një kushti që bie ndesh me qëllimin e shitblerjes,

– ose cenon vlerën e çmimit,

– ose çon në pasiguri (garar) brenda një dhurate (hiba).

Bazuar në këto kriteret, rezultojnë tre lloje kushtesh:

1. Vendosja e një kushti që bie ndesh me qëllimin e shitjes. Nëse shitësi i vendos blerësit kusht që të mos e shesë apo dhurojë (sendin e blerë), e blerësi e heq kushtin, atëherë kontrata është plotësisht e vlefshme.



2. Vendosja e një kushti që cenon çmimin. Nëse një shitës ose blerës vendos kusht që përfshin hua (selem) nga pala tjetër, kjo sjell pasiguri në çmim për shkak të shtimit ose mungesës së vlerës. Nëse hiqet kushti, kontrata është e vlefshme.

3. Vendosja e një kushti që çon në pasiguri (garar). Kjo është në rastin e dhuratës: Dikush i jep një personi një kalë që ta përdorë për disa vite në luftë dhe vendos kusht që pranuesi t'i paguajë shpenzimet e mbajtjes, pastaj kali të mbetet pronë e tij. Kjo nuk lejohet për shkak të gararit-pasigurisë.

Kategoria e dytë:

Veprimi juridik konsiderohet i vlefshëm, si kur hiqet kushti, ashtu edhe kur nuk hiqet.

Kjo kategori përfshin:

– kushtet e pavlefshme, me të cilat kontrata mbetet e vlefshme sipas hanefive, – kushtet e pavlefshme, me të cilat kontrata mbetet e vlefshme sipas malikive, – kushtet e prishura (faside) që nuk prishin kontratën sipas shafiive dhe hanbelive.

REZYME PËR PASOJAT E KUSHTIT TË PAVLEFSHËM NË KONTRATA

Nga ajo që u përmend deri më tash, shihet se kushtet e pavlefshme në kontrata, i kanë edhe pasojat e tyre juridike për kontratat në kuptim të vlefshmërisë dhe zbatimit të tyre. Por, këto pasoja dallojnë varësisht prej llojit të kushtit që gjendet në kontratë. Kështu, nëse kushti është i pavlefshëm

dhe e prish kontratën, atëherë kontrata shfuqizohet tërësisht, si p.sh., në rastet kur kontrata përmban një kusht të pavlefshëm që e shkatërron atë.

Nëse kushti është i pavlefshëm, por nuk e prish kontratën, atëherë prishen vetëm kushtet, ndërsa kontrata mbetet e vlefshme, siç është rasti me kushtin që e ndalon blerësin ta shesë mallin. Në këtë rast, kushti është i pavlefshëm, por shitja mbetet e saktë.¹²

PËRFUNDIMI

Legjislacioni islam u ka kushtuar vend të rëndësishëm në njësitë e tij kontratave, vlefshmërisë, zbatimit dhe kushteve të tyre, ngase kontratat janë mekanizmi i zhvillimit të marrëdhënieve ndërnjerëzore në fusha të ndryshme, si dhe tipar dallues i marrëdhënieve ekonomike në çdo kohë, në veçanti në kohën bashkëkohore kur bota është shndërruar në një fshat të vogël dhe komunikimi tregtar dhe ekonomik, por edhe i natyrave të tjera mes njerëzve, është i mundshëm edhe në distanca të largëta. Për atë, legjislacioni islam e rregullon fushën e kontratave, jo për t'i kufizuar marrëdhëniet mes njerëzve, por për ta evituar mashtrimin, pasigurinë dhe padrejtësinë ndaj palëve kontraktuese. Për më tepër, ligjshmëria nuk është thjesht një operacion teknik, që lidhet me ligje dhe forma të caktuara, por nga kompatibiliteti me parimet etike dhe fetare, ngase e ndaluara në Islam nuk është thjesht vetëm një çështje me karakter formal juridik, por edhe një problem moral. Së këndejmi, zbatimi korrekt i parimeve të Sheriatit në kontratat bashkëkohore siguron një sistem të pastër ekonomik, më etik dhe më të drejtë, duke mbrojtur të dyja palët dhe shoqërinë në tërësi.

1 El Maide, 1.

2 Shih: Ibën el Humam, Muhamed ibën Abdilhamid, Fet'hul Kadir sherhul Hidaje, Darul Fikr, botimi i dytë, Bejrut, 1977, vëll.VI, f. 442; Ibën Kudame, Muvefekuddin Abdullah, El Mugnij sherhu muhtesartil Hurekij, El Mektebetul hadithe, Riad, 1401h, vëll. IV, f. 249.

3 Zuhajli, Vehbe, El Fikhul islamij ve edil-letuhu, ribotim i botimit të tretë, Darul Fikr, Damask, 1996, vëll. IV, f. 202.

4 Shih: Ibën Kudame, Abdullah, El Kafî fi fikhi Ibni Hanbel, pa botues, pa vit botimi, vëll. I, f.22. Po ashtu, shih: Ebu Zehre, Muhamed, El Milkijetu ve nedharijetul akdi fi esh sheri'atil islamijje, Darul Fikril a'rebij, Bejrut, 1976, f. 282.

5 Shih: Musa, Muhamed Jusuf, El Fikhul islamij, botimi i tretë, Darul kitabil Arabij, Kajro, 1957, f.415.

6 Zuhejli, Vehbe, po aty.

7 El Kasani, Alauddin Ebi Bekr ibni Mesud, Bedai'u es sanai'i fi tertibi esh shera'i, botimi i dytë, Darul Kitabil Arabij, Bejrut, 1982, vëll. II, f. 22.

8 Shih: Zuhejli, Vehbe, po aty, f. 204-205.

9 Po aty.

10 Shih për këto kushte: El Meusua'tul fikhije el kuvejtijje, Ministria e Vakëfeve dhe Çështjeve Islame, Kuvajt, 1992, vëll. XXVI, f.13-16, Zuhejli, Vehbe, po aty, f. 207-208.

11 Shih: El Meusua'tul fikhije el kuvejtijje, po aty.

12 Zuhejli, Vehbe, vep. e cit., f. 236-237.

Mësime dhe dobi nga leximi i ndodhisë së Israsë dhe Miraxhit

Muhamed B. Sytari

Më lejoni të vendos para duarve tuaja, në një formë të përmbledhur, hadithin kryesor të kësaj ndodhie të mrekullueshme, që është koleksionuar në librin e saktë të Imam Buhariut, si dhe disa detaje nga transmetimi i Ibni Mesudit (r.a), për të parë mrekullinë e Zotit ndaj të Dashurit të Tij, Hz. Muhamedit (a.s).

“Ngjarja e Israsë dhe Miraxhit ka ndodhur në muajin Rexheb të vitit 11 të dërgesës”¹

Resulullahu (a.s) tregon: “Më sollën Burakun, një kafshë e bardhë, që hidhte hapin, ku i përfundonte vështrimi. Hipa në të, derisa mbërrita në Bejtul-Makdis... “Aty gjeti Hz. Ibrahimin, Hz. Musain, Hz. Isain dhe shumë të dërguar të tjerë, të cilëve u priu në namaz”²

Kuptojmë prej kësaj se muslimani është prijës në shoqërinë e tij: fëmija i mirëedukuar në kopësht, nxënësi i udhëzuar në mësime, studenti elitari në universitet, inxhinieri në biznesin e tij, arkitekti në punën e tij, drejtuesi në marrëdhënie me nëpunësit e tij, imami me xhematin e tij, tamam sikurse na porositi i Dërguari: “...dhe secili prej jush do të llogaritet për përgjegjësinë e tij!”. Islami na fton të jemi elitë ne jetë! Ky është një mesazh shumë i rëndësishëm i ndodhisë së Israsë dhe Miraxhit!

“Pastaj dola. Më erdhi Xhibrili (a.s) me dy enë; njëra me verë dhe tjetra me qumësht. Unë zgjodha qumështin. Xhibrili tha: “Zgjodhe natyrën e pastër! [U udhëzove ti, u udhëzua ymmeti yt.]”³”

Ymeti islam është i udhëzuar deri në kiamet! Nuk ka fitne e përçarje, model ekstrem e cytje shejtani, tendencë rrëshqitjeje në fanatizëm të verbër a shfaqje terrorizmi, që

mund të rrëshqasë në të muslimani i udhëzuar; kurrësesi! Ky ymet është i udhëzuar deri në kiamet!

“Pastaj nisëm miraxhin (lartësimin) drejt qiellit, ku Xhibrili trokiti...

Kur u hap dera, u ngjitëm në qiellin e botës tonë, ku pashë një burrë të ulur; në të djathtë e në të majtë kishte disa forma shpirtrash. Kur sillte kokën djathtas, qeshte e, kur e sillte majtas, qante.

Më tha: Mirë se erdhe, o lajmëtar i mirë, o djalë i mirë! E pyeta Xhibrilin: Kush është ky? Tha: Ademi (a.s). Ndërsa këto





forma shpirtrash djathtas e majtas tij, janë shpirtrat e fëmijëve të tij; në të djathën e tij, banorët e xhennetit dhe në të majtën e tij, banorët e xhehnemit”.

“Pastaj u ngjitëm derisa erdhëm në qiellin e dytë. Trokiti. Dikush tha: Kush është? Tha: Xhibrili jam. Pyeti: Kush është me ty? (Xhibrili) Tha: Muhamedi! Pyeti: A është dërguar? (Xhibrili) Tha: Po! Ia ktheu: Mirë se ka ardhur, në vendin më të mirë ka ardhur! Dhe, e hapi derën.

Kur kaluam, pashë Jahjanë dhe Isain, dy djem tezeshe. (Xhibrili) Më tha: Këta janë Jahjai dhe Isai, jepu selam. U dhashë selam. Ma kthyen, pastaj thanë: Mirë se vjen, o vëlla i mirë, o lajmëtar i mirë!

Pastaj u ngjitëm në qiellin e tretë. Trokiti. Dikush tha: Kush është? Tha: Xhibrili jam. Pyeti: Kush është me ty? (Xhibrili) Tha: Muhamedi! Pyeti: A është dërguar? (Xhibrili) Tha: Po! Ia ktheu: Mirë se ka ardhur, në vendin më të mirë ka ardhur! Dhe, e hapi derën.

Kur kaluam, pashë Jusufin. (Xhibrili) Më tha: Ky është Jusufi, jepi selam. I dhashë selam. Ma ktheu, pastaj tha: Mirë se vjen, o vëlla i mirë, o lajmëtar i mirë!

Pastaj u ngjitëm në qiellin e katërt. Trokiti. Dikush tha: Kush është? Tha: Xhibrili jam. Pyeti: Kush është me ty? (Xhibrili) Tha: Muhamedi! Pyeti: A është dërguar? (Xhibrili) Tha: Po! Ia ktheu: Mirë se ka ardhur, në vendin më të mirë ka ardhur! Dhe, e hapi derën.

Kur kaluam, pashë Idrisin. (Xhibrili) Më tha: Ky është Idrisi, jepi selam. I dhashë selam. Ma ktheu, pastaj tha: Mirë se vjen, o vëlla i mirë, o lajmëtar i mirë!

Pastaj u ngjitëm në qiellin e pestë. Trokiti. Dikush tha: Kush është? Tha: Xhibrili jam. Pyeti: Kush është me ty? (Xhibrili)

Tha: Muhamedi! Pyeti: A është dërguar? (Xhibrili) Tha: Po! Ia ktheu: Mirë se ka ardhur, në vendin më të mirë ka ardhur! Dhe, e hapi derën.

Kur kaluam, pashë Harunin. (Xhibrili) Më tha: Ky është Haruni, jepi selam. I dhashë selam. Ma ktheu, pastaj tha: Mirë se vjen, o vëlla i mirë, o lajmëtar i mirë!

Pastaj u ngjitëm në qiellin e gjashtë. Trokiti. Dikush tha: Kush është? Tha: Xhibrili jam. Pyeti: Kush është me ty? (Xhibrili) Tha: Muhamedi! Pyeti: A është dërguar? (Xhibrili) Tha: Po! Ia ktheu: Mirë se ka ardhur, në vendin më të mirë ka ardhur! Dhe, e hapi derën.

Kur kaluam, pashë Musain. (Xhibrili) Më tha: Ky është Musai, jepi selam. I dhashë selam. Ma ktheu, pastaj tha: Mirë se vjen, o vëlla i mirë, o lajmëtar i mirë!

Kur mora të largohem, ai nisi të qante. I thanë: Pse po qan? Tha: Po qaj, sepse një djalë i ri (pra, Hz. Muhamedi (a.s.) -shënim imi. M.S.-) është dërguar pas meje, në xhenete do të hyjnë më shumë nga ymeti i tij sesa nga ymeti im!”

(Autori shpjegon – shënim imi. M.S.-), Qante nga gëzimi për këtë të Dërguar të nderuar, pajja e Allahut qoftë mbi të!

Pastaj u ngjitëm në qiellin e shtatë. Trokiti. Dikush tha: Kush është? Tha: Xhibrili jam. Pyeti: Kush është me ty? (Xhibrili) Tha: Muhamedi! Pyeti: A është dërguar? (Xhibrili) Tha: Po! Ia ktheu: Mirë se ka ardhur, në vendin më të mirë ka ardhur! Dhe, e hapi derën.

Kur kaluam, pashë Ibrahimin. (Xhibrili) Më tha: Ky është Ibrahim, babai yt, jepi selam. I dhashë selam. Ma ktheu, pastaj tha: Mirë se vjen, o djalë i mirë, o lajmëtar i mirë!”

Ndërsa në transmetimin e Tirmidhiut, nga Hz. Abdullah ibn Mesudi (r.a): “Takova Ibrahimin natën e Israsë dhe më tha: O Muhamed, bëji salam ymetit tënd prej meje dhe lajmëroji se xheneti e ka tokën e mirë, ujin e ëmbël, është fushë e shtrirë, që mbillet me Subhanallah, me Elhamdu lillah, me La ilahe ilallah dhe me Allahu ekber!”⁴

A nuk është e udhës, që teksta lexojmë për takimin e Resulullahut (a.s.) me peygamberët më të zgjedhur të historisë dhe racës njerëzore, të mësojmë të lexojmë rolin e mrekullueshëm që ka muslimani në jetë, për të ftuar drejt harmonisë në mesin e popujve, besimeve, etnitetëve, kulturave dhe për të dhënë shembullin e tij elitar në hartën e madhe të diversitetit, ku “më fisniku tek Allahu, është më i ruajturi!”?

Në simbolikën e saj, ndodhia e Israsë dhe Miraxhit, detajet e së cilës janë të panumërta dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet dëshimit të saj në dy suret e zbritura në këtë përshpirtësi; sureja “El-Isra” dhe sureja “En-Nexhm”; dëshmon se “Muhamedi (a.s) është i dërguar i dy kibleve, imami i dy lindjeve dhe i dy perëndimeve, trashëgimtari i të dërguarve para tij, prijësi i brezave pas tij! Pasi, në personalitetin e Hz. Muhamedit (a.s), mbrëmjen e Israsë, u takua Meka me Kuds, Bejtul-Harami me Mesxhidi Aksanë. Aty, të dërguarit u falën pas tij, duke sinjalizuar kështu universalizmin e dërgesës së tij hyjnore, përjetësimin e imamatit të tij, humanizmin e mësimëve të tij dhe përshtatshmërinë e tyre me gjithë ndryshimet e vendit dhe kohës.”⁵

Israja dhe Miraxhi erdhën si përforsim i Hz. Muhamedit (a.s) në rrugën e tij të mundimshme të thirrjes, në edukimin e brezave me dritën e udhëzimit hyjnor dhe begatitë e fesë së Allahut; ISLAMIT!

Më lejoni të vendos para duarve tuaja disa detaje me shumë rëndësi në jetën e të Dashtunit tonë (a.s.), para ndodhisë së Israsë dhe Miraxhit.

Dy janë personazhet e palës idhujtare që spikasin me arrogancën e tyre kundër Resulullahut (a.s), Ukbe ibn Ebi Muajit dhe Ebu Xhehl ibni Hisham.

I pari, arriti deri në atë gradë sa ta thojë shehadetin në tallje, por jo vetëm..., natën kur i dërguari mori pjesë në gostinë e shtruar nga Ukbe, me rastin e martesës së të birit.⁶

Ndërkohë, Ebu Xhehli, një ditë teksa Resulullahu (a.s) falej para Qabes së Madhnueshme, urdhëroi dikë që kur i Dërguari të shkonte në sexhde, t’i hidhte mbi

shpinë e kokë të brendshmet e disa deveve të therrura një ditë më parë, dhe ashtu u veprua.⁷

Ibni Is’haku tregon se pasi vdiq Ebu Talibi, kurejshët nisën ta lëndonin shumë Resulullahun (a.s), sa një ditë, njëri prej tyre i hodhi një grusht dhë mbi kokë. Ashtu në atë gjendje, i dërguari hyri në shtëpinë e tij dhe tekta e bija, që qante nga kjo pamje, i pastronte kokën, ai (a.s), i thoshte: “Mos qaj moj bijë, se Allahu e ruan babën tënd!”⁸

PËRTEJ HORIZONTEVE...

Diku, në një qytet të quajtur Taif (rreth 80 km larg Mekës), një burrë i heshtur, që kishte kaluar pragun e të pesëdhjetave nga vitet e jetës së tij, me këmbë të gjakosura dhe me frymën e lodhur nga përballja me arrogancën e idhujtarisë dhe injorancën e mosdijes, u ul të pushonte nën hijen e ca pemëve...

I shoqëruar edhe nga Zejd ibni Harithe, u largua nga vendlindja drejt një realiteti tjetër, me shpresë së dikush do të udhëzohej në besimin e Njësisë së Zotit! Fillimisht trokiti në dyert e zotërinjve të Taifit, Abd Jalejl, Mesud dhe Habib, të bijtë e Amr ibn Umejr Thekafit.

I pari i tha: “Unë e shqyq mbulesën e Qabes, nëse Allahu të ka dërguar ty si lajmëtarin e Tij!”

I dyti i tha: “A nuk ka gjetur Allahu dikë tjetër pos teje që ta dërgojë për lajmëtar?!?”

I treti, nuk denjoi as ta priste, por i nxori një nga shërbëtorët e tij dhe i tha: “Nëse ti je lajmëtar, nuk i takon një njeriu si unë të flasë me lajmëtarë të Zotit. E, nëse je mjeran, një si unë nuk denjon të flasë me mjeranë!”⁹

Pasi kërkoi prej tyre ta lejonin qoftë edhe të jetonte i izoluar në mes tyre, t’u mësonte fenë e All-llahut njerëzve përreth, ata e refuzuan dhe urdhëruan fëmijët ta gjuanin me gurë, derisa i ra të fikët. Nuk u mjaftuan me kaq, e kapën për krahësh dhe vazhduan ta godisnin e ta gjuanin, sa i rrodhi gjak nga koka tek këmbët...

Ishte i lodhur, i mërziur. Çfarë nuk kishte kaluar mbi supet e tij në këto dhjetë vite... Por, zemra e tij rrihte mëshirë dhe falje, urtësi dhe dashamirësi të pakufijshme për krijesat e Zotit...

E, përtej lodhjes, mërzi, dhembjeve të trupit, që lëngonte goditjet e gurëve, sharjet dhe fyerjet e panumërta, i përqendruar në një qëllim dhe një pikësynim, me kokën e ulur dhe duart drejt qiellit, nisi të mërmëriste këto fjalë: “Allahume, Ty po të ankohe për dobësinë time, për mungesën e rrugëve, për

“O Allahu im,
Ty po të
ankohem për
dobësinë time,
për mungesën
e rrugëve, për
përcëimin
nga njerëzit. O
Mëshiruesi i
mëshiruesve,
Ti je Zoti i të
dobësuarve, Ti
je Zoti im! Në
dorën e kujt
po më lë?...”



përçmimin nga njerëzit. O Mëshiruesi i mëshiruesve, Ti je Zoti i të dobësuarve, Ti je Zoti im! Në dorën e kujt po më lë?...

Nëse Ti nuk je i zemëruar me mua, hiç nuk pyes...¹⁰

Pra, pas sa e sa mundimesh e durimi të pashembullt në rrugën e Thirrjes Islame, Allahu i Madhëruar i dëshmoi Resultit të Tij dhe krejt njerëzimit se, “Allahu është me durimtarët” dhe se pas errësirave të natës, domosdo do të agojë dita e re dhe rrezet e diellit do të përhapin dritën gjithandej!

Ndaluni pak të meditojmë: Resulullahu (a.s.) nuk u dëshpërua nga mundimet dhe përbuzja, nga shkëlja e të drejtave dhe persekutimi, porse udhëtoi drejt një tjetër vendi dhe një tjetër realiteti shoqëror, për të ftuar njerëzit në besim.

A e kemi marrë mundin ne sot, të udhëtojmë brenda realiteteve të familjes, shoqërisë e rretheve fafeshnore, për të ftuar njerëzit tanë në besim, në pastërtinë e fesë, në lartësinë e saj, drejt shkallëve të larta të drejtësisë, dijes, solidaritetit në të mirë e në të keq, bujarisë, altruizimit, bamirësisë?

Me fjalë të tjera, a e marrim mundin të ndjekim gjurmët e Resulullahut tonë (a.s.) për të përhapur të mirën dhe paqen në shoqërinë tonë, që përpëlitet sot, në dilemat e mëdha të identitetit dhe pamjes reale të Islamit, që herë i paraqitet si shkatërrimtar, herë si prapanik, herë si ekstrem e herë si devijim, herë si humbje e herë si distancim nga rrënjët e qytetërimit dhe zhvillimit të mendjes dhe natyrës njerëzore?!

Israja dhe Miraxhi erdhën si përforcim i Hz. Muhammedit (a.s.) në rrugën e tij të mundimshme të Thirrjes, në edukimin

e brezave me dritën e udhëzimit hyjnor dhe begatitë e fesë së Allahut; ISLAMIT!

Atë natë, zemra e tij u mbush pafundësisht me dritën e pashuar të mbështetjes hyjnore, tamam si atë ditë, kur melekët i hapën gjoksin dhe ia mbushën me nurin e besimit dhe dashninë e Zotit!

Atë natë, iu dhurua amaneti më i shtrenjtë dhe garancia e përjetshme e lidhjes së qiellit me tokën dhe anasjelltas; namazi i pesë kohëve ditore!

Atë natë, u vulos mirësia dhe u derdhën bekime pafund për Pejgamberin tonë dhe ymetin islam, deri në ditën e kiametit!

Atë natë, teksa kthehej me pesë namazet e ditës, si rrugë e pambyllur drejt kërkimit të mëshirës dhe Dritës së Zotit në jetën tonë, fjalët e Krijuesit, ishin ngulitur thellë në zemrën e tij (a.s.), do ua thoshte më pas edhe sahabëve dhe mbarë botës: “O Muhamed, këto janë pesë namaze, për çdo ditë dhe natë. Secili namaz do të shumëzohet me dhjetë, pra pesëdhjetë namaze...¹¹”

Sa bukur e shkruan Hoxha i jonë, Shejh Vehbi Sulejman Gavoçi, se ai burrë i madh, që “një vit më parë, fëmijët e Taifit, qenë rreshtuar në të dy anët e rrugës dhe me gurë në duar, qëllonin këmbët e tij (a.s.), teksa largohej prej aty për në vendin e vet, sot, pas një viti, po i rreshtoheshin Pejgamberët (a.s.), atje në Kuds, me dhjetra të dërguar, të cilët po e prisnin me gëzim dhe donin të faleshin pas tij...¹²”

Teksa lexojmë në historinë e Ibn Hishamit, mbi mrekullinë e Israsë dhe Miraxhit, sipas transmetimit të Ibn Mes’udit

(r.a), vëmendja përqendrohet edhe tek kthimi i Resulullahut (a.s.) nga takimi i tij me Zotin e botëve, ku u obligua me faljen e 50 namazeve ditore.

Thotë Resulullahu (a.s.): “Dhe u ktheva. Kur kalova pranë Musait, të birit të Imranit, miku juaj i dashur, më pyeti se sa namaze m'u obliguan. I thashë: “Pesëdhjetë namaze ditore.” (Musai) Tha: “Namazi është i rëndë dhe ymeti yt janë të dobët, prandaj kthehu tek Zoti yt dhe kërkoji lehtësim për vete dhe për ymetin tënd!”

U ktheva tek Zoti im dhe i kërkoja lehtësim për vete dhe për ymetin tim. Më lehtësoi me dhjetë (namaze). U largova dhe kalova pranë Musait, i cili më tha të njëjtat fjalë dhe u ktheva sërish tek Zoti im. Më lehtësoi me dhjetë të tjera. Sërish u ktheva dhe më tha të njëjtat fjalë. U ktheva tek Zoti im, që më lehtësoi edhe me dhjetë të tjera, deri sa përfundoi në pesë namaze. Pastaj u ktheva tek Musai, i cili më kërkoi sërish të kthehem tek Zoti im dhe të kërkoj lehtësim. I thashë: Jam kthyer disa herë tek Zoti im dhe më ka lehtësuar, sa më erdhi turp prej Tij. Nuk kthehem më!”¹³

Këto pesë namaze, ndonëse u lehtësuan nga pesëdhjetë të tilla në origjinën e obligueshmërisë, por ato do ta kenë shpërblimin e dhjetëfishuar tek Allahu i Madhëruar, që tha: “O Muhamed, këto janë pesë namaze, për çdo ditë dhe natë. Secili namaz do të shumëzohet me dhjetë, pra pesëdhjetë namaze...”¹⁴

A nuk na e ka vërtetuar Resulullahu (a.s.) këtë mirësi të namazit, kur ka thënë: “Shembulli i pesë namazeve ditore, është si shembulli i një lumi të pastër e të rrjedhshëm në derën e secilit prej jush, ku ai lahet pesë herë në ditë. Si mendoni, sa papastërti do të mbetet në trupin e secilit? – Thanë: Asgjë, o i dërguar i Allahut! Tha: Namazet i pastrojnë gjynahet, siç i pastrojnë uji papastërtitë!”¹⁵

Po! Sepse, ai që falet me rregull, duke e kontrolluar mbikqyrjen e Allahut në jetën e tij, flet pak dhe ruhet nga thashethemet. Nuk gënjen, nuk mashtron, nuk bie në pesimizëm, nuk dorëzohet në jetë, është këmbëngulës në realizimin e të mirës, e ndalon të keqen me kurajo dhe me kënaqësi, nuk fyen, nuk shan, nuk mallkon, e ruan pastërtinë e jashtme, pasi është mësuar të mbajë pastër zemrën, të cilën ia ka dorëzuar Allahut Mëshirëbërës me vullnet e me kënaqësi.

Dëgjoni se sa bukur e përshkruan Allahu i Madhëruar, në një hadith kudsi, marrëdhënien e Tij me njeriun që falet. Thotë (xh.sh): “E kam ndarë namazin, në mes Meje dhe robit Tim, në dy pjesë. Dhe robi Im, do të marrë atë që kërkon. Kur robi Im thotë: “Elhamdu lil-lahi rabbil-alemine”¹⁶, Allahu thotë: “Më falënderoi me lavde, robi Im”. Kur robi thotë: “Er-Rrahmanirr-Rrahim”¹⁷, Allahu thotë: “Më lavdëroi robi Im”. Kur robi thotë: “Maliki jeumid-din”¹⁸, Allahu thotë: “Më madhëroi robi Im”. Kur robi thotë: “Ijjake na'budu ve ijyake

nestein”¹⁹, Allahu thotë: “Kjo është në mes Meje dhe robit Tim dhe, robi Im do të ketë atë që kërkon”. Kur robi thotë: “Ihdinas-siratal-mustekim, siratal-ledhine en'amte alejhim gajril-magdubi alejhim ve led-dal-lin”²⁰, Allahu thotë: “Kjo është e robit Tim dhe robi Im do të ketë atë që kërkon”²¹

Prandaj, të parët tanë, që e kuptuan drejtë vlerën e namazeve ditore në raport me jetën e përditshme dhe mundësinë e gabimit dhe rrëshqitjes në gjynahe, ishin të rregullt dhe të disiplinuar me namazet ditore.

Transmetohet se, kur hynte koha e namazit, Hz. Ebu Bekri (r.a) thoshte: “Ngrihuni drejt zjarreve, që keni ndezur dhe fikini!”²² Pra, ngrihuni në namaz, që ju pastrojnë nga gabimet dhe gjynahet, që janë si zjarri që djeg!

- 1 Dr. Mervan Shejkhulerd, “Es-siretun-nebevijje”, botimi i parë, Damask, 2003, vëll. i 1-rë, f. 275, duke u bazuar në historinë e Dehlanit, në fusnotat e Sirres El-Halebijje, 1/322.
- 2 Transmetimi i Ibn Mesudit (r.a), si të Ibn Hishami, “Es-siretun-nebevijje”, botimi i 4-t, Bejrut, 1999, vëll. i 2-të, f. 30.
- 3 Transmetimi i Ibn Mesudit (r.a).
- 4 Shejh Abdullah Siraxhudin, “Leksione rreth Israsë dhe Miraxhit”, botimi i parë, Damask, 2005. Hadithin e transmeton Imam Buhariu, nga Ebu Dherri (r.a.).
- 5 Es-Sejid Ebul-Hasen Ali El-Haseni En-Nedvi, “Es-siretun-nebevijje”, botimi i 12-të, Damask, 2004, f. 218-219.
- 6 Muhamed El-Habesh, “Siretu Resulillah”, Damask, 1996, f. 84
- 7 Po aty, f. 84-85.
- 8 Safijjurrhman El-Mubarekfuri, “Siretu Resulillah”, Bejrut, 1997, f. 118.
- 9 Muhamed Rida, “Muhamedun Resulullah”, Bejrut, pa vit botimi, f. 136-137.
- 10 Dr. Mervan Shejkhulerd, “Es-siretun-nebevijje”, botimi i parë, Damask, 2003, vëll. i 1-rë, f. 268, duke u bazuar në historinë e Ibn Hishamit.
- 11 Transmetuar nga Imam Buhariu, nga Enes ibn Malik (r.a) dhe Malik ibn Sa'sa' (r.a).
- 12 Vehbi Sulejman Gavoçi, “Muhammedi alejhisselam – Jeta dhe vepra”, LOGOS-A, Shkup, 2011, f. 117.
- 13 Ibn Hisham, “Es-siretun-nebevijje”, botimi i 4-t, Bejrut, 1999, vëll. II, f. 37-38.
- 14 Transmetuar nga Imam Buhariu, nga Enes ibn Malik (r.a) dhe Malik ibn Sa'sa' (r.a).
- 15 Transmetuar nga Muslimi, nga Xhabiri (r.a).
- 16 Përkthimi i kuptimeve të sures “El-Fatiha”, që në versionin shqip, nga prof. Hasan I. Nahi, vjen kështu: “Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve”
- 17 “të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit”.
- 18 “Sunduesit të Ditës së Gjykimit”.
- 19 “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”.
- 20 “Udhëzoni në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!”.
- 21 Transmetuar nga gjashtë imamët kryesorë, përveç Buhariut, nga Ebu Hurejra (r.a). Si në koleksionin e Ebu Abdurrahman Kemal ibn Besjuni El-Ebjani, “Mu'xhem el-ehadithil-kudsijetis-sahihati ve meaha el-erbaunel-kudsije li Mola Ali”, botimi i parë, Bejrut, 1993, f. 316-317.
- 22 Ebu Hamid El-Gazali, “Ihju ulumidin”, botimi i parë, Bejrut, 2000, vëll. 1, f. 201.

Vlera e Natës së Beratit dhe mesazhet e saj

NATA E MËSHIRËS, FALJES DHE PASTRIMIT SHPIRTËROR

Ajet Aliu

Muaji Shaban është një ndër muajt më me vlerë në kalendarin islam, i cili ndodhet në mes të muajit Rexheb dhe Ramazan. Në zemër të këtij muaji qëndron nata e njohur në kulturën tonë islame shqiptare si Nata e Beratit. Ky emërtim vjen nga fjala arabe “*Bera’ë*”, që do të thotë pafajësi, falje, pastrim, shpëtim etj.. Kjo natë përjetohet si një moment i veçantë faljeje, mëshire dhe pastrimi shpirtëror. Pikërisht këto tri elemente përmbledhin thelbin dhe vlerën e kësaj nate të veçantë. Kjo natë për shumë breza ka qenë një fanar drite që i fton besimtarët drejt përmirësimit të vetvetes dhe pajtimit me njëri-tjetrin.

NATË E MËSHIRËS PËR MBARË KRIJESAT

Nata e Beratit konsiderohet një ndër netët më të begata të vitit pas natës së Kadrit. Kjo natë është cilësuar si natë e mëshirës së gjerë, e cila mbulon gjithë umetin e Pejgamberit Muhamed a.s.. Besimtari e kupton se mëshira e Allahut është burimi i çdo shprese në jetë. Në këtë natë, njeriu e gjen veten përgjatë rrugës midis frikës dhe shpresës, frikës nga gabimet e së kaluarës, por edhe shpresës se Zoti e fal çdo mëkat kur pendimi është i

Ky emërtim vjen nga fjala arabe “Bera’ë”, që do të thotë pafajësi, falje, pastrim, shpëtim etj.. Kjo natë përjetohet si një moment i veçantë faljeje, mëshire dhe pastrimi shpirtëror. Pikërisht këto tri elemente përmbledhin thelbin dhe vlerën e kësaj nate të veçantë.

sinqertë. Çdo zemër që rreh me sinqeritet, çdo sy që loton nga pendimi dhe çdo gojë që shqipton istigfar në këtë natë, gjen paqe dhe mbështetje hyjnore. Një numër transmetimesh profetike theksojnë se, në këtë natë, Allahu i Madhëruar e përshkon me mëshirë gjithë krijimin dhe ua fal mëkatet atyre që i drejtohen Atij sinqerisht. Transmetohet nga Ebu Musa el Eshariu se Muhamed a.s., ka thënë: “Allahu shikon krijesat e Tij në natën e mesit të Shabanit dhe fal çdo besimtar, përveç atij që është mushrik dhe atij që mban armiqësi ndaj të tjerëve!”¹ (Ibën Maxhe). Gjithashtu transmetohet nga nëna e besimtarëve, Aisheja r.a., se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Vërtet Zoti i Madhëruar zbret (mëshirën, faljen) natën e mesit të Shabanit në qiellin e dynjasë dhe falë më shumë sesa flokët e bagëtisë të fisit Kelb!”² (Tirmidhiu). Këto hadithe, por edhe shumë të tjera të kësaj natyre, na tregojnë se mëshira e kësaj nate është aq e gjerë, saqë përfshin çdo besimtar që i drejtohet Allahut me pendim të sinqertë. Në këtë natë, siç transmetohet, Allahu i Lartësuar i thërret robërit e Tij deri në agim: “A ka ndonjë që kërkon falje, që ta fal? A ka ndonjë që kërkon risk, që t’ia jap? A ka ndonjë të sprovuar që t’i lehtësoj gjendjen e tij?”³ (Ibën Maxhe). Kjo thirrje hyjnore, e



cila zgjat deri në agim, e bën këtë natë një dritare të rrallë mëshire dhe faljeje. Njeriu që e kalon në adhurim, në istigfar dhe në lexim Kurani, ngre veten shpirtërisht dhe afrohet te Zoti i tij më shumë se në çdo natë tjetër të zakonshme.

Natë e gjallërimit të adhurimeve

Një ndër muajt të cilin Pejgamberi a.s. e ka dalluar me adhurim është edhe muaji Shaban, në të cilin ndodhet nata e Beratit. Në këtë muaj ngrihen veprat tek Allahu i Madhëruar, siç transmetohet nga Usume bin Zejdi r.a., se ka thënë: “O i Dërguari i Allahut, nuk të kam parë të agjërosh në ndonjë prej muajve, ashtu siç agjëron në muajin Shaban.” Pejgamberi a.s. i tha: “Ky është një muaj ndërmjet Rexhebit dhe Ramazanit, të cilin njerëzit e shpërfillin. Në këtë muaj veprat i dorëzohen Zotit të botëve. Unë do të doja që të më ngrihen veprat e mia duke qenë agjërueshëm.”⁴ Mirëpo, natën e mesme të këtij muaji, e cila është ajka e këtyre netëve e ka dalluar me adhurime të shumta dhe të ndryshmet si: namaz nate, lexim të Kuranit, lutje, dhikër etj., ndërsa ditën e saj e ka pasuar me agjërim. Për të përfutur nga të mirat dhe begatitë e kësaj

Njeriu që e kalon Natën e Beratit me pendim, me adhurim, me istigfar, me lutje dhe me afrim tek Allahu, hyn në Ramazan me një zemër që tashmë është e përgatitur për devotshmëri.

nate, Pejgamberi a.s. ka kërkuar që edhe të tjerët nga umeti i tij ta gjallërojnë këtë natë me adhurime, ndërsa ditën e saj me agjërim, siç transmetohet nga udhëheqësi i besimtarëve, Ali bin ebi Talibi r.a., se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Nëse është nata e mesit të Shabanit, atëherë gjallëroni natën e saj dhe agjëroni ditën e saj...”⁵. (Ibën Maxhe).

Nata e Beratit është një nga momentet ku lutja e robit nuk refuzohet. Pejgamberi a.s., ka thënë: “Janë pesë kohë në të cilat duaaja e drejtuar Allahut xh.sh. nuk kthehet, dhe ato janë: secila natë që i paraprinë ditës së xhuma, nata e parë e muajit Rexheb, nata e gjysmës së Shabanit (pra, Nata e Beratit) dhe netët që iu paraprijnë dy ditëve të Bajrameve.”⁶ Pejgamberi a.s., në këtë natë, ishte i përkushtuar në lutje, siç rrëfen Aisheja r.a., se e pa një natë Pejgamberin duke u ngritur nga shtrati dhe duke dalë jashtë. Ajo e ndoqi me shqetësim, por kur e gjeti, ai ishte i përlulur në sexhde, duke thënë: “O Allah, unë kërkoj mbrojtjen Tënde nga dënimi Yt dhe kërkoj faljen e mirësisë Tënde.”⁷ (Ibën Huzejme). Ajo e pyeti se çfarë e kishte shtyrë të adhuronte kaq shumë, dhe Pejgamberi a.s., i tha: “Kjo është një natë në të cilën Allahu i shikon robërit e Tij dhe fal mëshirë më shumë sesa



numri i qimeve që kanë delet e fisit Kelb.”⁸ (Tirmidhiu). Ky është një shembull i qartë i përkushtimit të tij, sepse Pejgamberi a.s., e shihte këtë natë si mundësi për të kërkuar falje për veten, për umetin dhe për të gjithë njerëzit që kishin nevojë për mëshirë hyjnore.

Sahabët, duke parë vlerën dhe begatitë e shumta të kësaj nate, e shihnin veten si të ftuar në një mundësi të madhe që nuk duhej humbur. Prandaj, këtë natë e mbushnin me adhurime nga më të ndryshmet, si: namaz nate, lexim të Kuranit, istigfar, dhikër dhe me lutje të shumta. Enes bin Maliku transmeton: “Kur arrinte muaji Shaban, sahabët i përkushtoheshin leximit të Kuranit. Besimtarët në këtë muaj e ndanin zekatin e pasurisë së tyre dhe ua jepnin të varfërve, në mënyrë që duke pasur për syfyr e iftar, të kishin mundësi për të agjëruar, ndërkaq kadinjtë (gjqtarët) dhe məkëmbësit (gubernatorët) ose ua zvogëlonin dënimin ose edhe i amnistionin krejtësisht të burgosurit. Tregtarët i paguanin borxhet e tyre.”⁹

NATË E CILA PËRGATIT ZEMRËN PËR RAMAZAN

Nata e Beratit, vlera dhe rëndësia e saj vihet në pah edhe për faktin se kjo natë është sinjali i fundit hyjnor për ardhjen e muajit të bekuar Ramazan. Pra, nata e Beratit nuk shënon vetëm falje, mëshirë dhe afrimet me Allahun,

Pejgamberi a.s., për muajin Shaban, ka thënë: “Ky është muaj në të cilin njerëzit shpesh janë të pakujdesshëm, mes Rexhebit dhe Ramazanit. Në të ngrihen veprat (tek Allahu), dhe më pëlqen që veprat e mia të ngrihen duke qenë unë në gjendje adhurimi.”

por ajo është një thirrje hyjnore, që e fton njeriun të rregullojë raportin me Krijuesin e tij para se të hyjë muaji më i madh i adhurimit. Në këtë natë, Allahu i shikon robërit e Tij me mëshirë të gjerë, dhe kjo i kujton besimtarit se dera e pendimit, e përmirësimit dhe e kthimit te Zoti është e hapur para Ramazanit, në mënyrë që ky muaj të hyjë në një zemër që tashmë është e përgatitur.

Allahu xh.sh. na obligoi me agjërimin e Ramazanit në mënyrë që të bëhemi të devotshëm, por devotshmëria nuk nis në ditën e parë të Ramazanit, ajo fillon shumë më herët. Njeriu që e kalon Natën e Beratit me pendim, me adhurim, me istigfar, me lutje dhe me afrim tek Allahu, hyn në Ramazan me një zemër që tashmë është e përgatitur për devotshmëri. Kjo natë shtrin rrugën e devotshmërisë, e ndez dashurinë për adhurim dhe e zgjon zemrën që të hyjë në muajin e mëshirës me gatishmëri, sinqeritet dhe përlulesi. Adhurimet e kësaj nate e stërvitin besimtarin që të mos e ketë të vështirë të zgjohet natën në Ramazan për teravi, për lexim Kurani dhe për lutje, namaz nate e kështu me radhë. Stërvitja shpirtërore që fillon në këtë natë forcon qëllimin, shton dëshirën dhe e përgatit trupin dhe mendjen për adhurimet e gjata të muajit të mëshirës. Zemra që ndizet me adhurim para Ramazanit e shijon atë dyfish më thellë gjatë muajit të agjërimit.

Për ndërgjegjen e besimtarit, Nata e Beratit vjen si një ure lidhëse shpirtërore që e përgatit besimtarin për Ramazan. Pejgamberi a.s., për muajin Shaban, ka thënë: “Ky është muaj në të cilin njerëzit shpesh janë të pakujdesshëm, mes Rexhebit dhe Ramazanit. Në të ngrihen veprat (tek Allahu), dhe më pëlqen që veprat e mia të ngrihen duke qenë unë në gjendje adhurimi.”¹⁰ (Nesaiu). Kjo tregon se muaji Shaban është muaj reflektimi, ndërsa nata e mesit përbën kulmin e këtij reflektimi.

NATË E PASTRIMIT SHPIRTËROR

Një nga mesazhet më të rëndësishme të Natës së Beratit është pajtimi midis njerëzve dhe pastrimi i zemrës nga urrejtja, xhelozia dhe armiqësia. Vetë Pejgamberi a.s. ka theksuar se dy kategori njerëzish privohen nga mëshira e kësaj nate: idhujtarët dhe ata që

mbajnë armiqësi për vëllain e tyre mysliman. Dijetarët kanë shpjeguar se nuk ka ndonjë pengesë më të madhe për pranimin e adhurimeve sesa zemra e sëmurë nga urrejtja dhe konflikti.¹¹ Allahu në Kuran thotë: “Në ditën kur pasuria dhe fëmijët nuk do të bëjnë dobi, përveç atij që vjen tek Allahu me zemër të pastër...!” (Esh Shuara, 88-89). Zemra e pastër është zemra e pajtuar, që nuk mban urrejtje, smirë apo zemërim. Prandaj shumë dijetarë të hershëm e kalonin ditën para Natës së Beratit duke ndrequr marrëdhëniet shoqërore, duke kërkuar falje dhe duke falur.

Në fakt, pajtimi në këtë natë është një adhurim më vete. Kur njeriu fal një të afërm, një mik, apo edhe një njeri me të cilin ka pasur mosmarrëveshje, ai e pastron zemrën dhe e bën veten të denjë për mëshirën dhe faljen e Allahut.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Veprat i paraqiten Allahut çdo të hënë dhe të enjte, dhe Ai nuk fal dy njerëz që mbajnë mëri, derisa të pajtohen.”¹² (Muslim). Kjo tregon se pajtimi hap dyert e mëshirës, andaj në Natën e Beratit ai merr një rëndësi edhe më të madhe. Një familje, një shoqëri e tërë përmirësohet kur njerëzit falin njëri-tjetrin, sepse paqja dhe dashuria janë themelet e një umeti të fortë.

PËRFUNDIM

Nata e 15-të e muajit Shaban është një dhuratë e jashtëzakonshme. Një natë e cila nuk është thjesht një datë, por një udhëtim shpirtëror. Një udhëtim që nis me pendim, vazhdon me adhurim dhe përfundon me shpresë. Kjo natë është feneri që ndriçon rrugën drejt Ramazanit, urë që bashkon zemrën me Zotin, është hapja e derës së mëshirës për ata që kërkojnë dritë, paqe dhe udhëzim. Nata e 15-të e muajit Shaban nuk është thjesht një datë në kalendar. Ajo është një natë ku qielli i hapur pret lutjet, ku mëshira është e pafund dhe ku çdo njeri, pavarësisht gabimeve, ka mundësinë të fillojë një jetë më të pastër. Në këtë natë, çdo besimtar është i ftuar të ndalojë, të reflektojë, të pastrohet dhe të ringrihet shpirtërisht, ku drita e mëshirës hyjnore zbret dhe i mbush zemrat me shpresë.

- 1 Ibën Maxhe (1390), El Bejheki në “Shu’ab el Iman” (3553); nga Muhammed ibën Is’hak es Sagani. Ed Darakutni në “En Nuzul” (94) nga Er Rebi’ ibën Sulejman el Xhizi, dhe Ibën Asakir në “Tarih Dimeshk” (18/327) nga Humejd ibën Zenxhuvjeh; të gjithë (Es Sagani, Er Rebi’ dhe Ibën Zenxhuvjeh) nga Ebu el Esved en Nadr ibën Abd el Xhebbar, prej tij.
- 2 Tirmidhiu, 739. Is’hak ibën Rahavejh në Musnedin e tij (nr. 850, 1700); Ahmedi në Musned (nr. 26018); Abdu ibën Humejd (nr. 1509); Bejhekiu në “Shu’ab el Iman” (nr. 3543, 3545); dhe Darekutni në “En Nuzul” (nr. 89–91). Të gjithë e transmetojnë nga Haxhaxh ibën Arta’it, nga Jahja ibën Ebi Kethir, nga Urve, nga Aisheja.
- 3 Ibën Maxhe, 1388, El Fakihij në “*Akhbaru Mekkeh*” (3/84–85) nga El Hasan ibën Ali. Po ashtu e ka transmetuar Ibën Bishrani në “*El Emali*” (nr. 703) nga rruga e El Hasan ibën Ebi Ali en Nexhar; El Bejhekiu në “*Shu’ab el Iman*” (5/354, nr. 3542) nga Muhamed ibën Ali ibën Zejd es Saig; Ebu’l Kasim el Asbahani në “*Et Tergib we’l Terhib*” (nr. 1860) nga Ahmed ibën Muhamed el Bezzar; dhe El



Mezziu në “*Tehdhib el Kemal*” (33/107) nga Muhamed ibën Harun ibën Humejdi. Të gjithë këta e transmetuan nga El Hasan ibën Ali el Hulvani, me të njëjtin zinxhir.

- 4 Nesaiu në Sunen (2357 dhe 2358), Ahmedi 21703 nga Abdur-Rahman ibën Mehdij, Et Tahavi në “*Sherh Meanil- Ethar*” (2/ 82) nga Zejd ibën Sinan, Ed Darimij në “*Radd alal Xhehemije*” 91, El Bejhekiu në “*Shu’ab el Iman*” (3540)).
- 5 Është përmendur më lartë.
- 6 Ibën Asakiri në “*Tarikh Dimashk*” (6/312), Ibën Xheuzi në “*El Illel Mutenehijeh*” (2/560), Sujuti në “*Xhamius Sagir*” nr. 3952.
- 7 Ibën Huzejme, nr. 1139, Nesaiu në “*Sunenul Kubra*” nr. 10759, Ahmedi në Sunen nr. 25133.
- 8 Është përmendur më lartë.
- 9 Abdulla ibën Abdu Rrahman es Sead në “*Xhuzu fi Ehadith Lejlet en Nisf min Shaba*”, f. 61, Muhamed ibën Ahmed Amuh në “*Gajetul Bejan el Fda’il lejtu nisf min Shaban*”, f. 42,43,44, Ibën Rexheb në “*Letaiful Mean*” Darul Ifta Misrij, nr. i fetvasë 7469, më 13.03.2022.
- 10 Nesaiu në Sunen (2357 dhe 2358), Ahmedi 21703 nga Abdur-Rahman ibën Mehdij, Et Tahavi në “*Sherh Meanil- Ethar*” (2/ 82) nga Zejd ibën Sinan, Ed Darimij në “*Radd alal Xhehemije*” 91, El Bejhekiu në “*Shu’ab el Iman*” (3540)).
- 11 Muhamed ibën Ahmed Amuh në “*Gajetul Bejan el Fda’il lejtu nisf min Sha’ban*” f. 76.
- 12 Muslimi, nr. 2565, Ahmedi në Musned nr. 9251, Tirmidhiu, nr. 2023.

Gruaja mes joshjes për ekspozim dhe ftesës hyjnore

Zamira Bushati – Puka

Një ndër çështjet më të ngërthyera në diskutimet bashkëkohore është çështja e gruas. Diskutimet rreth saj janë të larmishme dhe dinamike, por në të shumtën e rasteve ato kanë të bëjnë më tepër me identitetin, rolin e saj në shoqëri, veshjen dhe paraqitjen publike, fuqinë kulturore dhe sociale të saj, etj..

Për sa i përket veshjes dhe paraqitjes së saj në publik, gruaja po përballet kryesisht me dy zëra të kundërt: një zë e fton atë drejt shfaqjes, ekspozimit, konkurrencës për imazh dhe shkëlqim të jashtëm, ndërsa tjetri, i cili është zëri i brendshëm, zëri i besimit e thërret atë drejt pastërtisë, thjeshtësisë dhe dhënies rëndësi jo vetëm fizikes por edhe shpirtërores.

Kjo gjendje, edhe pse është bërë pjesë e pandashme e jetës moderne, nuk është një dukuri e re, por ka ekzistuar edhe më parë. Thjesht, ajo që ka ndryshuar sot është intensiteti i joshjes dhe ritmi i saj, sidomos në kohën e ekraneve dhe rrjeteve sociale, ku gjithçka matet me pamje, imazh, ndjekës dhe aprovime/admirime nga të tjerët. Prandaj, gruaja po jeton në një fushëbetejë të padukshme, ku nuk luftohet me armë por me ide, me imazhe, modele e krahasime, që po ia dëmtojnë shpirtin dhe po e largojnë nga qëllimi kryesor i krijimit.

Ndërsa zëri tjetër është zëri i besimit, i cili zanafillën e ka te ftesa hyjnore. Ai e fton atë jo vetëm drejt thjeshtësisë së besimit, modestisë, ruajtjes së dinjitetit, por i mëson se vlera qëndron në atë se sa e nderuar dhe e lartësuar është tek Allahu, sa arrin ta ruajë pastërtinë e zemrës dhe sa fisnikërohet në moralin e saj.

Feja islame, duke respektuar vlerën e brendshme të gruas, e ka urdhëruar atë me veshjen e hixhabit. Hixhabi përbën një normativë juridike dhe hyjnore jo vetëm në Kuran, por edhe në fetë e tjera hyjnore, si në hebraizëm dhe krishterim. Kështu që, hixhabi nuk është shpikje e Islamit, por Islami vetëm sa e vijoi dhe mëshiroi këtë parim hyjnor.¹ Allahu xh.sh., në Kuran, thotë: “O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë mbulesën e tyre (të kokës) përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.” (El Ahzab, 59). Gjithashtu Ai thotë: “Mos i zbuloni hijeshitë tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes.” (El Ahzab, 33).

Si rrjedhojë, veshja e hixhabit, jo vetëm që është obligim hyjnor, por edhe identifikon gratë si myslimane që të dallohen me të. Jo vetëm kaq, por u tregon të tjerëve se përballë kanë një grua rigoroze, me moral dhe

Gruaja po jeton në një fushëbetejë të padukshme, ku nuk luftohet me armë por me ide, me imazhe, modele e krahasime, që po ia dëmtojnë shpirtin dhe po e largojnë nga qëllimi kryesor i krijimit.

integritet të lartë, e cila nuk mund të manipulohet qoftë me personalitetin apo edhe me imazhin e saj. Ajo e di punën e saj, i di vlerat që mbart, nuk është një lodër, nuk mund të ngacmohet, e nuk mund të luhet me të, por duhet ta merret shumë seriozisht që nga mënyra se si i mund t'i drejtohet kur të flitet me të.

Duke u nxitur jo vetëm nga media, hixhabi paragjykohet dhe sulmohet vazhdimisht. Ai paraqitet si simbol i prapambetjes së grave, edhe pse dihet mirë fakti se përparimi nuk ka qenë kurrë peng i veshjes apo i paraqitjes të jashtme të njeriut, por ka qenë produkt i studimeve, hulumtimeve dhe kërkimeve. Në realitet, hixhabi nuk e mbulon mendjen dhe përdorimin e inteligjencën e gruas, por ai mbulon bukuritë trupore dhe mbron privatësinë e saj.

Shpesh në trojet tona shqiptare hixhabi nga disa njerëz etiketohet si veshje arabe apo turke, kur realisht ai nuk i përket asnjë kombësie të veçantë, por është një normë veshjeje për myslimanet kudo në botë, çfarëdo kombësie të kenë. Ai paraqitet si “kufizim lirie” për gratë, por studimet bashkëkohore tregojnë, që për shumicën e grave myslimane, hixhabi nuk përfaqëson thjesht një normë veshjeje, por një **zgjedhje të vetëdijshme identitare**, e cila lidhet me besimin, dinjitetin personal dhe autonominë mbi trupin. Sociologja Alison Scott-Baumann thekson: “Edhe pse hixhabi i zemëron ata që këmbëngulin në lirinë e gruas për të shfaqur trupin e saj, unë propozoj që trupi, siç zbulohet aktualisht sipas modës perëndimore, është një mënyrë potencialisht e rrezikshme për të demonstruar feminitetin e dikujt dhe bazohet në një ideal lirie, që kryhet nga forca që ne duhet të jemi në gjendje t'i sfidojmë...”²

Edhe pse në disa shoqëri ekzistojnë stereotipe negative, literatura akademike thekson se problemi nuk qëndron te hixhabi, por te **diskriminimi kulturor dhe mungesa e edukimit ndërfetar**. Në këtë aspekt, hixhabi shërben si “test shoqëror” që tregon nivelin e tolerancës, pluralizmit dhe respektit për lirinë fetare në një shoqëri të caktuar. Studiuesja amerikane Rachel Anderson Droogsma, thekson se: “Hixhabi funksionon për të përcaktuar identitetin mysliman, për të kryer



Studimet bashkëkohore tregojnë, që për shumicën e grave myslimane, hixhabi nuk përfaqëson thjesht një normë veshjeje, por një zgjedhje të vetëdijshme identitare, e cila lidhet me besimin, dinjitetin personal dhe autonominë mbi trupin.

një kontroll sjelljeje, për t'i rezistuar objektifikimit, për të ofruar më shumë respekt.”³

Prandaj, sfida nuk qëndron te hixhabi si koncept, por te mënyra se si shoqëritë moderne e interpretojnë dhe e pranojnë diversitetin fetar. Në këtë kuptim, hixhabi mbetet jo vetëm një praktikë fetare, por edhe **një diskurs kritik ndaj standardeve reduktuese të modernitetit**.

Në shoqëritë e globalizuara, presioni për ekspozim vjen kryesisht nga industria e reklamave, media sociale dhe kultura vizuale hiperkomerciale, të cilat ushqehen nga kërkesat për ekspozim dhe vlerësim vizual. Prandaj ndikimet e veshjes ndaj mirëqenies nuk mund të vlerësohen jashtë kontekstit të imazhit të tregut dhe institucioneve kulturore, të cilat e bëjnë më se normale ekspozimin. Psikologja Barbara Fredrickson në teorinë e “vetë-objektifikimit” (self-objectification) argumenton se objektifikimi i vazhdueshëm çon në “vëzhgim të brendshëm të trupit”, e cila sjell një gjendje psikologjike, ku gruaja fillon të shohë veten me syrin e publikut dhe humbet kontaktin me perceptimin natyral të vetes. Kjo gjendje mund të rrisë mundësitë e grave për ankth, si dhe mund të çojë në rreziqe të shëndetit mendor, si depresioni unipolar...⁴

Ndërsa sociologia Alison Scott-Baumann, ekspozimin e gruas e sheh nga këndvështrimi i sjelljes amorale. Ajo thekson: “Në hapësirën laike ekziston një tendencë e pakontrolluar midis grave perëndimore për të besuar se autenticiteti ka të bëjë me arritjen e objektivave konsumatore, duke qenë dukshëm në modë dhe tërheqëse, që aktualisht do të thotë të veshësh gjithnjë e më pak rroba dhe të shfaqësh gjithnjë e më shumë lëkurë, ose të zbulosh format dhe dekolletetë përmes ngushtësisë së veshjeve. Do të ishte e kuptueshme të parashikohej sjellja e shthurur nga një kod i tillë veshjeje, i cili sugjeron se gruaja perëndimore mund të duket pa dashje si një ndotës, me të cilën kontakti është një rrezik.”⁵

Gjithashtu ajo argumenton se kultura e konsumit vjen si pasojë e mungesës së lirisë së zgjedhjes, kur thotë se, “kulturat e konsumit me siguri mund të konsiderohen si manifestuese të shtypjes përmes mungesës së zgjedhjes (sepse, paradoksisht, na jepen shumë zgjedhje, por çdo zgjedhje është brenda parametrave që na janë imponuar, asnjë nuk është e krijuar nga ne) dhe përmes konservatorizmit (siç shihet në mospëlqimin perëndimor ndaj hixhabit).”⁶

Diskutimet dhe debatet rreth të drejtës së mbajtjes së hixhabit janë fenomene që shfaqen në mënyrë të përsëritur, veçanërisht në vendet me popullsi myslimane, të cilat përballen me transformime të mëdha politike dhe kulturore. Këto debate marrin forma konkrete edhe në kontekste specifike kombëtare si rasti i Kosovës, me vendimin e Gjykatës Supreme, e cila ka refuzuar një padi që kërkonte leje për mbajtjen e shamisë në shkolla. Me këtë vendim, Gjykata Supreme e Kosovës, ka konfirmuar kompetencën e Ministrisë për të vendosur rregullat e uniformës.⁷ Vendimi ka nxitur një debat dhe tension të gjerë në sferën publike dhe sociale të Kosovës, ku komuniteti fetar dhe organizatat qytetare e shohin këtë vendim si kufizim të lirisë së besimit, që cenon të drejtat kushtetuese dhe të drejtat ndërkombëtare për liri fetare dhe arsimim, dhe si formë diskriminimi që godet veçanërisht nxënëset, që e mbajnë shaminë me bindje personale.⁸

Nga kjo situatë lindin disa pyetje: Përse në Kosovë, veçanërisht pas pavarësisë së saj, merret një vendim i tillë, ku sipas Censurit të

vitit 2024, statistikave të ASK-së, theksojnë se 93.49 % e popullsisë i përket besimit islam?⁹ Përse përdoret karta e “laicitetit të shtetit” sa herë që bëhet fjalë për një normë apo rit fetar islam? A mos vallë termi “uniformë shkollore”, po përdoret rastësisht për të kufizuar apo ndaluar mbajtjen e hixhabit nga vajzat myslimane në shkolla? Pse aktorët politikë frikësohen nga norma e “hixhabit”?

Nuk duhet të harrojmë se laicizmi, si koncept filozofik dhe model politik, ka lindur në Evropë gjatë periudhës së Iluminizmit¹⁰, si reagim ndaj dominimit të kishës në arsim, ligj dhe administrim. Në Evropë, ky laicizëm, pasi u shndërrua nga nocion filozofik në politikë shtetërore, solli një model ku feja trajtohej si çështje private. Kjo ideologji laike në disa raste mori një trajtë programore për sekularizimin e shoqërisë, ku modeli më tipik i nocionit “laicitet” është modeli francez.

Ndërsa, kur koncepti i laicizmit u importua në botën myslimane, ai hasi në një realitet historik tërësisht ndryshe nga Evropa, ngase në traditën politike islame nuk ka antagonizëm të brendshëm midis fesë dhe shtetit, por përkundrazi, pushtetin politik konceptohet si garantues i rendit dhe zbatues i drejtësisë, dhe si interpretues të ligjit hyjnor, pa konkurrencë institucionale.

Gjatë shekujve XIX–XX, në vendet me popullsi myslimane, u bënë përpjekje për të dobësuar autoritetin fetar, duke vendosur struktura laike në arsim, në gjyqësor dhe në administratë. Historiani Albert Hourani thekson se “modernizimi i imponuar nga jashtë në vendet arabe dhe turke e përdori sekularizmin si instrument për të riformatuar shoqërinë sipas modeleve perëndimore.”¹¹ Ky fenomen është përsëritur në shumë shtete myslimane, të cilat ishin nën sundimin kolonial perëndimor, si në Egjipt,¹² në Algjeri etj.. Analisti Frantz Fanon (1925-1961), në librin “Sociologie d’une Révolution”, e përkthyer në anglisht si “Një kolonializëm që vdes”, ka pohuar se zyrtarët kolonizator francezë në Algjeri kanë nisur një luftë kundër mbulesës që nga vitet 1930. Sipas tij, zyrtarët kolonialë francezë e shihnin mbulesën si barrierë midis shoqërisë së kolonizuar algeriane dhe asaj koloniale franceze, dhe besonin se kolonizimi nuk mund të ishte i plotë pa pushtuar gratë, gjë që përfshinte heqjen e mbulesës.¹³

Psikologia Barbara Fredrickson në teorinë e “vetë-objektifikimit” (self-objectification) argumenton se objektifikimi i vazhdueshëm çon në “vëzhgim të brendshëm të trupit”, e cila sjell një gjendje psikologjike, ku gruaja fillon të shohë veten me syrin e publikut dhe humbet kontaktin me perceptimin natyral të vetes.



Ky fenomen ka vazhduar edhe gjatë procesit të shtetformimit pas-kolonial, ku elitat “modernizuese”, të këtyre vendeve, shpesh kanë vazhduar të lexojnë “hixhabin” si pengesë për “integrimin” në modelin perëndimor të shtetit modern. Kjo gjë bëri që gruaja myslimane të përjetonte një formë tjetër presioni, jo më kolonial por shtetëror, ku “laicizmi” i imponuar e kufizoi të drejtën e saj për të shprehur identitetin fetar dhe moral. Në Turqi, reformat kemaliste pasi shfuqizuan kalifatin, nxitën “emancipimin e gruas” me braktisjen e mbulesës. Edhe në Iranin e epokës së Pahlavijve, “heqja me forcë e hixhabit të grave nga Reza Shah në vitet 1930 ishte pjesë e historisë bashkëkohore.”¹⁴

Këto tregojnë se në shumë vende me popullsi myslimane “laicizmi” është përdorur më shumë si instrument për të menaxhuar dhe kontrolluar fenë, jo për të garantuar lirinë fetare. Prandaj në këto vende, aktorët shtetërorë dhe disa elita laike e perceptojnë hixhabin jo thjesht si simbol fetar personal, por si potencial politik, shenjë identiteti e pavarësie.

Nga sa parashtruar më lart, do vërejmë se kjo që po ndodh në Kosovë, në lidhje me hixhabin nuk është një çështje e re, por është një fenomen i përsëritur historikisht në vende të ndryshme, që nga koha koloniale e deri në epokën postmoderne të mediave vizuale. Vërehet se çështja e veshjes së gruas vihet në qendër të debateve, sa herë që duhen zhvlerësuar strukturat tradicionale.

Si përfundim, debati mbi veshjen e gruas, veçanërisht mbi hixhabin nuk është thjesht një çështje veshjeje apo një konflikt mes traditës dhe modernitetit, por një nyje komplekse ku ndërthuren identiteti, liria, pushteti, morali dhe mënyra se si shoqëritë e konceptojnë dinjitetin e gruas. Hixhabi, siç u argumentua, nuk e kufizon gruan, por i kundërvihet kufizimit të saj në objekt vizual; ai nuk e kufizon lirinë, por sfidon një koncept lirie të formësuar nga tregu, media dhe standardet konsumatore. Përplasjet rreth tij tregojnë më shumë për frikërat, paragjykimet dhe projektet ideologjike të shoqërive

sesa për vetë gratë që e mbajnë atë. Prandaj, sfida reale nuk qëndron te hixhabi, por tek aftësia e shoqërive moderne për të pranuar pluralizmin e bindjeve, për të respektuar lirinë fetare si pjesë integrale e të drejtave të njeriut dhe për të mos e instrumentalizuar trupin e gruas për konsum mediatik.

Gjendja e gruas mes joshjes për ekspozim të imponuar nga faktorë të ndryshëm dhe mes ftesës hyjnore, na thërret të gjithëve të reflektojmë thellë mbi atë se çfarë vlerash duam të mbrojmë dhe çfarë shoqërie duam të ndërtojmë.

- 1 Shih: Altin Torba, Domosdoshmëria e hixhabit në dritën e argumenteve hyjnore dhe logjike, (2016), 24. <https://www.jetaever8.de/wordpress/wp-content/uploads/2022/10/Domosdoshmeria-e-hixhabit-ne-driten-e-argumenteve-hyjnore.pdf>
- 2 Alison Scott-Baumann, Unveiling Orientalism in reverse, (2011), 9. <https://soas-repository.worktribe.com/output/351736/unveiling-orientalism-in-reverse?>
- 3 Shih: Droogsma, Rachel Anderson. (Redefining Hijab: American Muslim Women’s Standpoints on Veiling), 13 Jul 2007, 294-319. <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/00909880701434299>
- 4 Shih: Fredrickson, Barbara L. & Roberts, Tomi-Ann. (Objectification Theory.) *Psychology of Women Quarterly*, 1997. 21(2), 173-206.
- 5 Alison Scott-Baumann, Unveiling Orientalism in reverse, (2011). <https://soas-repository.worktribe.com/output/351736/unveiling-orientalism-in-reverse?>
- 6 Po aty, 10-11.
- 7 Shih: <https://www.evropaelire.org/a/supremja-hedh-poshte-padine-shami-shkolle/33575655.html>
- 8 Shih: <https://www.evropaelire.org/a/ndalimi-shamia-shkollakosova-drejta-rregulla/33134565.html>
- 9 <https://ask.rks-gov.net/Releases/Details/8429>
- 10 Voltaire, *Treatise on Tolerance*, 1763, Edited by Simon Harvey, Cambridge, 2000, XVI.
- 11 Albert Habib Hourani, (Arabic Thought in the Liberal Age) 1798–1939. Cambridge University Press; 1983, 263..
- 12 Shih: Leila Ahmed, (Women and Gender in Islam), Yale University Press, 1992, 149-150.
- 13 Shih: Frantz Fanon, (In A Dying Colonialism), Algeria Unveiled, Grove Press, 1965, 37.
- 14 Paidar, Parvin. Women and the Political Process in Twentieth-Century Iran. Cambridge University Press, 1995, f. 377.

Familja myslimane përballë modernizimit dhe sfidave të kohës

Mimoza Sinani

Familja ka qenë gjithmonë bërthama e shoqërisë njerëzore. Në traditën islame, ajo përbën jo vetëm një lidhje gjaku, por edhe një institucion moral dhe shpirtëror mbi të cilin ndërtohet shoqëria. Roli i nënës dhe i babait është përcaktuar nga Zoti dhe është i garantuar nga ligji hyjnor, duke u dhënë atyre detyra dhe përgjegjësi të shenjta në rritjen dhe edukimin e brezave. Në çdo kohë dhe vend, familja ka qenë qeliza më e rëndësishme e shoqërisë. Ajo është streha e ngrohtë ku formohet karakteri, ndërtohen vlerat dhe kultivohet dashuria. Në këndvështrimin islam, familja nuk është thjesht një bashkësi njerëzish, por një institucion i shenjtë, që buron nga urdhri hyjnor dhe që ruan

ekuilibrin shpirtëror dhe moral të shoqërisë. Mirëpo, në epokën moderne, sidomos me zhvillimin e teknologjisë dhe globalizimit kulturor, ky institucion i shenjtë përballet me sfida serioze. Në periudhën e digjitalizimit, prindërit myslimanë përballen me sfida të veçanta për të ruajtur vlerat islame dhe për t'i edukuar fëmijët në një mjedis ku teknologjia dhe informacioni shpesh mund të ndikojnë negativisht. Duke pasur parasysh sfidat e rritjes së fëmijëve në një mjedis digjital, prindërit myslimanë duhet të kujdesen për balancimin e vlerave islame me ndikimet teknologjike, duke përfshirë menaxhimin e përdorimit të mediave sociale, zhvillimin e një

Kurani,
përkundrazi, i
shikon dijen
dhe zhvillimin
si mjete për ta
njohur më
mirë Krijuesin,
jo për ta
zëvendësuar
Atë. Allahu
urdhëron:
“Lexo, me
emrin e Zotit
tënd, i Cili
krijoi.”
(El Alak, 1).



identiteti të fortë islam dhe ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm digjital për fëmijët.

MODERNIZMI SI RRYMË KULTURORE DHE FILOZOFIKE

Modernizmi, si rrymë kulturore dhe filozofike, lindi në Evropë pas epokës së Iluminizmit, duke theksuar autonominë e njeriut dhe përjashtimin e autoritetit hyjnor nga jeta publike. Kurani, përkundrazi, i shikon dijen dhe zhvillimin si mjete për ta njohur më mirë Krijuesin, jo për ta zëvendësuar Atë. Allahu urdhëron: “Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi.” (El Alak, 1).

Në kuptimin filozofik dhe shoqëror, modernizmi nënkupton prirjen për t'u shkëputur nga autoritetet tradicionale, përfshirë edhe ato fetare, dhe për t'i dhënë njeriut rolin qendror në përcaktimin e vlerave. Në dukje, modernizmi përfaqëson përparim teknologjik dhe emancipim intelektual; megjithatë, në thelb, ai shpesh bart një koncept antropocentrik, që e vendos njeriun në qendër të universit, duke e larguar nga lidhja me Zotin.

Kjo frymë laiciste, e cila e përjashton shpirtëroren nga jeta publike, ka ndikuar ndjeshëm në transformimin e perceptimit për familjen. Martesa nuk shihet më si lidhje e shenjtë dhe përgjegjësi morale, por si marrëveshje e përkohshme e dy individëve për përmbushje emocionale apo materiale. Allahu i Lartësuar e përshkruan martesën dhe jetën familjare si një prej shenjave të Tij madhështore: “Dhe nga faktet e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje te to, dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.” (Er Rrum, 21).

RELATIVIZIMI I VLERAVE MORALE DHE FETARE

Globalizimi ka përhapur një kulturë të re, atë të individualizmit, të konsumizmit dhe të relativizimit moral, ku vlerat shpesh zëvendësohen me preferenca, dhe e vërteta shpesh trajtohet si “çështje opinioni”. Një nga sfidat e kohës është përhapja e idesë se çdo sistem vlere është i vlefshëm dhe se normat tradicionale duhen relativizuar. Për Islam, e vërteta dhe morali kanë burim të qartë: shpalljen hyjnore. Allahu i Madhëruar thotë: “Dhe se kjo është rruga Ime e drejtë; pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij...” (El En'am, 153).

Kjo do të thotë se myslimani nuk mund të pranojë relativizimin e vlerave që bien ndesh me parimet e qarta të fesë. Modernizimi shpesh nxit individualizëm ekstrem, ku liria shihet si e shkëputur nga çdo përgjegjësi. Por, në Islam, liria është e lidhur gjithmonë me përgjegjësi ndaj Allahut. Individualizmi pa përgjegjësi është i huaj për Islam.

Prindërit duhet të mbeten të pranishëm në edukimin e fëmijëve dhe të ruajnë rolin e tyre si prijës të familjes.

Në traditën islame, familja nuk është vetëm bashkim mes burrit dhe gruas, por një institucion me funksion edukues, etik dhe shpirtëror. Ajo është vendi ku përçohet besimi dhe moraliteti. Në këtë kuptim, familja është “shkolla e parë” ku fëmija mëson dashurinë për Zotin, respektin për prindërit dhe ndjesinë e përkatësisë.

Modernizmi, megjithatë, kërkon ta relativizojë këtë koncept. Ai e sheh familjen si strukturë të hapur dhe të ndryshueshme sipas preferencave individuale. Kjo ka sjellë në shumë shoqëri përhapjen e bashkëjetesave jashtëmartesore, rritjen e divorceve, si dhe tendencën për të zhdukur dallimet natyrore ndërmjet gjinive. Këto fenomene, të përhapura në emër të “barazisë” dhe “tolerancës”, përbëjnë në fakt një kërcënim të drejtpërdrejtë për rendin natyror që Zoti ka përcaktuar.

IDEOLOGJIA E NEUTRALITETIT GJINOR DHE ‘PRINDI 1 – PRINDI 2’

Një ndër manifestimet më të qarta të krizës moderniste është përpjekja për t'i zëvendësuar termat ‘nënë’ dhe ‘baba’ me shprehje neutrale si “prindi 1” dhe “prindi 2”. Në dukje kjo shihet si përpjekje për “përfshirje” dhe “mosdiskriminim”, por në thelb ajo nënkupton mohim të identitetit natyror dhe të rolit gjinor që përkufizon strukturën e familjes. Kjo përpjekje të relativizojë rolet gjinore dhe të zhdukë identitetin biologjik dhe natyror të prindërve. Islami, përkundrazi, e njeh dallimin gjinor si një urdhër hyjnor dhe një plotësim natyror mes burrit dhe gruas. Allahu thotë: “Dhe Ne ju krijuam juve në çifte (mashkull dhe femër).” (En Nebeë, 8).

Tentativa për ta zhdukur këtë ndarje minon jo vetëm identitetin fetar, por edhe vetë rendin biologjik dhe psikologjik të jetës njerëzore. Kjo nismë, që në pamje të parë duket si “neutralitet” gjinor, në thelb përmban një rrezik të madh: fshin identitetin natyror dhe emocional të prindërve, duke zbehur rolet që Zoti i ka përcaktuar me urtësi. Kur humbet identiteti gjinor, humbet edhe modeli moral mbi të cilin ndërtohet familja.

Zhdukja e rolit tradicional të prindërve dhe përpjekjet për të zëvendësuar konceptet e “nënës” dhe të “babait” me terma të paidentifikuar si “prindi 1” dhe “prindi 2” synojnë të relativizojnë identitetin natyror dhe hyjnor të familjes. Kjo gjë e shndërron familjen në një marrëdhënie teknike, pa shpirt dhe pa identitet. Ky është një sulm i drejtpërdrejtë ndaj konceptit të krijimit, i cili në Islam ka qartësi të plotë: mashkulli dhe femra plotësojnë njëri-tjetrin dhe nga kjo lidhje lind jeta, dashuria dhe rendi shoqëror. Fshirja e dallimeve gjinore, përmes terminologjisë “neutrale”, përbën jo emancipim, por humbje të kuptimit të familjes si strukturë natyrore dhe morale. Nëna dhe babai nuk janë thjesht “tituj”,



por role të shenjta që përmbajnë dashuri, përgjegjësi dhe identitet. Nëna është burimi i mëshirës, ndërsa babai është mburoja dhe udhëheqësi i familjes, i ngarkuar me përgjegjësi, drejtësi dhe kujdes. Të dy së bashku formojnë një harmoni të shenjtë, që asnjë koncept modern nuk mund ta zëvendësojë. Kur fëmijët rriten pa ndjenjën e nënës dhe të babait, por vetëm me një “strukturë prindërore neutrale”, ata humbasin përvojën e dashurisë dhe të përkushtimit që burojnë nga këto role. Ky nuk është përparim, por zbehje e lidhjes njerëzore më të natyrshme që ekziston. Roli i nënës dhe i babait nuk është thjesht një ndarje funksionesh shoqërore, por një amanet hyjnor. Termat neutrale e shkatërrojnë këtë hierarki natyrore dhe hyjnore. Kjo bie ndesh me çdo parim hyjnor që thekson dallimin, bashkëplotësimin dhe mëshirën mes gjinive.

Islami e pranon dallimin gjinor si pjesë të rendit hyjnor dhe plotësues të jetës. Mashkulli dhe femra kanë dinjitet të barabartë, por role të ndryshme në familje dhe shoqëri. Këto role nuk janë formë diskriminimi, por pasqyrim i urtësisë së krijimit. Familja myslimane duhet ta mbrojë me dinjitet këtë strukturë, sepse ajo

Moderniteti mund të ndryshojë shumë gjëra në botë, por nuk mund të ndryshojë natyrën e familjes, sepse aty qëndron vetë zemra e njerëzimit.

është garancia e shëndetit moral dhe shpirtëror të brezave të ardhshëm.

Pavarësisht sfidave të modernizimit, familja myslimane mbetet një dritë që nuk shuhet. Ajo është vendi ku fëmijët mësojnë dashurinë, respektin dhe përlësinë; ku burri dhe gruaja bashkëpunojnë me besim e përkushtim; dhe ku fjala “nënë” dhe “baba” mbeten simbole të mëshirës dhe të autoritetit hyjnor. Moderniteti mund të ndryshojë shumë gjëra në botë, por nuk mund të ndryshojë natyrën e familjes, sepse aty qëndron vetë zemra e njerëzimit.

QËNDRIMI I ISLAMIT NDAJ GRUPIT LGBT

Në shoqërinë bashkëkohore, çështja e komunitetit LGBT ka marrë një rëndësi të madhe në debatin publik, ligjor dhe etik. Shumë shtete kanë miratuar ligje, që njohin martesat e së njëjtës gjini dhe të drejtat e personave me identitete gjinore të ndryshme. Megjithatë, në traditën islame, konceptet e seksualitetit dhe të identitetit gjinor janë të përcaktuara në mënyrë të qartë nga burimet themelore të fesë: Kurani, Suneti dhe ixhmaja (konsensusi i dijetarëve).

Pjesëtarët e LGBT-së pohojnë se termi “identitet gjinor” përkufizohet si ndjenjë e

brendshme e individit për gjininë me të cilën ai identifikohet dhe mënyrën se si ai e shpreh këtë në jetën e përditshme: e folura, gjestikulacioni, veshja, sjellja etj.. Sipas tyre shumica e njerëzve ndihen femra ose meshkuj, por kemi dhe meshkuj që ndihen femra, si dhe femra që ndihen meshkuj, ashtu si ka dhe njerëz që ndihen të dyja ose asnjëra dhe etiketojnë veten si queer (gjini variabël ose gjini fluide).

Kohët e fundit, aleanca LGBT ka paraqitur kërkesën për zgjerimin e përkufizimit të 'gjinisë', duke u parë në lentën e gjithëpërfshirjes, përtej konceptit binar burrë-grua. Kërkesa për zgjerimin e përkufizimit të 'gjinisë', tregon për një zgjerim të qëllimshëm, pasi kjo gjë u jep status juridik kategorive të reja gjinore që dalin përtej binaritetit burrë-grua. Ky përkufizim "gjithëpërfshirës", i përforcuar edhe nga përfshirja e shprehjes "identitet gjinor", e shkapëput këtë nocion nga baza e tij biologjike dhe e lidh me vetëperceptimin subjektiv të individit. Pra, përkufizimi i termit "gjini" nuk mbështetet më mbi bazën biologjike të natyrës njerëzore, por mbi ndjenjën personale dhe vetëdeklarimin subjektiv të individit.

Islami e konsideron njeriun si krijesë të Zotit me natyrë të përcaktuar. Krijimi i mashkullit dhe i femrës përbën bazën e rendit natyror dhe qëllimin hyjnor të riprodhimit dhe të vazhdimësisë së jetës. Kurani thekson: "O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre..." (El Huxhurat, 13). Martesa midis burrit dhe gruas është forma e vetme legjitime e marrëdhënieve seksuale, përmes së cilës ruhet morali, nderi dhe struktura e shëndoshë familjare. Çdo formë tjetër marrëdhënieje seksuale, jashtë këtij kuadri, konsiderohet mëkat dhe devijim nga natyra që Allahu ka përcaktuar. Qëndrimi i Islamit ndaj sjelljeve homoseksuale nuk buron nga urrejtja, por nga parimet morale dhe natyrore mbi të cilat ndërtohet shoqëria njerëzore.

PËRGJIGJJA ISLAME NDAJ MODERNIZMIT

Kërcënimi modernist ndaj familjes myslimane është një realitet që kërkon vetëdije dhe reagim të organizuar. Ai nuk është thjesht çështje fetare, por edhe kulturore dhe njerëzore. Familja është qeliza e parë e umetit, dhe pa të, nuk mund të ekzistojë shoqëria islame e qëndrueshme. Prandaj, siç thotë Kurani: "O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj nga zjarri." (Et Tahrim, 6).

Ky urdhër përfshin ruajtjen dhe mbrojtjen morale dhe shpirtërore nga çdo ideologji që e deformon natyrën e krijimit. Familja myslimane mund të ruajë identitetin e saj

duke u përballur me modernizmin në mënyrë selektive: të përvetësojë elementet që përmirësojnë jetën materiale dhe sociale, por të refuzojë ato që dëmtojnë moralin, fenë dhe strukturën familjare.

Kjo kërkon një edukim të ndërgjegjshëm islam, ku prindërit të jenë shembuj në praktikimin e fesë, ndërsa shkollat, mediat dhe institucionet fetare të punojnë bashkë për të forcuar lidhjen ndërmjet brezave dhe për të kultivuar vlera të qëndrueshme.

Përgjigjja islame duhet të jetë jo refuzim i modernitetit, por përballje e mençur me të: duke ruajtur vlerat e familjes si institucion hyjnor dhe duke ndërtuar një shoqëri që kombinon diturinë bashkëkohore me udhëzimin hyjnor. Përballë këtyre sfidave, familja myslimane duhet të ruajë balancën: të ecë me kohën, por të mos ecë pas saj; të përfitojë nga përparimet, por të mos sakrifikojë vlerat; të jetë pjesë e botës moderne, por të mbetet e lidhur me botën shpirtërore.

Çelësi qëndron te edukimi fetar, etik dhe shpirtëror i fëmijëve, i cili i pajis me vlera që nuk i ndryshon koha. Familja që ushqehet me besim, dije dhe dashuri do të jetë e qëndrueshme përballë çdo stuhie modernizimi. Moderniteti mund të ndryshojë rrobat, arkitekturën dhe mënyrat e jetesës, por nuk duhet të ndryshojë zemrën e shoqërisë, që është familja.

Një shoqëri që humb nënën dhe babanë humb rrënjët; një brez që rritet pa dashurinë e tyre humb drejtimin. Familja myslimane, me përlësi ndaj Zotit dhe përkushtim ndaj vlerave, duhet të mbetet kështjellë e qëndrueshme në kohë të turbullta. Ajo nuk është pengesë për modernitetin, por dritë udhërrëfyese për ta bërë modernitetin më njerëzor. Vetëm përmes rikthimit të parimet hyjnore dhe edukimit të bazuar në vlera islame, familja myslimane mund të përballë me sfidat e modernizmit dhe të mbetet bastioni i fundit i moralit dhe shpirtit njerëzor.

LITERATURA

Lena Larsen, *Gender and Equality in Muslim Family Law: Justice and Ethics in the Islamic Legal Tradition*, Publisher: I.B. Tauris, 2013.

Ziba Mir-Hosseini, *Journeys Toward Gender Equality in Islam*, Publisher: Oneworld Academic, 2022.

Noha Alshugairi & Munira Lekovic Ezzeldine, *Positive Parenting in the Muslim Home*, Publisher: Izza Publishing, 2017.

Dr. Javed Akhtar, *Parenting and Nurturing Muslim Children in the Digital Era*, Publisher: Darussalam International Publications, 2023.

Daniel Haqiqatjou, *Kërcënimi modernist ndaj Islamit*, Shtëpia botuese: Hana, Prishtinë, 2024.

"O ju njerëz,
vërtet Ne ju
krijuam juve
prej një
mashkulli dhe
një femre..."
(El Huxhurat, 13).

Rritje e krizave sociale në kohën e zhvillimit global - konteksti socio-historik

Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi

Shekulli XXI karakterizohet nga një dualitet paradoksal. Nga njëra anë, ai shquhet për zhvillim të paparë teknologjik dhe informativ, diversitet kulturor, multikulturalizëm dhe përpjekje për konsensus global, ndërsa nga ana tjetër, pikërisht ky shekull ka sjellë një alarm shqetësues që nuk mund të injorohet. Ndërkohë që njerëzimi po gëzon nivele materiale mirëqenieje, që nuk janë parë kurrë më parë në histori, shoqëritë perëndimore dhe jo vetëm ato, po përballen me kriza të thella sociale dhe psikologjike. Paradoksalisht, zgjidhja ose 'kura' për këto kriza duket se fshihet jo në përparimin e mëtejshëm material apo teknologjik, por në një dimension që shoqëria moderne pothuajse e ka anashkaluar sistematikisht, e ai është 'dimensioni shpirtëror'. Ky është pikërisht aspekti për të cilin njeriu i shekullit XXI i mbingarkuar me informacion, i lidhur digjitalisht por i izoluar ekzistencialisht ka më shumë nevojë se kurrë, edhe pse shpesh nuk e pranon apo nuk e kupton këtë nevojë. Në anën tjetër, prodhimi i brendshëm bruto global ka arritur kulme të paprecedenta, teknologjia ka zgjidhur probleme që dikur konsideroheshin të pazgjidhshme, dhe varfëria ekstreme është reduktuar dukshëm në nivel global.¹ Megjithatë, në të njëjtën kohë, shkallët e depresionit, ankthit, vetëvrasjes, vetmisë dhe polarizimit social janë rritur në mënyrë alarmante, veçanërisht në vendet më të zhvilluara ekonomikisht.² Paradoksi i kohës moderne është më se i qartë: shoqëritë njerëzore po hyjnë në periudhën më të pasur materiale në historinë njerëzore, por njëkohësisht krizat sociale, psikologjike dhe morale gjithnjë e më shumë po rriten. Edhe në Kosovë, ku rritja ekonomike e viteve të fundit ka sjellë përmirësime në infrastrukturë dhe standard jetese, sfidat sociale si: papunësia e të rinjve, migrimi, humbja e besimit në institucionet publike, periudha e tranzicionit, si

dhe rritja e stresit psikologjik ende mbesin të theksuara. Këto zhvillime tregojnë se mirëqenia materiale nuk garanton automatikisht qetësi sociale dhe shpirtërore. Kësisoj, ky artikull shqyrton këtë paradoks duke analizuar faktorët socio-psikologjikë, që kontribuojnë në krizat bashkëkohore sociale, duke iu referuar edhe perspektivave fetare që ofrojnë një kornizë shpjeguese alternative për këtë fenomen.






Figura 1. Migrimi në Kosovë 2012 - 2023⁵.

Bazuar nga figura e lartcekur, shohim se në vitin 2015 ka qenë emigrimi më i madh ku ka pasur 74,434 njerëz, pastaj 2014 me 45,333, viti 2021 me 42,728, si dhe viti 2022 me 41,553.

Në aspektin sociologjik shihet se ngërçi i cili është në mes të solidaritetit mekanik dhe atij organik, që nënkupton se lidhjet e vjetra zakonisht zëvendësohen me lidhjet e reja, si duket në kontekstin kosovar kanë mbetur në një hendek ose ngërç, ku me njërin ka disa lidhje të reja, përderisa në anën tjetër lidhjet e vjetra akoma janë pjesë e shoqërisë.

PERSPEKTIVA PSIKOLOGJIKE - PASURIA MATERIALE PA NJË MIRËQENIE EMOCIONALE

Kur flitet për krizat sociale, padyshim se ato manifestohen përmes formave dhe mënyrave të ndryshme, por gjithsesi se rol me rëndësi luan edhe aspekti kohor. Pasi, aspekti kohor është edhe përcaktues i një morie të ngjarjeve sociale. Në fakt, një krizë sociale paraqitet atëherë kur ka një shqetësim të rëndë brenda strukturave shoqërore, që shpesh vjen si rezultat i pabarazive sistematike (të vazhdueshme), mungesës së burimeve ose degradimit mjedisor. Këto shqetësime mund të shfaqen si trazira të përhapura, zhvendosje masive të popullsisë ose një kolaps i besimit publik ndaj institucioneve, duke penguar ndjeshëm përparimin e shoqërisë drejt objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Krizat sociale po ashtu lidhen ngushtë me krizën e shëndetit mendor, e cila është rritur globalisht. Edhe në Kosovë, raportet e organizatave shëndetësore tregojnë rritje të rasteve të ankthit, depresionit dhe stresit post-traumatik, veçanërisht te të rinjtë. Studimet flasin se “puna e pasigurt, konkurrenca jo e drejtë dhe presioni për të arritur sukses, janë disa nga indikatorët të cilët rrisin barrën psikologjike.⁶ Lidhur me këtë, të dhënat nga

PERSPEKTIVA SOCIOLOGJIKE - STRUKTURA DHE PASIGURIA SOCIALE

Shoqëria bashkëkohore ka evoluar dukshëm në raport me të kaluarën, për distancat gjeografike të cilat dikur kanë qenë të pa imagjinuara, sot nuk mund të thuhet e njëjta gjë. Kjo pasi, krahas zhvillimit dhe emancipimit të shoqërisë është zhvilluar teknologjia dhe komunikimi dhe ky komunikim ka mundësuar që këto distanca gjeografike të ofrohen gjithnjë e më afër. Megjithatë, në vorbullën globale, sfida kryesore e njeriut është vetë njeriu, njeriu për të cilin ka folur dukshëm Fromi në librin e tij ‘Arratisja nga Liria’, ku ndër të tjera nënvizon se “individit pushon së qeni vetvetja, përshtat për vete krejt tipin e personalitetit që i ofrohet nga modelet kulturore dhe bëhet njëlloj si të gjithë të tjerët. Hendeku në mes meje dhe botës zhduket, dhe me këtë edhe frika e ndërgjegjshme e vetmisë dhe pafuqisë...”³ Ndaj, pikërisht si rezultat i pasigurisë sociale njeriu modern ka hyrë në një mjegull të cilën shpeshherë as vetë nuk e kupton. Pabarazia sociale, e cila vërehet edhe në Kosovë midis qyteteve dhe zonave rurale, midis sektorit publik dhe privat, krijon tensione dhe perceptim të padrejtësisë.⁴ Ky kontekst lë të kuptohet se pavarësisht zhvillimit dhe emancipimit të shoqërisë, si duket shoqëria bashkëkohore jeton në një realitet në të cilin ka filluar të humb besimi dhe mungesa e këtij besimi mund të krijojë hendeqe të mëdha edhe në rastin e Kosovës. Në anën tjetër, anomia e Durkheim-it është po ashtu e dukshme në kontekstin kosovar, ku ndryshimi i shpejtë i vlerave, ndikimi i emigrimit dhe sfidat institucionale krijojnë boshllëk normativ dhe presion të shtuar mbi individin. Sipas të dhënëve, si imigrimi po ashtu emigrimi ka pasur rritje dhe rënie të kohëpaskohshme, të cilat janë manifestuar si rezultat i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Të dhënat janë paraqitur në figurën e mëposhtme, si vijon:

ShSKUK-ja për vitin 2024 nënvizojnë për rritjen e shërbimeve sociale rreth shëndetit mental, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1. Qendrat e shëndetit mendor me Shtëpi Integruese në Bashkësi dhe QIRSKP Shtime”⁷

Të dhënat përfaqësojnë numrin e rasteve/kërkesave për

t’ua largojnë telefonin, qoftë edhe për disa orë, atëherë pothuajse me automatizëm fëmijët kalojnë në shpërthime të inateve, në reagime shumë agresive, dhe në pamundësi për të gjetur një mirëkuptim në mes të prindërve dhe fëmijëve për përdorim të telefonit dhe rrjeteve sociale.⁹ Duke parë këtë realitet, shpeshherë janë ngritur pyetje se, a duhet të kufizohen disa nga rrjetet sociale, siç është TikToku, Facebook-u,

Nr.	Njësia	Vizita shtëpiake	Qëndrim ditore	Vizita/specialistik e (psikiatrike- psikologut)	Terapi okupuese, art, sporte, argëtim e etj)	Shërbime të punëtorit t social
1.	Prishtinë	1,103	4,000	6,231	6,176	2,247
2.	Ferizaj	443	1,264	4,334	2,078	102
3.	Mitrovicë	1,213	4,031	4,886	10,739	-
4.	Gjilan	1,386	1,329	2,945	12,282	1,286
5.	Pejë	1,333	4,101	2,931	7,670	117
6.	Gjakovë	681	2,206	3,251	9,484	155
7.	Prizren	282	1,675	2,381	10,122	86
8.	Shtime		21,600	1,494	550	
Total:		6,441	40,206	28,453	59,101	3,993

shërbime psiko-sociale dhe shëndet mendor në komunat e Kosovës, të ndara sipas llojit të shërbimit. Kjo tabelë na tregon shtrirjen e nevojave, intensitetin e përdorimit të shërbimeve dhe nivelin e mbështetjes komunitare për secilën komunë. Gjithashtu, një shqetësim tjetër goxha i lartë është edhe mënyra e shfrytëzimit të ‘shkopit magjik’ – internetit i cili si duket në shumë pjesë të botës keqpërdoret dhe pothuajse është shndërruar në një varësi të lartë. Studimet tregojnë se “në 15 vitet e fundit, përdorimi i internetit është rritur jashtëzakonisht shumë: tani afërsisht 40% e popullsisë botërore është online. Varësia nga interneti është një çrregullim emergjent, sepse rritja e popullaritetit ka çuar në shfaqjen e rasteve klinike që paraqesin simptoma abuzimi. Klasifikimi i varësisë nga interneti është ende i diskutueshëm dhe ekzistojnë disa kritere diagnostikuese dhe mjete të ndryshme matëse. Megjithatë, nuk ka kritere diagnostikuese të pranuar gjerësisht”.⁸ Në fakt, përdorimi i teknologjisë dhe rrjeteve sociale, edhe pse rrit komunikimin virtual, shpesh krijon izolim emocional. Lidhur me këtë çështje, studimet tregojnë se çdoherë e më shumë, sidomos fëmijët, po janë të varur nga interneti dhe kjo padyshim se po prodhon pasoja të tjerë. Naim Telaku, i ka parë me sytë e tij rastet e varësisë së fëmijëve nga rrjetet sociale në Kosovë. Ai citon hulumtime të besueshme kur thotë se 20% e popullsisë botërore ka krijuar varësi nga rrjetet sociale, dhe paralajmëron se shifra mund të rritet shpejt. Sipas tij, përherë e më shumë kemi prindër, të cilët tregojnë që kur provojnë që fëmijëve të tyre

Snapchat, etj., apo jo? Njëjtë sikurse ka bërë Shqipëria e cila ka mbyllur rrjetin social të TikTokut apo së fundi edhe Australia, e cila ka ndaluar rrjetet sociale për fëmijët nën 16 vjeç. Sipas mediave, “platformat e mediave sociale do të duhet të raportojnë çdo muaj se sa llogari fëmijësh kanë mbyllur pasi Australia të fillojë zbatimin e kufirit të moshës 16 vjeç javën e ardhshme, deklaroi një ministre. Facebook, Instagram, Kick, Reddit, Snapchat, Threads, TikTok, X dhe YouTube do të përballen me gjopa deri në 50 milionë dollarë australianë (33 milionë dollarë amerikanë) nga data 10 dhjetor nëse nuk ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të mbyllur llogaritë e fëmijëve australianë nën moshën 16 vjeç.¹⁰ Ndoshta ka të drejtë sociologu Zygmunt Bauman, i cili ka analizuar shoqërinë moderne dhe e ka quajtur si “modernitet të lëngshëm” një shoqëri ku strukturat e qëndrueshme sociale





dhe identitetet janë zëvendësuar nga fluiditet dhe ndryshimet e vazhdueshme.¹¹ Psikologjia sociale tregon se qeniet njerëzore shpejt adaptohen ndaj rrethanave të reja të njohura ndryshe si 'rrota e vrapimit hedonik', duke bërë kështu që çdo kënaqësi materiale të jetë përkohësisht dhe të kërkojë nivele gjithnjë e më të larta stimulimi¹², stimulim ky i cili padyshim se është i përkohshëm. Ky fakt prodhon pasoja të tjera në aspektin social, duke ndikuar kështu që njeriu modern të jetë më shumë në shërbim të konsumit sesa të mirëqenies emocionale, sociale dhe shpirtërore.

DIMENSIONI FETAR DHE SHPIRTËROR - MUNGESA E KUPTIMIT NË NJË BOTË TË PASUR DHE TË LARMISHME

Feja është një përjetim subjektiv, emocional, metafizik me një fuqi absolute, e cila ka një domethënie të veçantë për individin. Kjo lë të kuptohet se feja është mjet i integritimit social përmes së cilës njeriu e ka gjetur veten në një dimension shpirtëror, të qetë, paqësor dhe të afërt për rrethin social apo komunitetin. Në fakt, edhe pse feja luan ende rol të rëndësishëm në shoqërinë kosovare, ndikimi i konsumizmit dhe modernizimit shpesh e zbeh funksionin e udhëzimit moral dhe shpirtëror. Përtej dimensionit teologjik, komunitetet fetare historikisht kanë funksionuar si struktura të forta sociale që ofrojnë mbështetje emocionale, identitet kolektiv dhe kuptim të përbashkët. Studimet tregojnë se "pjesëmarrja në komunitete fetare korrespondon me nivele më të larta të lumturisë së raportuar dhe shëndetit mendor më të mirë".¹³ Traditat fetare shpesh përmbajnë kritika të forta ndaj materializmit dhe konsumizmit. Shembull Jezusi paralajmëroi se 'nuk mund t'i shërbesh Perëndisë dhe

pasurisë njëkohësisht' (Mateu 6:24). Budizmi identifikon lakminë si një nga rrënjët themelore të vuajtjes. Islami thekson balancën dhe moderimin në çështjet materiale. Këto perspektiva ofrojnë një kornizë kritike për të kuptuar pse rritja ekonomike e pafund nuk çon domosdoshmërisht në mirëqenie. Ato sugjerojnë se ndjekja e pakufizuar e pasurisë materiale jo vetëm që nuk plotëson, por në fakt mund të distancojë nga ajo që vërtet ka rëndësi: marrëdhëniet, qëllimi, shërbimi ndaj të tjerëve, dhe një jetë e drejtuar nga vlerat morale. Në rastin e Kosovës, tensioni midis vlerave tradicionale, modernitetit dhe pritjeve të reja sociale shpesh krijon konflikt të brendshëm dhe pasiguri identitare, veçanërisht ndër brezat e rinj. Kombinimi i pabarazisë sociale, presionit psikologjik, individualizmit dhe dobësimit të strukturave morale krijon terren për kriza sociale në botë, ku as shteti i Kosovës nuk përjashtohet.

ÇELËSI TE PERSPEKTIVA E IBËN HALDUNIT - RËNIA E ASABIYYAH-SË NË SHOQËRITË E PASURA

Ibën Halduni (1332–1406), një prej figurave më të rëndësishme të mendimit islam dhe sociologjisë klasike, argumenton se fuqia dhe stabiliteti i një shoqërie mbështeten mbi asabiyyah apo ndjenjën e solidaritetit grupor, unitetin moral dhe frymën e përbashkët. Sipas tij, "feja ka lënë gjurmë të thella në jetën dhe historinë e arabëve, më të fuqishme se ndikimi i mjedisit, natyrës apo edukimit, duke u shndërruar, në masë të madhe, në faktor kyç dhe vendimtar që formëson të gjitha aspektet e jetës së tyre të përditshme gjatë epokave pas përhapjes së saj".¹⁴ Gjithashtu, sipas pikëpamjes së tij, shoqëritë e forta ndërtohen kur ekziston bashkimi, qëllimi i

përbashkët dhe disiplina morale. Ndërsa shoqëritë e pasura, me kalimin e kohës, humbasin pikërisht këtë energji kolektive. Në këtë këndvështrim, sfidat e shoqërive moderne përfshirë edhe Kosovën mund të interpretohen si rënie e asabiyyah-së. Individualizmi i theksuar, konkurrenca e ashpër, fragmentimi social dhe rrënimi i besimit institucional e dobësojnë ndjenjën e përkatësisë, duke krijuar një shoqëri ku individët jetojnë pranë njëri-tjetrit, por jo me njëri-tjetrin. Ky fenomen, sipas Ibën Haldunit, është paralajmërues i krizave të brendshme, pavarësisht pasurisë materiale. Ibën Halduni nënvizon rëndësinë e fesë, sidomos Islamit, si faktor që forcon asabiyyah-në. Feja shërben si mekanizëm etik, duke vendosur norma të përbashkëta, solidaritet dhe përgjegjësi kolektive. Parimet islame si zekati (ndarja e pasurisë), ndihma reciproke, drejtësia sociale dhe përgjegjësia morale për komunitetin kontribuojnë në uljen e pabarazisë dhe rritjen e kohezionit shoqëror. Në Kosovë, ku feja islame ka një prani të rëndësishme historike dhe kulturore, vlerat etike të saj, si: solidariteti, modestia, përgjegjësia ndaj tjetrit, respekti brenda komunitetit dhe jashtë tij kanë ndihmuar në mbajtjen e kohezionit social përballë vështirësive dhe sfidave tjera.

Si përfundim mund të themi se paradoksi i krizave sociale në kohën më të pasur të historisë zbulon një të vërtetë themelore: mirëqenia njerëzore nuk mund të reduktohet në pasuri materiale. Ndërkohë që progresi ekonomik dhe teknologjik ka sjellë përfitime të padiskutueshme, ai ka dështuar të adresojë dhe në disa raste ka përkeqësuar nevojat më të thella njerëzore për lidhje, kuptim, qëllim dhe transcendencë. Sfida qëndron në identifikimin e një ekuilibri midis vlerave moderne të autonomisë individuale dhe njohjes së nevojës sonë themelore për lidhje, përkatësi dhe qëllim kolektiv. Adresimi i krizave sociale bashkëkohore kërkon një rikonceptim themelor të asaj që do të thotë të jetosh mirë në një vizion që integron jo vetëm sigurinë materiale, por edhe shëndetin e komunitetit, kohezionin social, kuptimin ekzistencial dhe dimensionin shpirtëror të jetës. Vetëm përmes një qasjeje multidimensionale mund të shpresojmë të

Individualizmi i theksuar, konkurrenca e ashpër, fragmentimi social dhe rrënimi i besimit institucional e dobësojnë ndjenjën e përkatësisë, duke krijuar një shoqëri ku individët jetojnë pranë njëri-tjetrit, por jo me njëri-tjetrin.

krijojmë shoqëri që janë jo vetëm të pasura, por edhe të shëndetshme, kuptimplota me një mirëqenie emocionale, sociale dhe shpirtërore.

1 Steven, Pinker: "Enlightenment Now: The Case for Reason, Science, Humanism, and Progress", Viking, New York, 2018, f. 52-98.

2 Jean M. Twenge, iGen: "Why Today's Super-Connected Kids Are Growing Up Less Rebellious, More Tolerant, Less Happy", Atria Books, New York, 2017, f. 79-115.

3 Fromm, Erich: "Arratisje nga Liria", Plejad, Tiranë, 2011, f. 45.

4 Piketty, Thomas: "Capital in the twenty-first century", The Belknap Press of Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts London, 2014, f. 45.

5 Instituti GAP: "Emigrimi dhe tregu i punës në Kosovë: Potenciali i papërdorur i fuqisë punëtore jo-aktive", Instituti GAP, Prishtinë, 2025, f. 5-6.

6 Fuchs, Christian: "Social media: A critical introduction", Sage, London & Los Angeles, 2021, fq. 31.

7 SHSKUK: "Raport i Punës Janar-Dhjetor 2024", Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-SHSHKUK, Prishtinë, 2025, f. 59.

8 Poli, Borberto: "Internet addiction update: diagnostic criteria, assessment and prevalence", Commentary, Neuropsychiatry (London) (2017) 7(1), 04-08, 10.4172/Neuropsychiatry.1000171 © 2017

9 Cubolli, Krenare: "Varësi si droga e alkooli: A duhet të bllokohet TikTok-u në Kosovë?", artikull i botuar në REL, 14 Dhjetor, 2024: <https://www.evropaelire.org/a/a-duhet-te-bllokohet-tiktoku-ne-kosove/33238950.html>

10 Raporteri: "Australia ndalon rrjetet sociale për fëmijët nën 16 vjeç, ja sa gjohet nëse nuk zbatohet ligji", Raporteri, artikull i botuar në Raporteri, 04 Dhjetor 2025: <https://reporteri.net/extra/techauto/australia-ndalon-rrjetet-sociale-per-femijet-nen-16-vjec-ja-sa-gjohiten-nese-nuk-zbatohet-ligji/>

11 Bauman, Zygmunt: "Moderniteti i Lëngshëm", Pika Pa Siperfaqe, Tiranë, 2017, f. 76.

12 Brickman, Philip and Donald T. Campbell: "Hedonic Relativism and Planning the Good Society", in *Adaptation Level Theory: A Symposium*, ed. M. H. Appley, Academic Press, New York, 1971, f. 287-302.

13 Chaeyoon Lim and Robert D. Putnam: "Religion, Social Networks, and Life Satisfaction", *American Sociological Review* 75, No. 6 (2010), f. 914-933.

14 Kindi, Ferexh: "Teoria e Ibn Haldunit në filozofinë e historisë", botuar në: <https://ardhmeriaonline.com/teoria-e-ibn-haldunit-ne-filozofine-e-historise/>

Manipulimi informativ si nxitës i konfliktit shoqëror

Enis Reçica

Lufta nuk bëhet vetëm me plumba dhe tanke. Arma kryqë, sot në botën moderne, është informacioni. Ai që ka informacionin, ka edhe fitoren. Është media ajo që e bartë, e transmeton, e thotë informacionin. Jo më kot mediet quhen si pushteti i katërt në shtetet demokratike, pas legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Me të drejt i jep pushtetin real medias edhe ish-presidenti amerikan, Barack Obama, kur thotë se “unë jam ai që thotë media se jam, dhe nuk jam ai që media thotë se nuk jam” (Guximi për të shpresuar, 2008). Këtë pushtet ka media sot. Varësisht se çfarë “dëshiron” të thotë, të vërtetën apo jo të vërtetën. Kur ta bëjë këtë të dytën, mund të ndikojë dukshëm negativisht në shoqëri. Në këtë moment bëhet manipulimi i së vërtetës, manipulimi informativ, që më pas nxit, jo vetëm konflikt shoqëror, por çon edhe në dëme më të mëdha. Prandaj, edhe Zoti, në Kuran na porositi: “Mos e përzieni të vërtetën me të rremën

dhe mos e fshihni të vërtetën ndërsa e dini” (Kuran). Ky ajet flet mjaftueshëm. E vërteta është porosi hyjnore, që në njerëzit nuk duhet ta manipulojmë, se dëmi mund të jetë afatgjatë.

Fenomeni i manipulimit informativ përbën një fushë të thellë interdisiplinore, e cila ndërthur gazetarinë, komunikimin politik, sociologjinë e konfliktit dhe etikën fetare. Në një kontekst ku informacioni qarkullon me shpejtësi të paprecedentë dhe ku mediet, si ato të Kosovës, ashtu edhe ato ndërkombëtare, janë shndërruar në aktorë me ndikim të drejtpërdrejtë politik, kuptimi i mekanizmave të manipulimit është jetik për shoqërinë demokratike. Sidomos, tani, në kohën kur po lulëzon edhe Inteligjenca Artificiale, përmes së cilës po bëhen manipulime edhe vizuale, rrezikun e konfliktit shoqëror e kemi në prag.




Manipulimi informativ përkufizohet si transformimi i qëllimshëm i fakteve me synim ndikimin e perceptimit publik, orientimin e opinionit ose prodhimin e një realiteti të rremë të pranueshëm nga publiku. Bill Kovach dhe Tom Rosenstiel theksojnë se gazetaria ka një “detyrim moral ndaj së vërtetës”, ndërsa devijimi nga ky parim përbën një formë të deformimit epistemik (The Elements of Journalism, 2014). Nëse mjekët e kanë “Betimin e Hipokratit” si një tekst që lidhet me etikën e profesionit të tyre, edhe gazetarët duhet ta kenë ngjashëm, një dokument që nxitë moralin e tyre për të thënë të vërtetën. E libri i myslimanëve, Kurani, shpeshherë e ngrit brengën e dëmit nga gënjeshtria, prandaj edhe mund të jetë një “tekst” i rekomanduar për gjithsecilin gazetarë dhe informatorë. Nëse e kemi parasysh citatin se “mallkimi i Allahut qoftë mbi gënjeshtarët” (Kuran), ne nuk do të kishim asnjë rrezik nga manipulimi informativ, dhe nga asnjë e keqe që mund të vije nga dezinformimi. Diçka e tillë, nuk do ekzistonte fare as si e thënë teorike e as si frikë praktike.

Në literaturën e shkencave politike, informacioni konsiderohet shpesh si instrument i pushtetit. Elitat politike kanë synime ta shtrijnë ndikimin në opinionin publik përmes “kapjes” së medieeve. Qëllimi është që të manipulohet mbi informacionin që transmetojnë mediet te masa e gjerë. Në këtë frymë, Noam Chomsky, argumenton se mediet strukturohen për të prodhuar konsensus në favor të elitave, duke filtruar informacionin përmes interesave ekonomike dhe politike (Herman, E. S., & Chomsky, N. Manufacturing Consent, 1988). Kësisoj manipulimi nuk është rastësi, por rezultat i mekanizmave sistemorë. Në këto raste, përveç shpërndarjes së propagandës në të mirë të elitave, dhe fshehjes së gjendjes reale, mediet e kapura nga pushteti, ndikojnë fort në polarizimin shoqëror. Në shembuj real, mediet, duke i shërbyer agjendës së elitave ose pushteteve, fillojnë të ndërtojnë “armiqtë brendshëm”, të ushqejnë konflikt të qëllimshëm midis grupeve, apo të ndajnë shoqërinë sipas bindjeve politike. Këto janë bazat e nxitjes së konfliktit shoqëror përmes “medieeve-pushtet”.

Erving Goffman, përmes teorisë së kornizimit (Framing, 1974), sqaron se mënyra se si informacioni paraqitet, për shembull: si rrezik, krizë, apo komplete, determinon edhe reagimin social. Kornizat janë mjete të fuqishme për orientimin emocional dhe racional të publikut. Këto “korniza” janë metaforë e natyrës së ndikuesve të jashtme

Sipas mendimit tuaj sa ndikon dezinformimi në besimin në mes të bashkësive etnike në Kosovë



Ndikim shumë domethënës 83%
Ndikim i moderuar 11%
Ndikim i lehtë 6%

Ndikimet partiake dhe ekonomike shpesh prodhojnë narracione të polarizuara, duke e bërë procesin e informimit jo vetëm të shtrembëruar, por edhe të instrumentalizuar.

mbi informacionin e vërtetë. Kësisoj, sipas pasqyrit të Goffman, media, politika, kultura, institucionet dhe grupet shoqërore krijojnë korniza, që u tregojnë njerëzve si të kuptojnë një ngjarje. Shembull i saj është që një protestë mund të paraqitet nga mediet si: revoltë civile, huliganizëm, luftë për drejtësi, rrezik për rendin, e drejtë qytetare e pasqyrimet të tjera. Pra ky është pushteti i medias, varësisht nga cila perspektivë anon, pasi informacioni është vështirë të jetë neutral, nëse ka ndikues brenda “kornizës”.

MANIPULIMI INFORMATIV NË KONTEKSTIN E KOSOVËS

Mediet kosovare operojnë në një realitet të vogël tregu, si pasojë e kësaj, ato mund të veprojnë lehtësisht nën presion politik, ekonomik dhe shpesh edhe kulturor. Ndikimet partiake dhe ekonomike shpesh prodhojnë narracione të polarizuara, duke e bërë procesin e informimit jo vetëm të shtrembëruar, por edhe të instrumentalizuar.

Disa forma të zakonshme të manipulimit informativ në Kosovë përfshijnë:

Sensacionalizmin si strategji komerciale dhe politike;

Dezinformimin në periudha zgjedhore, ku partitë përdorin media të afërta (rrjete sociale) për mobilizim emocional;

Përdorimin e gjuhës polarizuese që synon etiketimin e kundërshtarëve politikë;

Interpretimin e njëanshëm të raporteve ndërkombëtare, sidomos atyre që lidhen me dialogun Kosovë-Serbi apo Kosovë-ShBA;

Mungesën e verifikimit, sidomos në portalet jo-profesionale.

Në këtë ambient, qytetari kosovar është shpesh i ekspozuar ndaj realiteteve të fragmentuara që prodhojnë paqartësi politike dhe tension shoqëror. Manipulimi i informacionit,

përveç kësaj, mund të ketë ndikim edhe në raportet ndëretnike në Kosovë. Në bazë të të dhënave të një hulumtimi të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (Në ç' mënyrë dezinformimi shënjestron dhe ndikon në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë? 2024), thuhet se mbi 80% e banorëve në Kosovë besojnë se dezinformimi ka ndikim të rëndësishëm në tensionimin e marrëdhënieve ndëretnike në vend.

Sipas këtij hulumtimi, perceptimi i kosovarëve është se këto dezinformata apo manipulime të informacionit përhapen kryesisht përmes rrjeteve sociale, e më pas edhe nga mediet "fantome", të cilave nuk u dihet pronësia dhe veprimtaria reale. Në këtë mënyrë, "faktorët e jashtëm, apo të brendshëm" shfrytëzojnë informacionin për të krijuar pushtet, nëse shihet në syrin politik. Teoricieni Jürgen Habermas (The Structural Transformation of the Public Sphere, 1962), e koncepton hapësirën publike si arenë të komunikimit racional, ku qytetarët diskutojnë mbi çështje të interesit të përgjithshëm në mënyrë të lirë dhe të informuar. Kur informacioni manipulohet, hapësira publike deformohet, duke prodhuar një shoqëri të polarizuar dhe emocionalisht të manipulueshme. Këtë deformim e bëjnë ata të cilët nuk e duan realitetin, dhe përfitojnë nga manipulimi. Ky manipulim më pas, mund të çojë deri në krizë shoqërore.

Kur themi krizë shoqërore, nuk aludohet gjithmonë në kriza fizike, protesta, dhunë e veprime të ngjashme demonstrative. Ndonëse edhe ato mund të shkaktohen lehtë nga manipulimi informativ, qoftë nga mediet, qoftë nga politika. Shembull, Johan Galtung, e sheh manipulimin informativ si një formë të dhunës strukturore, (*Peace by Peaceful Means: Peace and Conflict, Development and Civilization*, 1996) pasi ai krijon kushte në të cilat individët dëmtohen pa ndërhyrje të drejtpërdrejtë fizike. Narracionet polarizuese prodhojnë stigmatizim, frikë dhe mobilizim të dhunshëm. Kësisoj, manipulimi informativ, në aktualitetin tonë, po di të krijojë edhe bullizim dhe frikë te popullata.

Në kontekstin kosovar, manipulimi informativ shpesh shërben si mjet politik për të ndërtuar imazh të rremë të kundërshtarit, duke e paraqitur si kërcënim ndaj shtetit, kombit apo integritetit politik. Etiketimet si "tradhtar", "antishtet", "i shitur" krijojnë një diskurs ku kundërshtarit i mohohet legjitimiteti moral dhe politik. Këtë qasje politikanët e përdorin shpesh, sidomos gjatë zgjedhjeve. Atë e bëjnë me ndihmën e medieve sociale e tani edhe inteligjencës artificiale. Ndërsa mediet serioze nacionale, tentojnë të mbajnë qëndrime redaktoriale, duke mos rënë pre e sponsorizimeve partiake në përmbajtjet editoriale që mund të qojnë në manipulim informativ.

ETIKA E KOMUNIKIMIT, SI PËRGJEGJËSI MORALE

Edhe komunikimi ka etikë. Jo gjithçka mund të thuhet në publik, e aq më shumë, në transmetimet mediale. Fjala e thënë, mund të ndikojë një opinion të tërë publik. Prandaj, Kosova qysh herët ka tentuar ta rregullojë këtë edhe përmes Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Ky ligj, si kryefjalë ka

për "qëllim promovimin e një shoqërie tolerante dhe demokratike në Kosovë përmes respektimit të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe të lirisë së shprehjes dhe për parandalimin e gjuhës së shpifjes dhe fyerjes" (LIGJI NR. 02/L-65, 2008).

Etika e komunikimit gjen vend si fushë studimore te shumë studiues të fushave sociale. Jürgen Habermas (Moral Consciousness and Communicative Action. Cambridge, 1990), flet për etikën e diskursit, i cili zhvillon idenë e komunikimit racional, ku normat morale dalin nga një dialog i lirë, pa dominim. Secila shoqëri ka normat e saj morale, që shkojnë përtej hapësirës ligjore. Ligjet shtetërore, të bëra nga njerëzit janë dispozita përcaktuese të rregullave të vetë njerëzve. Por, jo gjithçka ligji mund të përfshijë. Prandaj, përtej ligjit, janë edhe normat shoqërore që një shoqëri ka. Morali është përcaktues i ndjeshëm edhe i komunikimit, i etikës në komunikim.

Edhe shoqëria kosovare ka normat e saja, që përcaktojnë lejimin ose mos lejimin e të folurit në publik. Kjo normë morale, ndikohet edhe nga religjioni që i përket një grup shoqëror. Shembull, në traditën islame, përkatësisë së të cilës i takon 93.49 % (ASK, 2024) e popullatës në Kosovë, flitet shumë për etikën e komunikimit. Ndonëse jo detyrimisht si terminologji, por si përmbajtjeje. Kësisoj, Kurani urdhëron: "O besimtarë! Nëse ndonjë mendjelehtë ju sjell ndonjë lajm, hulumtoni mirë..." (Kurani 49:6). Ky ajet konsiderohet themeli i metodologjisë islame të verifikimit. Në këtë parim, vepron edhe gazetaria e mirëfilltë, e cila verifikon "lajmin" para se të publikohet ai. Lajmi i pa verifikuar mund të jetë i rrejshëm, manipulativ, dhe në këtë mënyrë i dëmshëm deri në konflikt shoqëror.

Etika islame, edukon në vazhdimësi thënien e së vërtetës. Zoti në Kuran thotë: "O ju që besuat! Keni frikë Allahun dhe thoni vetëm fjalë të drejtë." (Kuran 17:36). Fjala e drejt, fjala e vërtetë është tejet e rëndësishme në komunikimin publik. Nëse thuhet e padrejta, e pavërteta, dëmi mund të jetë kolosal. Prandaj edhe Pejgamberi a.s. porositi: "Mjafton që dikush të konsiderohet gënjeshtar nëse përcjell çdo gjë që dëgjon." (Muslimi). Ky është një paralajmërim i fuqishëm kundër qarkullimit të lajmeve të pa verifikuara. Ato duhet të verifikohen, dhe të thuhën gjithmonë lajmet e vërteta.

Këto mësimet paraqesin një paralele të qartë me parimet moderne të etikës së gazetarisë, duke krijuar bazë solide për një qasje të unifikuar etiko-profesionale. Nëse marrim parasysh këto parime fetare, dhe bazën morale e ligjore, atëherë evitohen edhe dezinformimet. Në këtë mënyrë, mbrohemi edhe nga manipulimi informativ dhe nga secila krizë shoqërore që vjen si rrjedhojë e të kundërtës.

Zbulimet e myslimanëve që ndryshuan botën

Nehat Shehu

Historia e zhvillimit të dijes njerëzore është një mozaik hi pasur, ku secili qytetërim ka shtuar gurin e tij të çmuar. Ndër këta gurë, kontributi i qytetërimit islam në periudhën e artë (shekujt VIII–XIV) përbën një shtyllë të rëndësishme që nuk mund të anashkalohet. Në një kohë kur Evropa ishte ende nën hijen e errësirës mesjetare, qytetet si Bagdadi, Kordoba, Damasku, Kajroja dhe Buhara, ishin qendra të gjalla të dijes, ku bibliotekat, observatorët dhe spitalet përfaqësonin kulmin e përparimit shkencor të kohës.

Dijetarët myslimanë nuk u kufizuan vetëm në ruajtjen e trashëgimisë së qytetërimeve të lashta greke, persiane, indiane dhe kineze, por i studiuan, i përkthyen, i sistemuan dhe i zhvilluan më tej, duke dhënë kontribute origjinale që ndryshuan rrjedhën e historisë. Muhamed ibën Musa el Huarizmi themeloi bazat e algjebërës dhe sistemit numerik që përdorim sot; Ibën el Hejthemi revolucionarizoi optikën me metodat e tij eksperimentale; Ebu Kasim el Zehravi vendosi themelet e kirurgjisë moderne; Ismail ibën er Rezzaz el Xheziri krijoi mekanizma të avancuar automatike, pararendës të robotikës së sotme.

Një mënyrë e thjeshtë për të kuptuar ndikimin e arabëve në jetën tonë të përditshme është të imagjinojmë një kafene: hiqni xhaketen dhe rehatohuni mbi sofanë ngjyrë karmine, ku mund të porosisni një filxhan kafe me dy copa sheqeri, një limonadë të ftohtë apo ndonjë ëmbëlsirë me reçel e banane. Çdo gjë që shihni dhe përdorni, kafeja, filxhani, sheqeri, limonada, xhaketa, shalli, mbartin histori dhe emra që vijnë nga bota arabe. Siç thekson Sigrid Hunke: “A do ndiheshit rehat kur gjithçka që ju rrethon, si dhe gjithçka që ju ofroj gjendet në listën e artikujve, të cilët kanë ardhur nga inventarët e botës arabe? Kafeja pa të cilën nuk mund të bëni

në jetën e përditshme, filxhani ku e hidhni ketë pije të zezë, sheqeri, limonada, xhaketa e shalli, të gjitha i njohim falë arabëve. Dhe pothuajse në mbarë botën e gjallëruar, këto gjëra mbajnë ende emrin e tyre arab”. Edhe loja e shahut, ku fjalët “shah” dhe “mat” tregojnë origjinën e tyre arabe, apo stofrat e çmuara si damasku, taftaja, mohair-i dhe satenet me ngjyrat e ndezura si shafrani, portokallia dhe lejlaia, janë dëshmi të pasurisë së dijes dhe artizanatit islam. Në farmaci e dyqane, produktet, si: shafrani, kamfori, boraksi, pambuku dhe talku, po ashtu mbartin emra arab, duke treguar qartë ndikimin e tyre në jetën tonë të përditshme.¹

“Arritëm të ndajmë atomin me ndihmën e 30 librave që kishin mbetur nga qytetërimi i Andaluzisë. Sikur të mos ishin djegur librat e myslimanëve, ne sot do të udhëtonim nëpër galaktika.” Kështu shprehet Pierre Curie, shkencëtar



dhe fizikan francez, njëherësh fitues i çmimit Nobel në fizikë në vitin 1903.

Këto shembuj tregojnë se qytetërimi islam nuk ishte thjesht një ruajtës i dijes së lashtë, por një krijues dhe inovator, që kontribuoi fuqishëm në përparimin e mbarë njerëzimit. Falë këtyre “dhuratave”, një jetë që dikur ishte e thjeshtë dhe e varfër është bërë më e pasur, më e shëndetshme, më higjienike, më rehatshme dhe më elegante. Ky punim synon të shqyrtojë disa nga shpikjet dhe zbulimet më të rëndësishme të myslimanëve, duke u mbështetur në burime autentike historike, për të nxjerrë në pah rolin e tyre të pakrahasueshëm në zhvillimin e shkencës dhe kulturës botërore.

ALGJEBRA DHE KONTRIBUTI I MUHAMED IBËN MUSA EL HUARIZMIT

Një nga kontributet më të rëndësishme të qytetërimit islam në matematikë është zhvillimi i algjebërës, shkencë që hodhi themelet e llogaritjeve moderne dhe të shumë disiplinave të tjera shkencore. Muhamed ibën Musa el Huarizmi ishte dijetari që sistematizoi njohuritë matematike të kohës në veprën e tij “Al Kitab al Mukhtasar fi Hisab al Jabr wal Muqabala”, e cila do të konsiderohej më vonë si teksti themelor i algjebërës. Emri “al-jabr” në titull do të thotë “rikthim” ose “bashkim”, duke iu referuar metodave për zgjidhjen e ekuacioneve lineare dhe kuadratike. Veprat e Huarizmit nuk përmbajnë vetëm ekuacionet, por përshkruajnë metoda të qarta për llogaritjen numerike, përfshirë përdorimin e numrave hindu-arabë, të cilët lehtësuan llogaritjet krahasuar me sistemet romake të numrave. Ai prezanton teknika për reduktimin e ekuacioneve komplekse në forma më të thjeshta dhe zgjidhjen e tyre përmes hapash të logjikshëm, një qasje që mundësoi zhvillimin e mëtejshëm të matematikës në Lindje dhe në Perëndim.

Përveç rëndësisë së saj teorike, algjebra e Huarizmit ka pasur ndikim praktik të madh. Ajo përdorej në tregti, hartim tokash, taksa, astronomi dhe inxhinieri, duke e bërë matematikën një mjet të domosdoshëm në jetën e përditshme. Për shembull, zgjidhja e problemeve mbi ndarjen e pasurisë, llogaritjen e interesit dhe ndërtimin e objekteve, të gjitha u bënë më të lehta falë metodave të Huarizmit.

“Arritëm të ndajmë atomin me ndihmën e 30 librave që kishin mbetur nga qytetërimi i Andaluzisë. Sikur të mos ishin djegur librat e myslimanëve, ne sot do të udhëtonim nëpër galaktika.”
Kështu shprehet Pierre Curie, shkencëtar dhe fizikan francez, njëherësh fitues i çmimit Nobel në fizikë në vitin 1903.

Veprat e tij u përkthyen në latinisht në shekullin XII nga dijetarët evropianë dhe u përhapën nëpër universitete dhe shkolla, duke sjellë revolucionin e parë matematikor në Evropë që më vonë do të mbështeste zhvillimin e shkencës moderne. Pikërisht për këtë arsye, termi “algjebra” është marrë direkt nga titulli i librit të tij, duke treguar se ndikimi i qytetërimit islam në matematikën perëndimore është i drejtpërdrejtë dhe i pazëvendësueshëm.

Algjebra moderne, e cila përdoret sot në shkencë, inxhinieri, ekonomi dhe teknologji, është e pakthyeshme pa bazat që vendosi ky dijetar mysliman i shekullit IX.^{2 3 4}

OPTIKA DHE IBËN EL HEJTHEMI

Një tjetër fushë ku qytetërimi islam dha kontribute thelbësore është optika, shkencë që studion dritën, pamjen dhe mënyrën se si perceptohet vizualisht bota. Ibën el Hejthemi (Abu Ali al Hasan ibën al Haytham, 965–1040) është i njohur si “babai i optikës moderne” për veprën e tij të jashtëzakonshme “Kitab al Manazir” (Libri i Optikës). Në këtë tekst, ai analizon në mënyrë sistematike fenomenet e dritës, reflektimin, thyerjen dhe perceptimin vizual nga syri. Koncepti i tij për modelin e kamerës pinhole ishte një parashikim i hershëm i instrumenteve optike.

Për herë të parë në historinë e dijes, Ibën el Hejthemi përdori metodën eksperimentale për të testuar teoritë e tij, duke u përpjekur të vërtetojë idetë përmes eksperimenteve dhe matjeve, një qasje që do të bëhej themeli i metodës shkencore moderne. Ai theksoi rëndësinë e provave empirike dhe përfundimeve logjike, duke e paraqitur një qasje sistematike ndaj shkencës që e paraqiste në një kontekst më të gjerë.

Kontributi i Ibën el Hejthemit nuk mbeti i izoluar. Veprat e tij u përkthyen në latinisht në shekujt XII–XIII dhe u përhapën në Evropë, duke ndikuar fuqishëm në zhvillimin e optikës dhe instrumenteve optike si lente, teleskopë dhe mikroskopë. Pa punën e tij, puna e dijetarëve evropianë si Kepleri, Galileu dhe Newton nuk do të kishte bazën eksperimentale dhe teorike që përdoren për të zhvilluar shkencën moderne.

Ibën el Hejthemi kombinon analizën teorike me eksperimentin praktik, duke treguar se qytetërimi islam nuk kontribuoi vetëm në akumulimin e dijes, por edhe në mënyrën e vet të menduarit shkencor. Optika e tij nuk



është thjesht studim i dritës; ajo është simbol i përparimit metodik, i rritjes së kuriozitetit dhe i ndikimit të gjallë të dijetarëve myslimanë në mbarë historinë e shkencës.^{5 6} Kjo e bën atë një nga personalitetet më të rëndësishme në historinë e shkencës, duke i dhënë një vend të merituar në panteonin e dijetarëve të mëdhenj.⁷

KIRURGJIA DHE EBU KASIM EL ZEHRAVI

Një tjetër kontribut i rëndësishëm i qytetërimit islam në shkencë është kirurgjia. Ebu Kasim el Zehravi (936–1013) konsiderohet babai i kirurgjisë moderne për veprën e tij monumentale “Et Tesrif li-men ‘axhize ‘an el te ‘lif” (Manuali i kirurgjisë për ata që nuk mund të përgatisin vetë libër). Ky libër përbëhet nga 30 vëllime dhe mbulon një gamë të gjerë temash mjekësore dhe kirurgjikale, duke përfshirë teknika kirurgjikale, mjete operative, trajtimin e plagëve, ortopedinë, stomatologjinë dhe obstetrikën.

El Zehravi nuk ishte thjesht një praktikues i shkencës; ai ishte edhe inovator. Ai përgatiti më shumë se 200 instrumente kirurgjikale, shumë prej të cilave ishin të parat e llojit të tyre në histori. Disa prej këtyre instrumenteve përdoren ende si model bazë në kirurgji moderne. Ai gjithashtu përshkroi teknika të reja kirurgjikale, si operacionet për heqjen e gurëve në veshkë dhe trajtimin e plagëve të thella, duke futur procedura të sigurta dhe sistematike që minimizonin rrezikun për pacientin.^{8 9}

Veprat e Ebu Kasim el Zehravit u përkthyen në latinisht në shekujt XII–XIII dhe shërbyen si manual bazë për kirurgët evropianë deri në shekullin XVI. Një nga arritjet më të rëndësishme të tij ishte kombinimi i teorisë me praktikën, ku çdo metodë kirurgjikale shoqërohej me ilustrime të instrumenteve dhe procedurave, duke e bërë mjekësinë dhe kirurgjinë më të kuptueshme dhe më të aksesueshme për profesionistët. Kontributi i Ebu Kasim el Zehravit tregon qartë se qytetërimi islam nuk ishte thjesht ruajtës i dijes, por

një qendër inovacioni ku zhvilloheshin praktika dhe instrumente që ndryshuan jetën e njerëzve dhe vendosën themelet e kirurgjisë moderne. Përmes punës së tij, shumë nga teknikat dhe instrumentet që përdoren sot në mbarë botën kanë rrënjët e tyre në dijen dhe përparimet e dijetarëve myslimanë të Mesjetës.¹⁰

MEKANIKA DHE AUTOMATIKAT E ISMAIL IBËN ER REZZAZ EL XHEZIRIT

Një tjetër kontribut i jashtëzakonshëm i qytetërimit islam në shkencë është mekanika dhe krijimi i pajisjeve automatike. Ismail ibën er Rezzaz el Xheziri (1136–1206) është i njohur si “babai i robotikës” për veprën e tij të famshme “El Xhamiu bejne-l-Ilmi ve-l-Ameli en Nafi’ fi Sina’ati el Hijel”, ku përshkruan më shumë se 100 makina dhe mekanizma, shumë prej të cilave funksiononin automatikisht. Pajisjet e tij përfshinin orë uji, shpërndarës të ujit, lodra mekanike, instrumente muzikore të vetëluftueshme dhe makina të tjera, që tregojnë kuptimin e avancuar të përdorimit të forcës, rrotave dhe ingranazheve.

Xheziri nuk e trajtoi mekanikën vetëm si një praktikë inxhinierike, por gjithashtu si shkencë dhe art. Ai përdorte principet e levës, rrotullimit dhe transmetimit të lëvizjes për të krijuar pajisje të sakta dhe funksionale. Për shembull, disa nga automatikat e tij mund të funksiononin për disa minuta pa ndërhyrje njerëzore, duke treguar njohuri të thella mbi dinamikën dhe energjinë mekanike.

Veprat e Xhezirit u përkthyen më vonë në latinisht dhe ndikuan në zhvillimin e mekanikës evropiane gjatë shekujve XIII–XV. Pajisjet e tij u përdorën si modele për orët mekanike dhe instrumentet muzikore të hershme, duke treguar se qytetërimi islam nuk kontribuoi vetëm në teorinë shkencore, por edhe në aplikimin praktik të shkencës në jetën e përditshme.

Kontributi i Xhezirit tregon qartë se dijetarët myslimanë nuk ishin vetëm teoretikë, por edhe inovatorë dhe shpikës, të aftë të bashkonin teorinë, matematikën dhe praktikitetin për të krijuar pajisje që do të linin gjurmë deri në epokën moderne. Mekanizmat e tij janë paraardhës të robotikës dhe inxhinierisë moderne, duke dëshmuar se qytetërimi islam vendosi themelet e shumë fushave të shkencës dhe teknologjisë.^{11 12}

IBËN SINA DHE SHPIKJET NË MJEKËSI DHE SHKENCË

İbën Sina (980–1037), i njohur në Evropë si Avicenna, është një nga figurat më të shquara të qytetërimit islam, duke lënë gjurmë të thella në mjekësi, farmaci, filozofi dhe shkencë natyrore. Vepra e tij më e famshme “El Kanun fi et Tibb” (Kanuni i Mjekësisë), ishte një enciklopedi e madhe mjekësore që përshkruante anatominë, fiziologjinë,

diagnostikimin, trajtimin e sëmundjeve dhe përdorimin e barnave. Ky libër u përdor si manual bazë në universitetet evropiane për rreth 600 vjet dhe mbeti një nga burimet më të rëndësishme për mjekësinë deri në shekullin XVIII.

Ibën Sina nuk ishte thjesht një studiues teorik; ai ishte shpikës dhe inovator në metodologji dhe praktikë mjekësore. Ai krijoi një qasje të organizuar për trajtimin e sëmundjeve, duke ndarë sëmundjet sipas simptomave dhe mënyrës së trajtimit, duke përshkruar mbi 760 barnave dhe përzierjeve medikamentesh që përdoren edhe sot si bazë për disa ilaçe. Ai sugjeroi përdorimin e instrumenteve për matje dhe diagnozë, si p.sh. për vëzhgimin e pulsit dhe gjendjes së trupit, dhe propozoi metoda për studimin eksperimental të proceseve fiziologjike.

Përveç kësaj, Ibën Sina përshkroi konceptet e patofiziologjisë, duke treguar se si sëmundjet ndodhin në organet specifike dhe si ndikojnë ato në trup, duke paraqitur kështu një qasje të hershme sistematike të shkencës klinike. Metodot e tij analitike dhe eksperimentale shërbyen si një themel i rëndësishëm për zhvillimin e shkencës moderne dhe për shpikjen e qasjes sistematike në mjekësi.

Veprat e Ibën Sinasë ndikuan fuqishëm në Evropë. Përmes përkthimeve latine në shekujt XII–XIII, Kanuni i Mjekësisë u bë manual kryesor në shkolla mjekësore në Itali, Francë dhe Gjermani, duke shërbyer si udhëzues për studentët dhe mjekët për shumë shekuj. Kontributi i tij nuk kufizohej vetëm në përhapjen e dijes, por krijoi një qasje sistematike, ku teoritë mjekësore dhe praktikat klinike kombinoheshin për të garantuar trajtim të saktë dhe të bazuar mbi evidencë.

Ibën Sina përfaqëson urinë për dijen, kombinimin e teorisë dhe praktikës, dhe ndikimin e qytetërimit islam në shkencën globale. Punët e tij, veçanërisht në mjekësi dhe farmaci, vazhdojnë të jenë një burim frymëzimi dhe referencë për studiuesit dhe profesionistët e sotëm, duke dëshmuar se qytetërimi islam ishte një qendër inovacioni dhe udhëheqësi në zhvillimin e shkencës botërore.^{13 14 15 16}

Në fund të shkrimit, mund të themi se, përmes shekujve, qytetërimi islam ka lënë një trashëgimi të jashtëzakonshme në shkencë, mjekësi, matematikë, mekanikë dhe optikë, duke ndryshuar rrjedhën e dijes dhe jetës njerëzore. Figurave si Muhamed ibën Musa el Havarizmi, Ibën el Hejthemi, Ebu Kasim el Zehravi, Ismail ibën er Rezzaz el Xheziri dhe Ibën

Pas çdo kontributi shkencor modern që ne e marrim si të natyrshëm, gjendet një histori e pasur me kreativitet, dedikim dhe dijeni të qytetarëve myslimanë të Mesjetës, të cilët ndryshuan botën në mënyrë të qëndrueshme dhe të paharrueshme.

Sina u detyrohemi për shumë nga konceptet, metodat dhe instrumentet që sot konsiderohen pjesë e përparimit shkencor global. Algjebra, metoda eksperimentale në optikë, instrumentet kirurgjikale, makineritë automatike dhe qasja sistematike në mjekësi nuk janë thjesht arritje teknike, por dëshmi e kuriozitetit, inovacionit dhe vizionit për përparimin e dijes që karakterizonte dijetarët myslimanë. Në këtë mënyrë, qytetërimi islam nuk ishte thjesht një transmetues i dijes antike, por një qendër inovacioni dhe përparimi shkencor, ku shpikjet dhe metodat e zhvilluara nga dijetarët myslimanë vazhdojnë të ndikojnë në mbarë botën edhe në shekullin XXI. Dhe themi se, pas çdo kontributi shkencor modern që ne e marrim si të natyrshëm, gjendet një histori e pasur me kreativitet, dedikim dhe dijeni të qytetarëve myslimanë të Mesjetës, të cilët ndryshuan botën në mënyrë të qëndrueshme dhe të paharrueshme. Them i se kjo trashëgimi duhet të njihet dhe vlerësohet si një burim frymëzimi për dijen dhe inovacionin e sotëm.

- 1 Sigrid Hunke, Shems el Arab testa ala el Garb, Përkthyer në arabisht nga Faruk Bejdun, Kemal Dusukij, f. 15.
- 2 Muhamed ibën Musa el Huarizmi, El Kitab el Muhtasar fi Hisab el Xhebr uel Mukabale (Kajro: Dar el Kutub el Ilmijje, 1986), f. 45–47.
- 3 George Sarton, Introduction to the History of Science, f. 534–537.
- 4 <https://www.newscientist.com/people/muhammad-ibn-musa-al-khwarizmi/>
- 5 <https://www.ibnalhaytham.com/discover/who-was-ibn-al-haytham/>
- 6 Olaf Pedersen, Early Physics and Astronomy: A Historical Introduction, f. 102–105.
- 7 Po aty.
- 8 Peter E. Pormann dhe Emilie Savage-Smith, Medieval Islamic Medicine, f. 62–65.
- 9 <https://www.independent.co.uk/news/science/how-islamic-inventors-changed-the-world>
- 10 <https://edition.cnn.com/2010/WORLD/meast/01/29/muslim-inventions/>
- 11 Ahmed Delal, Islam, Science, and the Challenge of History, f. 88–90.
- 12 <https://www.independent.co.uk/news/science/how-islamic-inventors-changed-the-world>
- 13 <https://plato.stanford.edu/entries/ibn-sina/>
- 14 Emilie Savage-Smith, Islamic Science, f. 95–100.
- 15 F. Najmuddin, Avicenna and his Influence on Medieval Medicine, f. 12–25.
- 16 Donald R. Hill, Islamic Science and Engineering, f. 78–85.

“Vakëfi te shqiptarët – histori – trashëgimi – perspektivë”

Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, organizoi Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Vakëfi te shqiptarët – histori – trashëgimi – perspektivë”, e cila u mbajt më 8 dhe 9 dhjetor 2025.

Kjo Konferencë, e mbështetur nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, përkatësisht nën kujdesin e Myftiut Naim ef. Tërnavë, përreth vetes mblodhi mbi pesëdhjetë studiues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriu, Mali i Zi dhe më gjerë, të cilët me kumtesat e tyre shpalosën historikun, vlerën, rëndësinë, trashëgiminë dhe perspektivën e vakëfit ndër shqiptarët.

Në hapjen e kësaj Konference, përveç përfaqësuesve më të lartë të institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës, morën pjesë edhe përfaqësues nga vendet e ndryshme islame, si nga Arabia Saudite, Turqia, Katari, Emiratet e Bashkuara Arabe etj., të cilët shpalosën projektet e tyre vakëf të realizuara në vendin tonë.

Në hapjen e kësaj Konference, të pranishmëve, me një fjalë përshëndetëse, në emër të organizatorit, iu drejtua drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora, i cili ndër të tjera tha se: “Kjo Konferencë dy ditore, është vazhdimësi e organizimit të konferencave të tilla shkencore nga ana e IHSI-së. Në Konferencën e vitit 2023, në fokus kishim temën bosht: “Xhamia te shqiptarët, histori, mision, identitet”, dhe sipas të gjitha vlerësimeve doli shumë e suksesshme, falë studimeve dhe hulumtimeve akademike të referuesve, që ua bënë rolit historik të xhamive në të gjitha trojet tona, e madje kishim referues që u morën edhe me historikun e xhamive të ndërtruara nga personalitete shqiptare nëpër botë, si në: Egjipt, Siri, Turqi, në diasporë, Evropë e ShBA.”

Ai më pas foli edhe rreth arsyes se përse është zgjedhur pikërisht tema e vakëfeve për ta organizuar këtë Konferencë, duke thënë se Vakëfi, si institucion i lashtë i bamirësisë, ka



genë ndër shtyllat më të qëndrueshme të qytetërimit islam dhe një ndër mekanizmat më të rëndësishëm për zhvillimin e kulturës, arsimit dhe jetës publike edhe në trojet shqiptare.

Ai më pas foli edhe rreth tranzicionit të pandalshëm ekonomik, kulturor dhe teknologjik, që është duke kaluar shoqëria jonë dhe rreth roli të vakëfit në këtë realitet. “Sot, kur shoqëritë tona gjenden në një tranzicion të pandalshëm ekonomik, kulturor dhe teknologjik, vakëfi mund të shndërrohet sërish në një ndër mekanizmat më të fuqishëm për zhvillim të qëndrueshëm, veçanërisht në fushat e arsimit, kulturës, shërbimeve sociale dhe mbrojtjes së trashëgimisë. Por, kjo kërkon strategji, transparencë, vizion dhe mbi të gjitha, një qasje moderne që i respekton rrënjët e vakëfit, duke e bërë atë funksional për brezat që vijnë” – tha ndër të tjera prof. Bajgora.

Në fund, ai falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e tyre dhe për gatishmërinë për të ndarë dijen me ne.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, në fjalën e tij përshëndetëse, drejtuar të pranishmëve, çmoi lart organizimin e Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, duke shprehur kështu gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës që të përkrahë nisma të tilla, të cilat ndriçojnë rolin dhe historikun e vakëfeve të shqiptarët. Ai tha se: “Të flasësh për vakëfin nuk është thjesht të përshkruash një institucion juridik; do të thotë të flasësh për një traditë të gjatë dhe të thellë të popullit tonë, për një amanet të çmuar që na kanë lënë paraardhësit tanë – njerëz të mirë, bujarë dhe fisnikë – të cilët kanë synuar jo vetëm t’i ruajnë pasuritë materiale, por edhe të krijojnë një ndikim të qëndrueshëm shoqëror dhe shpirtëror.”

Duke folur për ndikimin që ka luajtur vakëfi në jetën e besimtarëve, Myftiu Tërnavë, ndër të tjera tha se: “Vakëfi ndikoi thellësisht në jetën fetare, morale, ekonomike, arsimore dhe urbane të shoqërive islame. Përmes vakëfit u ndërtuan xhami, medrese, biblioteka, ura, rrugë, hane, spitale, mejtepe, si dhe struktura të panumërta shërbimesh publike. Ky ndikim u shtri fuqishëm përgjatë shekujve edhe ndër shqiptarët. Thënë shkurt, nuk ekziston asnjë aspekt i jetës së popujve myslimanë, qoftë aspekt fetar, moral, ekonomik, politik apo social, ku vakëfi të mos ketë pasur ndikim të thellë. Me pranimin e fesë islame, i cili ndodhi për arsye të ndryshme fetare, kulturore, politike dhe shoqërore nga shumica e popullsisë shqiptare që nga fundi i shekullit XIV, shqiptarët u njohën edhe me institucionin e Vakëfit.”

Myftiu Tërnavë, më pas foli edhe për Vakëfin si institucion ndër shqiptarët, duke thënë se, shqiptarët, mbi baza vakëfi, themeluan një sërë institucionesh fetare, arsimore, kulturore, ekonomike dhe sociale: xhami, medrese, biblioteka, hamame, bezistane (treg i mbuluar – pazar i vjetër), hane, ura, imarete, çezma e të ngjashme. Ai tha se: “Vakëfi i parë i dokumentuar ndër shqiptarë është ai i Manastirit, që e vakëfnoi Sungur Çauš Beu, në vitin 1434. Pastaj vakëfi i Is’hak Beut, i themeluar në Shkup në vitin 1444, vakëfi i Suzi Çelebiut në Prizren në vitin 1513, vakëfi Kuklibegut në Prizren në vitin

1538, vakëfi i pesë herë sadriazemit Koxha Sinan Pashës dhe lista vazhdon me vakëfet e personaliteteve dhe familjeve të shquara shqiptare, si Bushatlinjve të Shkodrës, Mahmudbegollëve të Pejës, Kurtpashajve të Gjakovës, Bargjinollëve të Tiranës, Biçakçinëve të Elbasanit, Derallajve të Tetovës, Ngurzajve të Beratit, Alihajdarbegollëve të Kavajës, Rrotllajve të Prizrenit, Gjinollajve të Prishtinës dhe shumë e shumë të tjerëve që është e pamundur të përmenden të gjithë këtu.”

Gjatë fjalës së tij, Myftiu Tërnavë, nuk la pa përmendur edhe shkatërrimin që iu është bërë vakëfeve, qoftë nga faktorët natyrorë qoftë edhe nga ata njerëzorë, sidomos në shekullin e kaluar, kur shumë vakëfe u shkatërruan, u konfiskuan ose iu ndryshua destinacioni nga ish-sistemi okupues komunist-ateist. “Duhet të theksojmë se nuk ekziston asnjë institucion fetar që të ketë pësuar kaq shumë goditje dhe shkatërrime sa vakëfi. Kjo ka ndodhur për shkak të sistemeve politike, dhe qëndrimeve të tyre ndaj fesë në përgjithësi dhe ndaj Islamit në veçanti. Vetëm gjatë luftës së fundit në Kosovë (1998–1999) u shkatërruan, u dogjën, ose u dëmtuan 218 xhami, rreth 40% e xhamive ekzistuese në atë kohë në Kosovë, pa përmendur këtu edhe shkatërrimin e trashëgimisë tjetër islame me vlera të çmuara historike dhe kulturore, biblioteka, arkiva, dorëshkrime etj.. Në Shqipëri, pas vitit 1967, regjimi komunist shkatërroi qindra objekte fetare, përfshirë xhami monumentale. Edhe në Maqedoni u shkatërruan dhjetëra xhami gjatë regjimit komunist dhe luftës së vitit 2001 (ku u shkatërruan 56 xhami të rrënuara).”

Në fund të fjalës së tij, Myftiu Tërnavë, përmendi dhe falënderoi shtetet mike, të cilat i qëndruan pranë Kosovës në ditët më të errëta të historisë sonë, në kohën e luftës së fundit. “Do të veçoja ndihmën nga disa shtete islame, si: Arabia Saudite, Turqia, Emiratet e Bashkuara Arabe, Katari, Kuvajti dhe nga të gjitha vendet e tjera, që i qëndruan Kosovës pranë në ditët më të errëta të historisë sonë, në kohën e luftës së fundit, kur shumë vakëfe shekullore u shkatërruan nga





kriminelet serbë, vakëfe me vlera të pallogaritshme historike, fetare dhe kulturore” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Një fjalë përshëndetëse para të pranishmëve e mbajti edhe drejtori Ekzekutiv i Ministrisë së Çështjeve Islame, Vakëfeve dhe Zekatit nga Emiratet e Bashkuara Arabe, Muhamed al Bolushi, i cili shprehu falënderimet dhe mirënjohjen e tij të thellë ndaj Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame për organizimin e kësaj Konference, duke potencuar më pas rolin dhe ndikimin që ka luajtur vakëfi. “Që nga zanafilla e historisë së qytetërimit islam, vakëfi ka qenë një institucion ekonomik dhe social me ndikim, që ka kontribuar në zhvillimin e qytetërimit, në sigurimin e arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies, si dhe në forcimin e kohezionit social dhe mbrojtjen e identitetit. Me ritmet e shpejta të ndryshimeve botërore, roli i vakëfit bëhet edhe më i rëndësishëm si një mekanizëm zhvillimor i qëndrueshëm, që siguron burime të pavarura dhe mbështet iniciativat komunitare për përmbushjen e nevojave të shoqërisë.”

Më pas, ai foli edhe rreth sistemit të vakëfeve në Emiratet e Bashkuara Arabe, për të cilin tha se gëzon mbështetje dhe kujdes të drejtpërdrejtë nga Qeveria dhe udhëheqja e saj vizionare. “Kjo mbështetje është manifestuar në: zhvillimin e mekanizmave juridikë dhe ligjorë të vakëfit, fuqizimin e institucioneve vakëfore dhe nismave lidere, zgjerimin e fushave të vakëfit për t’iu përgjigjur nevojave bashkëkohore të shoqërisë, përdorimin e të dhënave dhe analizave për të maksimizuar ndikimin ekonomik dhe social” – tha ndër të tjera Al Bolushi.

Zëvendësdrejtori gjeneral i Drejtorisë së Vakëfeve të Turqisë, z. Hayrullah Çelebi, në fjalën e tij përshëndetëse, tha se: “Në të gjitha hapësirat e gjera ku Perandoria Osmane hodhi rrënjë, vulën më të fortë e la pikërisht përmes vakëfit, e cili ka një traditë të thellë islame. Në çdo vend që ka hyrë nën administrimin osman, janë ngritur vepra të qëndrueshme dhe madhështore, të ndërtuara pikërisht me këtë frymë.”

Ai më pas foli edhe rreth projekteve që ka Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve të Turqisë, duke përmendur kështu

se kanë marrë përsipër detyrën për ta mbrojtur pasurinë kulturore të vakëfeve të traditës turko-islame. “Duke ndjekur këtë qasje, që prej vitit 2013 e deri më sot, kemi përfunduar restaurimin dhe ringjalljen e 40 objekteve të trashëgimisë së vakëfeve në Ballkan, duke iu rikthyer atyre identitetin e tyre origjinal. Sa i përket Kosovës, ndër objektet që kemi përfunduar deri tani janë: në Gjakovë – Medreseja e Vogël, Qendra e Trajnimeve, biblioteka që mban gjallë dijen e vakëfit, Xhamia e Mulla Jusufit, Xhamia e Sefës, Xhamia e Kusarëve; në Pejë – Xhamia e Çarshisë në Pejë; si dhe Xhamia e fshatit Suriganë. Ndër objektet që kanë kaluar në restaurim, përveç vendeve të adhurimit, janë edhe Kulla e Sahatit në Mamushë dhe Kursi i Kuranit në Rahovec. Ndërkaq, në programin tonë të investimeve kemi përfshirë edhe vepra që mbajnë gjurmë vakëfi, si Xhamia Atik në Gjilan, Xhamia e Hasan Agës në Rogovë dhe Xhamia e Gazi Ali Beut në Vushtrri” – tha ndër të tjera z. Çelebi.

Ndërkaq, në fund të fjalimeve, një fjalë përshëndetëse e mbajti edhe zëvendësguvernatori i Autoritetit Gjeneral (të Përgjithshëm) të Vakëfeve të Saudisë, dr. Fehd el Maxhid.

Ai potencoi faktin se si Mbretëri e Arabisë Saudite kemi qenë gjithnjë përkrahës të Kosovës dhe se këtë përkrahje do ta vazhdojmë edhe me tutje.

“Ne në Mbretërinë e Arabisë Saudite kemi qenë përkrahës të Kosovës, që nga koha e luftës dhe sigurisht se jemi edhe tash të gatshëm për të ofruar ndihmën tonë. Në fushën e vakëfeve, po vërejmë një përmirësim të dukshëm dhe edhe ne kemi të njëjtën çështje dhe punojmë në shumë sfera që të bëjmë zhvillimin e vakëfeve dhe për të përmirësuar vetëdijesimi për rëndësinë e tyre” – tha ndër të tjera El Maxhid.

Në fund të ceremonisë hapëse, u shfaq një video dokumentar, që prezantonte kontributin e shteteve mike të Kosovës në ndërtimin dhe restaurimin e objekteve vakëf. Më pas, Konferenca vazhdoi punimet me paraqitjen e referuesve

40-vjet nga botimi i përkthimit të plotë të Kuranit në shqip – kujtesë, mirënjohje, reflektim

Ramadan Shkodra

Në këtë akademi solemne jemi tubuar për të shënuar një përvjetor të veçantë, që për nga kuptimi i tij shpirtëror, kulturor dhe shkencor, tejkalon kufijtë e një ngjarjeje kalendarike, 40-vjetorin e botimit të përkthimit të plotë të Kuranit në gjuhën shqipe.


Shënimi i përvjetorëve të veprave të mëdha nuk është vetëm një rikthim në histori. Ai është një akt i vetëdijshëm kulturor dhe shkencor, që na fton të reflektojmë mbi rrugëtimin e dijes dhe të besimit, mbi zhvillimet që kanë pasuar dhe mbi vlerat që mbeten të qëndrueshme në kohë. Përvjetorët na kujtojnë se veprat e mëdha nuk i përkasin vetëm një brezi apo epoke, por janë pasuri e gjallë e kujtesës

dhe e frymëzimit që ushqen brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Në këtë frymë nderimi dhe reflektimi, sot kujtojmë dhe vlerësojmë një ndër arritjet më të rëndësishme të mendimit islam dhe të kulturës kombëtare shqiptare, botimin e plotë të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe, të realizuar në Prishtinë më 1985 nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe përkthyer me përkushtim, dije të thellë dhe ndjeshmëri gjuhësore nga profesor Feti Mehdiu.

Ky botim hapi rrugën e një epoke të re të komunikimit ndërmjet besimit dhe gjuhës, duke e bërë fjalën e Zotit të





kuptueshme për çdo shqiptar që dëshiron ta lexojë dhe ta përjetojë Kuranin në gjuhën e vet amtare.

Kurani është teksti themelor i Islamit dhe konsiderohet nga myslimanët si shpallja hyjnore e drejtpërdrejtë e Zotit (Allahut), e zbritur Pejgamberit Muhamed a.s., në gjuhën arabe gjatë viteve 610–632. Ai përbën burimin parësor të besimit islam, të praktikës fetare, të etikës dhe të rendit normativ, duke u plotësuar nga Suneti profetik.

Në aspektin teologjik, Kurani përcakton parimet e monoteizmit, raportin Zot–njeri–univers dhe konceptet themelore të përgjegjësisë morale dhe jetës së përtejme. Në aspektin juridik dhe shoqëror, ai ka shërbyer si bazë normative për zhvillimin e jurisprudencës islame dhe institucioneve shoqërore në botën islame.

Ndikimi i Kuranit shtrihet përtej sferës fetare, duke pasur një rol strukturor në formësimin e qytetërimit botëror. Ai ka ndikuar në ndërtimin e sistemeve juridike islame, në zhvillimin e mendimit etik dhe në organizimin e jetës shoqërore në hapësira të gjera gjeografike.

Në planin intelektual dhe shkencor, Kurani ka nxitur kërkimin e dijes, reflektimin racional dhe studimin e natyrës, duke kontribuar në zhvillimin e shkencave gjatë Mesjetës Islame dhe, përmes transmetimit të dijes, edhe në qytetërimin evropian.

Në planin kulturor dhe estetik, ai ka ndikuar në letërsi, art, arkitekturë dhe kaligrafi, ndërsa në planin etik dhe shoqëror, ka formësuar parime universale si drejtësia, solidariteti dhe barazia njerëzore. Gjithashtu, Kurani ka qenë një faktor i rëndësishëm në dialogun ndërfetar dhe ndërqytetëruës.

Ky ndikim i gjithanshëm i Kuranit në historinë e dijes dhe të qytetërimit ka bërë që ai të përkthehet ndër shekuj në rreth njëqind gjuhë të botës, për t'u bërë i kuptueshëm për njerëz

të kombeve dhe kulturave të ndryshme. Përkthimi i Kuranit në gjuhë të ndryshme ka qenë thelbësor për përhapjen dhe kuptimin e mesazhit islam përtej botës arabishtfolëse. Edhe pse teksti origjinal arab mbetet normativ në adhurim, përkthimet kanë shërbyer si mjete interpretative për transmetimin e kuptimeve.


Përkthimi i Kuranit në gjuhë të ndryshme ka luajtur rol fetar-edukativ, kulturor-gjuhësor dhe akademik, duke pasuruar gjuhët pritëse, duke nxitur studime krahasuese dhe duke lehtësuar dialogun ndërfetar dhe ndërkulturor. Përkthimi i Kuranit ka theksuar gjithashtu dallimin ndërmjet shpalljes hyjnore dhe interpretimit njerëzor, duke kontribuar në zhvillimin e hermeneutikës islame.

Ndër këto gjuhë, tashmë katër dekada më parë, Kurani u përkthye dhe u botua i plotë edhe në gjuhën shqipe.

Përkthimi i Kuranit në gjuhën shqipe ka qenë një nevojë fetare, kulturore dhe kombëtare për myslimanët shqiptarë, të cilët nuk kishin njohuri të mjaftueshme të arabishtes. Ai ka mundësuar kuptimin e drejtpërdrejtë të mesazhit kuranor, edukimin fetar dhe ruajtjen e identitetit fetar në gjuhën amtare.

Njëkohësisht, përkthimi i Kuranit në shqip përfaqëson një akt afirmimi të gjuhës shqipe në fushën e teksteve të shenjta dhe një kontribut të rëndësishëm në kulturën dhe dijen shqiptare.

Ky përkthim historik i vitit 1985 dëshmoi jo vetëm pasurinë shprehëse dhe forcën shpirtërore të gjuhës shqipe, por edhe pjekurinë profesionale dhe përgjegjësinë institucionale të studiuesve dhe të institucioneve islame shqiptare. Ai është dëshmi se në hapësirën tonë kulturore, feja dhe gjuha kanë ecur bashkë, duke i vënë në shërbim të njëra-tjetres dijen,



urtësinë dhe përhapjen e vlerave universale të paqes, drejtësisë dhe mëshirës që përçon Kurani.

Megjithëse prania e Kuranit te shqiptarët është e hershme sa edhe prania e Islamit, s'do mend se edhe interesimi, përkushtimi dhe kontributi i shqiptarëve ndaj dhe për Kuranin janë të hershme e të dukshme. Nga radhët e tyre kanë dalë shumë njohës, komentues, hafëzë dhe lexues të spikatur të Kuranit; dhe në anën tjetër, ata kanë jetuar dhe vepruar sipas porosive të tij.

Ndër shqiptarët, përpjekjet dhe iniciativat e para për përkthimin e Kuranit në gjuhën shqipe i gjejmë që në kohën e Rilindjes Kombëtare. Punën e parë serioze në këtë drejtim e ndërmori Ilo Mitko Qafëzezi, i cili në Ploeshti të Rumanisë, më 1921, botoi në shqip gjashtë suret e para të Kuranit. Në këtë periudhë, ndër nismëtarët për përkthimin e Kuranit gjejmë personalitete të shquara të islamologjisë dhe të atdhetarizmit, si Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ali Korça dhe posaçërisht Hafiz Ibrahim Dalliu, të cilët ishin njohës të mirë të shkencave islame dhe të përgjithshme, për ta vazhduar këtë përpjekje në vitet e 60-ta edhe profesori Muharrem Blakçori, përkthimi i së cilit mbeti në dorëshkrim.

Me gjithë vullnetin dhe përkushtimin e madh të këtyre kolosëve për ta përkthyer Kuranin në shqip, rrethanat historike nëpër të cilat kaloi Shqipëria dhe shqiptarët nuk e lejuan konkretizimin

e këtij misioni.

Ky mision u bë realitet vetëm më 1985, falë qarkut të ulemave të Kosovës, që ishin të përqendruar në Prishtinë, e cila në vitet '70, përveçse qendër e rëndësishme administrative, ishte shndërruar edhe në një qendër të rëndësishme kulturore, arsimore e universitare dhe njëherësh në vatrë të kulturës islame shqiptare.

Kështu, siç e cekem edhe më sipër më 1985, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës pati fatin e mirë dhe privilegjin e madh të përmbushte një mision sa të rëndësishëm aq edhe sfidues: botimin e Kuranit të përkthyer nga profesor Feti Mehdiu, duke e bërë shqipen gjuhë që e njeh Kuranin dhe duke ua ofruar besimtarëve e opinionit shqipfolës fjalën e Zotit në gjuhën e tyre amtare.

Por jo vetëm kaq, vetëm tri vite më vonë, po në Prishtinë, u botuan edhe dy përkthime të tjera të Kuranit, ai i H. Sherif Ahmetit dhe ai i Hasan ef. Nahit.

Përkthimi i Kuranit në shqip nuk është vetëm një arritje fetare, por edhe një ngjarje kulturore dhe shpirtërore që forcon identitetin kombëtar.

Sot, kur shënojmë këtë përvjetor të shënuar, me respekt e mirënjohje kujtojmë, çmojmë e vlerësojmë brezat e dijetarëve, që e bënë të mundur që fjala e Zotit të kumbojë në gjuhën shqipe. Ata u bënë urë ndërmjet dritës së shpalljes dhe mendjes së kombit tonë.

Le të jetë kjo akademi një kujtesë e gjallë dhe një ftesë e përhershme për ta ruajtur, studiuar dhe përhapur trashëgiminë e tyre. Sepse Kurani në shqip nuk është vetëm dëshmi e besimit, por edhe gurthemeli i vetëdijes sonë kombëtare dhe shpirtërore.

Megjithatë, përkthimet bashkëkohore përfaqësojnë një arritje të rëndësishme fetare, akademike dhe kulturore, duke krijuar bazë të qëndrueshme për edukim fetar, studime shkencore dhe një qasje më të vetëdijshme të shqiptarëve ndaj Kuranit.

“Kujtesa në fotografi – xhamitë e shkatërruara në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë gjatë viteve '90 – sakralocid i planifikuar”

Organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës në bashkëpunim me Rijasetin e Bashkësisë Islame të Bosnjë dhe Hercegovinës, të enjten më 18 dhjetor 2025, në Prishtinë, u hap ekspozita “Kujtesa në fotografi – xhamitë e shkatërruara në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Kosovë gjatë viteve '90 – sakralocid i planifikuar”, e cila dokumenton shkatërrimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore gjatë viteve '90, si pjesë e një strategjie të qëllimshme për fshirjen e identitetit fetar, kulturor dhe historik të myslimanëve në Ballkan.

Në hapje, përveç përfaqësuesve të lartë fetarë të dy bashkësive islame, asaj të Kosovës dhe asaj të Bosnjë dhe Hercegovinës, ishte i pranishëm edhe kryeministri në detyrë i Kosovës, z. Albin Kurti, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij.

Në emër të organizatorit, drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, Ramadan Shkodra, tha se ekspozita dokumenton qartë dhe në mënyrë autentike shkatërrimin sistematik të xhamive gjatë luftës dhe përfaqëson një akt të rëndësishëm të kujtesës historike dhe reflektimit shoqëror. Ai theksoi se fotografitë dëshmojnë dhunën e organizuar dhe sakralocidin mbi monumentet e trashëgimisë islame, si pjesë e një projekti politik e ushtarak serb që synonte krijimin e një

realiteti të ri etnik e kulturor. “Derisa i shikojmë këto fotografi, nuk shohim vetëm muret e djegura e të rrënuara; shohim historinë e një populli, dhimbjen e një komuniteti dhe boshllëkun që lë pas shkatërrimi i identitetit kulturor”, tha z. Shkodra. Ai shtoi se ekspozita nuk është thjesht kujtesë e së kaluarës, por akt i fuqishëm i drejtësisë historike që u jep zë të heshturve me dhunë, ruan kujtimin e të flijuarve dhe na obligon të mos lejojmë harresën.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, tha se ky aktivitet paraqet një kapitull të dhimbshëm të historisë sonë të afërt, që i ka bashkuar dy popujt në përjetimin e vuajtjeve, dhunës së organizuar dhe krimit shtetëror. Ai theksoi se, si në Bosnjë dhe Hercegovinë ashtu edhe në Kosovë, regjimi synoi zhdukjen fizike, kulturore dhe shpirtërore të popujve autoktonë, me qëllim krijimin e një hapësire etnikisht të pastër serbe: Bosnjë pa boshnjakë myslimanë dhe Kosovë pa shqiptarë. Përveç dhunës fizike, vrasjeve, ekzekutimeve e dëbimeve, u ndërмор edhe një fushatë e gjerë e shkatërrimit të trashëgimisë kulturore e fetare, ku objektiva të veçanta u bënë objektet fetare islame.





Myftiu Tërnavë foli edhe për numrin e xhamive dhe objekteve me rëndësi të trashëgimisë islame të shkatërruara, duke potencuar se u rrënuan xhami shekullore (shumë prej tyre unike), çarshi historike, medrese, biblioteka, arkiva dhe institucione të tjera arsimore e kulturore, të mbështetura në vakëfe të themeluara nga shqiptarë e boshnjakë, nga ulema, dijetarë dhe bamirës. Ai theksoi se gjatë viteve '90 u shkatërruan gjithsej 832 xhami: 218 në Kosovë dhe 614 në Bosnjë dhe Hercegovinë, pa përfshirë objektet e tjera fetare e kulturore. U shkatërruan qendra historike dhe çarshi identitare në Kosovë (Pejë, Gjakovë, Vushtrri), kompleksi i kullave në Junik, Deçan, Nivokaz e zona të tjera, si dhe xhami monumentale si Xhamia e Bajrakalisë në Pejë, Xhamia e Hadum Agës në Gjakovë, medresetë historike të Gjakovës, Xhamia e Llapit në Prishtinë, xhamitë monumentale të Vushtrrisë dhe xhami në Mitrovicë, përfshirë Xhaminë e Ibrit, e shkatërruar deri në themele e me truall të rrafshuar, me qëllim zhdukjen e çdo gjurme të pranisë shqiptare dhe myslimane. Në mënyrë të ngjashme, shpesh edhe me intensitet më të madh, forcat serbe vepruan edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë; mjafton të përmenden Xhamia e Foçës, ajo e Banja Llukës, Ura e Mostarit dhe shumë objekte të tjera anekënd Bosnjës, dëshmitë vizuale të cilave paraqiten në ekspozitë.

Në fund të fjalës së tij, Myftiu Tërnavë propozoi që materialet shoqëruese, përfshirë katalogun, të përgatiten edhe në gjuhën angleze dhe arabe, për t'u ofruar miqve ndërkombëtarë dëshmi të qarta, të dokumentuara e të pakontestueshme mbi atë që ishte i planifikuar dhe i zbatuar nga regjimi serb. Ai tha se bota e qytetëruar duhet të rikujtohet vazhdimisht, sepse vetëm përmes kujtesës aktive dhe dëshmisë së dokumentuar shlyejmë një pjesë të borxhit moral ndaj shehidëve, viktimave të luftës dhe historisë.

Kryeministri në detyrë, z. Albin Kurti, tha se trashëgimia kulturore është themeli i identitetit tonë kolektiv, na lidh me të kaluarën, forcon vetëdijen për vlerat e përbashkëta dhe na

kultivon përgjegjësinë për ruajtjen e kujtesës historike. Ai foli për hapat konkretë të Qeverisë së Republikës së Kosovës për të kërkuar drejtësi, duke theksuar se në periudhën 1998–1999 u shkatërruan 1788 monumente të trashëgimisë kulturore, u grabitën mbi 3724 objekte muzeale nga koleksionet publike dhe u shkatërruan 175 biblioteka publike me mbi 1.7 milionë libra. Nga 1788 monumentet e shkatërruara, së paku 500 janë kulla banimi, 218 xhami dhe 11 teqe, 17 kisha katolike, si dhe Muzeu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ai vlerësoi edhe rolin e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke thënë se ka kontribuar me informacione të vlefshme për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore islame dhe se, përgjatë historisë, ka qenë shtyllë e rëndësishme për ruajtjen e vlerave kombëtare, fetare dhe kulturore.

Myftiu i Gorazhdës, Remzija ef. Pitič, tha se mësuesit e vjetër na mësonin se duke hyrë në xhami jemi mysafirë të Zotit dhe aty s'ka vend për biseda, zhurmë apo gjëra të pahijshme, por armiqtë e së vërtetës dhe bukurisë nuk e duruan paqen e xhamive tona. Ai theksoi se shkatërrimi nuk u bë nga individë të dehur apo grupe të rastësishme, por ishte pjesë integrale e politikës së niveleve më të larta, ku morën pjesë intelektualë, politikanë, gazetarë dhe aparati i sigurisë. "Ata nuk e dinë se xhamitë ndërtohen në zemrat tona... Ne dimë si t'i rindërtojmë, sepse kështu ndërtojmë veten dhe kulturën tonë", tha myftiu Pitič.

Përfaqësuesi i Rijasetit të Bashkësisë Islame të Kosovës, dr. Mirsad ef. Kalajxhiq, tha se rrënimi i arkitekturës islame në periudhat 1992–1995 dhe 1998–1999 është vazhdimësi e programit të mëparshëm të kulturocidit mbi myslimanët e Ballkanit dhe të Evropës, sipas të ashtuquajtur "Ligji i Vasijeve" nga gjysma e parë e shekullit XIX, ku u inkurajua dhe u legalizua shkatërrimi i veprave të kulturës myslimane. Ai theksoi se agresioni dhe kulturocidi ishin sulm ndaj qytetërimit botëror dhe gjithë njerëzimit, ndërsa boshnjakët dhe shqiptarët janë dy kombe evropiane me fat të ngjashëm historik, të udhëhequr nga forca e shpirtit dhe vendosmëria



për të jetuar në tokën e tyre, duke kërkuar të vërtetën dhe drejtësinë, pavarësisht presioneve, padrejtësive dhe armiqësive të mëdha.

Drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame në Prishtinë, prof. Sabri ef. Bajgora, autor i fotografive, foli për periudhën kur ishte dëshmitar i zhvillimeve makabre në Kosovë, duke thënë se fushata shkatërrimtare e forcave serbe u zhvillua pa respektuar norma morale, juridike apo ndërkombëtare. Ai tha se, duke parë shkatërrimin në Bosnjë dhe Hercegovinë, ishin të vetëdijshëm se një plojë e ngjashme do të ndodhte edhe në Kosovë; prandaj Kryesia e Bashkësisë Islame, në vitin 1996, vendosi të realizohej fotografimi dhe xhirimi i të gjitha xhamive dhe objekteve të proviniençës islame, që në rast shkatërrimi të ruheshin së paku fotot. Ai foli edhe për vizitat pasluftës për konstatimin e dëmeve, duke përmendur zonat e minuara, mjetet e pashpërthyera brenda objekteve dhe praninë e forcave paramilitare serbe në disa pjesë të Kosovës.

Në fund, prof. Bajgora tha se nga ky material, në vitin 2000, u botua monografia mbi shkatërrimin e xhamive, e përdorur si dëshmi në Gjykatën e Hagës kundër krerëve të shtetit serb. Libri u shpërnda në zyra vendimmarrëse në Evropë e SHBA, si dhe në vendet arabe-islame; ndërsa në vitin 2014, versioni anglisht u botua edhe nga Qeveria e Kosovës dhe u përfshi në fushatën për anëtarësim në UNESCO.

Ekspozita “Kujtesa në fotografi” synon të ruajë të vërtetën historike, të nxisë reflektim dhe të kujtojë pasojat e rënda që shkatërrimi i trashëgimisë kulturore e fetare lë mbi shoqërinë dhe identitetin. Në Bosnjë dhe Hercegovinë u shkatërruan qindra objekte fetare, përfshirë mbi 600 xhami, ndërsa në Kosovë u dëmtuan ose u rrënuan më shumë se 200 xhami, bashkë me medrese, teqe dhe objekte të tjera vakëfnore. Në maj të vitit 2026 ekspozita do të hapet edhe në Sarajevë dhe pritet të shfaqet edhe në vende të ndryshme të botës.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KOORDINATORIN E ZHVILLIMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË, STEPHEN O'MALLEY



Më 11 dhjetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim koordinаторin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, z. Stephen O'Malley.

Myftiu Tërnavë fillimisht e uroi z. O'Malley për detyrën e re, duke i uruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Më pas, Myftiu Tërnavë e njohu z. O'Malley me projektet, aktivitetet dhe rolin shoqëror të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke theksuar angazhimin e institucionit për promovimin e paqes,

solidarititet dhe kontributit në çështjet humanitare.

Nga ana tjetër, z. O'Malley vlerësoi kontributin e BIK-ut në promovimin e paqes, si dhe shprehu gatishmërinë për të thelluar bashkëpunimin në fusha me interes të përbashkët.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E PRISHTINËS, Z. PËRPARIM RAMA



Më 23 dhjetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Prishtinës, z. Përparim Rama. Gjatë këtij takimi u bisedua për bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve, si dhe për mundësinë e thellimit të këtij bashkëpunimi në projekte të përbashkëta për të mirën e qytetarëve.

Myftiu Tërnavë vlerësoi lart rëndësinë e koordinimit institucional në funksion

të përgjithshëm shoqëror, ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe promovimit të vlerave të përbashkëta.

Në kuadër të kësaj vizite, kryetari Rama së bashku me Myftiun Tërnavë, vizituan ekspozitën “Kujtesa në fotografi – xhamitë e shkatërruara në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë gjatë viteve '90, sakralocid i planifikuar”, e organizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës në bashkëpunim me Rijasetin e Bashkësisë Islame të Bosnjë dhe

Hercegovinës, e cila po qëndron e hapur në objektin e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë.

Kjo ekspozitë, përmes fotografive, pasqyron dëshmitë e shkatërrimit sistematik të objekteve fetare islame gjatë luftërave të viteve '90, duke shërbyer si kujtesë historike dhe thirrje për ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ZV.MINISTRIN E VAKËFEVE TË KATARIT, Z. HALID EL GHANIM



Më 8 dhjetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim Tërnavë, priti në takim zëvendësministrin e Vakëfeve të shtetit të Katarit, z. Halid el Ghanim.

Gjatë takimit u diskutua mbi bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve fetare të të dy

vendeve, si dhe mundësitë për projekte të reja në fusha të interesit të përbashkët.

Myftiu Tërnavë falënderoi z. El Ghanim dhe përmes tij edhe shtetin e Katarit për mbështetjen e vazhdueshme të ofruar për Bashkësinë Islame të Kosovës dhe për projekte të ndryshme

humanitare, arsimore e infrastrukturore që janë realizuar ndër vite.

Nga ana e tij, zëvendësministri El Ghanimi shprehu gatishmërinë e Katarit për të thelluar bashkëpunimin dhe për të mbështetur nisma të reja që kontribuojnë në zhvillimin fetar dhe shoqëror në Kosovë.

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT



Më 2 dhjetor 2025, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e saj të rregullt, e cila u zhvillua nën kryesimin e kryetarit të Kryesisë, Myftiut Naim ef. Tërnavë. Mbledhja u karakterizua nga një frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie institucionale, në funksion të planifikimit dhe mbarëvajtjes së aktiviteteve për vitin e ardhshëm.

Gjatë kësaj mbledhjeje, Kryesia shqyrtoi me vëmendje të veçantë projektbuxhetin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës për vitin 2026, si dhe projektbuxhetet e Këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës për të njëjtin vit. Diskutimet u fokusuan në prioritetet strategjike, nevojat institucionale dhe garantimin e një menaxhimi sa më efikas të mjeteve financiare.

Pas leximit të detajuar dhe shqyrtimit të gjithanshëm të këtyre projektbuxheteve, anëtarët e Kryesisë dhanë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre përkatëse. Në përfundim të diskutimeve, Kryesia miratoi në parim projektbuxhetin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës dhe të Këshillave të saj, duke hapur rrugën për procedurat e mëtejme të finalizimit dhe zbatimit të tij në përputhje me rregulloret dhe objektivat institucionale.

MYFTIU TËRNASA PRITI NË TAKIM ZV.GUVERNATORIN E AUTORITETIT TË PËRGJITHSHËM TË VAKËFEVE TË ARABISË SAUDITE



Më 8 dhjetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim zëvendësguvernatorin e Autoritetit të Përgjithshëm të Vakëfeve të Arabisë Saudite, z. Fehd el Maxhid.

Gjatë takimit u diskutua për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit dhe implementimit të projekteve të reja në Kosovë, veçanërisht në fushën e zhvillimit fetar, edukativ dhe humanitar.

Myftiu Tërnavë shprehu mirënjohje për mbështetjen dhe projektet e realizuara deri më tani në vendin tonë nga shteti i Arabisë Saudite, duke vlerësuar kontributin e tyre në avancimin e jetës fetare dhe sociale në Kosovë.

MYFTIU TËRNASA PRITI NË TAKIM DREJTORIN EKZEKUTIV TË MINISTRISË PËR ÇËSHTJE ISLAME, VAKËF DHE ZEKAT TË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE



Më 8 dhjetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim drejtorin ekzekutiv të Ministrisë për Çështje Islame, Vakëf dhe Zekat të Emirateve të Bashkuara Arabe, z. Muhamed el Bolushi.

Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin e ndërsjellë në fushën e

arsimit, humanizmit dhe projekteve infrastrukturore. Myftiu Tërnavë vlerësoi lart kontributin e Emirateve të Bashkuara Arabe ndër vite për institucionet dhe projektet e Bashkësisë Islame të Kosovës, duke theksuar se mbështetja e tyre ka qenë e çmuar për zhvillimin e jetës fetare dhe shoqërore në vend.

Nga ana e tij, drejtori El Bolushi shprehu vullnetin për vazhdimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes në projekte të ardhshme në Kosovë, duke theksuar rëndësinë e lidhjeve vëllazërore që bashkojnë popujt tanë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ZËVENDËSDREJTORIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË VAKËFEVE TË TURQISË

Më 8 dhjetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim zëvendës drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Republikës së Turqisë, z. Hajrullah Çelebi.

Gjatë takimit u diskutua për projektet aktuale dhe të ardhshme në fushën e restaurimit të xhamive dhe objekteve të trashëgimisë islame në Kosovë.

Myftiu Tërnavë vlerësoi kontributin e Turqisë në ruajtjen dhe gjallërimin e

këtij trashëgimi, teksa shprehu gatishmërinë për të avancuar bashkëpunimin në projekte të reja që i shërbejnë komunitetit dhe kulturës fetare në vend.



MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË TAKIMIN E PRIJËSVE FETARË TË FTUAR NGA AMBASADA BRITANIKE NË KOSOVË

Më 10 dhjetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në takimin e prijësve fetar të ftuar nga ambasadori i Britanisë së Madhe, z. Jonathan Hargreaves, takim ky i cili u ftua për ta shënuar përfundimin e fushatës #16DaysOfActivism kundër dhunës me bazë gjinore.

Në këtë takim, përveç Myftiut Naim ef. Tërnavë, morën pjesë edhe prijësit fetarë nga Kisha Katolike, Kisha Ortodokse, Kisha Protestante Ungjillore dhe komuniteti hebre, të cilët së bashku nënshkruan një deklaratë të përbashkët historike kundër dhunës me bazë gjinore dhe dinjitetit njerëzor.

Me nënshkrimin e kësaj deklaratë të përbashkët dhe me ngritjen zë kundër dhunës me bazë gjinore, prijësit fetarë të Kosovës kanë dërguar një mesazh të qartë se, dhuna nuk ka vend në fe, në

familje dhe në shoqëri. Deklarata e përbashkët është një angazhim i shkruar dhe një zotim publik, një premtim për të mbrojtur personat e cenusëm dhe për të sfiduar normat e

dëmshme. Ajo dërgon gjithashtu një mesazh shprese se, prijësit fetarë të Kosovës janë të bashkuar në thënien “mjajt” dhunës me bazë gjinore.



ZV.MINISTRI I VAKËFEVE TË KATARIT, Z. HALID EL GHANIM DHE MYFTIU TËRNAVA VIZITUAN OBJEKTIN VAKËF NË GJILAN DHE SHOQATËN “BEREQETI”

Më 10 dhjetor 2025, zëvendësministri i Vakëfeve të Katarit, i shoqëruar nga Myftiu Naim ef. Tërnavë, vizituan objektin vakëf në qytetin e Gjilanit, një projekt i realizuar falë donacionit të shtetit mik të Katarit. Gjatë vizitës, zv.ministri u njoh nga afër me ecurinë e punimeve dhe progresin e deritanishëm të këtij projekti me rëndësi të madhe për Këshillin e BI-së së Gjilanit.

Myftiu Tërnavë falënderoi zv. ministrin El Ghanim për mbështetjen e çmuar dhe kontributin e vazhdueshëm që Katarit ka dhënë për institucionet islame në Kosovë, duke theksuar se ky investim është një dëshmi e marrëdhënieve të forta miqësore dhe gatishmërisë për të ndihmuar zhvillimin fetar dhe shoqëror në vend.

Pas vizitës në objektin vakëf, delegacioni vizitoi edhe Shoqatën Humanitare “Bereqeti”, ku u pritën nga udhëheqësit e saj dhe u njohën nga afër me aktivitetet humanitare që kjo shoqatë zhvillon në shërbim të familjeve në nevojë. El Ghanimi vlerësoi përkushtimin e kësaj shoqate, duke

shprehur kështu mbështetjen për punën e saj.

Të dy palët u shprehën të kënaqura me projektet e realizuara dhe aktivitetet humanitare që po zhvillohen, duke theksuar rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit në të ardhmen për të mirën e qytetarëve.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E TURQISË, Z. TUNC ANGILI



Më 11 dhjetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, z. Tunc Angili. Gjatë këtij takimi u bisedua për bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe institucioneve fetare dhe shtetërore të Turqisë.

Myftiu Naim ef. Tërnavë shprehu mirënjohjen e tij të thellë për përkrahjen

e vazhdueshme që Republika e Turqisë ka ofruar ndër vite për Bashkësinë Islame të Kosovës, veçanërisht në fushën e restaurimit dhe ruajtjes së objekteve të trashëgimisë islame, si dhe në realizimin e projekteve humanitare me rëndësi për komunitetin.

Nga ana e tij, ambasadori Tunc Angili vlerësoi rolin dhe kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës në avancimin e vlerave të përbashkëta

fetare, kulturore dhe shoqërore, duke theksuar rëndësinë e dialogut dhe bashkëpunimit të ndërsjellë. Ai shprehu gjithashtu gatishmërinë e Republikës së Turqisë për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen, në dobi të interesit të përbashkët dhe forcimit të lidhjeve tradicionale ndërmjet dy vendeve.

U MBAJT KONFERENCA “IHTIJARI DHE ROLI I TIJ NË MENDIMIN JURIDIK ISLAM”

Më 13 dhjetor 2025, nën organizimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar në Tiranë, me rastin e botimit të veprës “El-Ihtijaru li Ta’lili-l-Muhtari”, botim ky që vjen si bashkëpunim ndërmjet Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, u mbajt Konferenca me temë “Ihtijari dhe roli i tij në mendimin juridik islam”.

Në ceremoninë e hapjes ishin të pranishëm Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, kryetari i KMSH-së, Bujar ef. Spahiu, kryetari i BFI-së në RMV, Reisul Ulema Shaqir Fetai, si dhe përfaqësues të tjerë të lartë të tri komuniteteve fetare, studiues, akademikë dhe njohës të jurisprudencës islame nga vendi dhe rajoni.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, vlerësoi botimin në gjuhën shqipe të veprës “El Ihtijar li Ta’lili-l-Muhtâr” si një ngjarje me rëndësi të veçantë shkencore dhe fetare për besimtarët myslimanë të hapësirës shqipfolëse.

“Është kënaqësi të shohim një moment të tillë në Tiranë, ku tri

bashkësitë islame shqiptare realizojnë një botim të përbashkët, një nismë e çmuar që meriton vlerësim dhe vazhdimësi. Le të shërbejë kjo vepër si frymëzim për projekte të tjera shkencore, për përkthime dhe studime të reja, duke na kujtuar se dija është mision dhe trashëgimi që duhet t’u transmetohet brezave me dinjitet dhe përgjegjësi,” – u shpreh Myftiu Tërnavë.

Në fjalën e tij, kryetari i KMSH-së, Bujar ef. Spahiu, theksoi rëndësinë e veprës “El Ihtijar li Ta’lili-l-Muhtâr” si një nga burimet më autoritative të fikhut hanefi, duke vënë në pah vlerën e saj metodologjike, shkencore dhe historike.

“Ky përkthim plotëson një boshllëk shkencor që ka ekzistuar për dekada, duke përbërë një hap të rëndësishëm në forcimin e studimeve juridiko-fetare, zhvillimin e kurrikulave të edukimit islam dhe konsolidimin e identitetit shkencor të myslimanëve në rajon,” – tha kryetari Spahiu.

Ndërsa Reisul Ulema Shaqir ef. Fetai theksoi rëndësinë jetike të bashkëpunimit ndërmjet tre komuniteteve fetare në ruajtjen dhe

përcjelljen e vlerave islame te brezat e rinj dhe studiuesit.

“Ky përkthim është akt strategjik, kulturor, fetar dhe kombëtar, sepse u mundëson brezave të rinj të njohin traditën e tyre fetare në gjuhën amtare. Ihtijari shndërrohet kështu në platformë metodologjike të përbashkët dhe simbol të kohezionit fetar ndërshqiptar,” – u shpreh ai.

Pas fjalëve përshëndetëse, konferenca vijoi me promovimin e veprës përmes kumtesave nga Sabri ef. Bajgora nga Bashkësia Islame e Kosovës, Mafiz ef. Rustemi nga Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Dorian Demetja nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë. Ata theksuan rolin e këtij botimi në forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional, ngritjen e nivelit akademik të studimeve islame dhe lehtësimin e qasjes në burime autentike juridiko-fetare për imamë, studiues dhe studentë.



MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË KONFERENCËN E TRETË BOTËRORE TË KËSHILLIT TË EMIRATEVE PËR FETVANË SHERIATIKE

Më 15 dhjetor 2025, me pjesëmarrjen e personaliteteve të shquara shkencore dhe intelektuale nga vende të ndryshme të botës, në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe, zhvilloi punimet Konferenca e Tretë Botërore e Këshillit të Emirateve për Fetvanë Sheriatike.

Në këtë forum shkencor dhe fetare, Kosovën e përfaqësoi kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili shoqërohej nga shefi i kabinetit të tij, Besim ef. Mehmeti.

Konferenca e organizuar nga Këshilli i Emirateve për Fetvanë Sheriatike, temë boshte pati familjen në kontekstin e fikhut të realitetit: identitetin kombëtar dhe shoqërinë e qëndrueshme, si dhe u zhvillua në kuadër të përpjekjeve për të nxitur kërkimin shkencor dhe për të thelluar shqyrtimin e qasjes juridiko-fetare ndaj familjes, e cila konsiderohet bërthama themelore e shoqërisë.

Përgjatë dy ditëve të Konferencës, morën pjesë mbi 300 studiues profesorë universitarë dhe përfaqësues

nga 57 institucione të ndryshme, përfshirë këtu edhe përfaqësues të ministrive dhe institucioneve që merren me çështjet familjare.

Me këtë Konferencë u synua arritja e disa objektivave kryesore, ndër të cilat përfshihen: përcjellja e përditësimeve legislative në ligjet e statusit personal dhe kuptimi i dimensioneve të tyre kombëtare dhe shoqërore; aktivizimi i mjeteve të ixhtihadit juridik brenda institucioneve të fetvasë për t'u përballur në mënyrë konstruktive me zhvillimet e reja familjare në kontekste të ndryshme; si dhe forcimi i bashkëpunimit institucional ndërmjet Këshillit të Fetvasë dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare që merren me çështjet e familjes.

Po ashtu, Konferenca synoi hartimin e nismave cilësore dhe projekteve novatore që mbrojnë familjen dhe garantojnë stabilitetin e saj, duke theksuar përpjekjet për fuqizimin e institucioneve familjare dhe të fetvasë, si dhe për vendosjen e strategjive që marrin parasysh fikhun e realitetit, me

qëllim ruajtjen e kohezionit familjar dhe unitetit shoqëror.

Programi shkencor i Konferencës përfshiu disa seanca të specializuara, të cilat trajtuan çështjet e familjes në realitetin bashkëkohor, shqyrtuan konceptet dhe metodat e integritit të fikhut të realitetit në sistemin e fetvave familjare, si dhe mënyrat për të arritur stabilitetin familjar të bazuar në dashuri dhe mëshirë, në dritën e zhvillimeve shkencore dhe vlerave moderne njerëzore. Krahas kësaj, u paraqiten edhe opinione bashkëkohore fetare lidhur me këto çështje.

Seancat trajtuan gjithashtu ndikimin e ndryshimeve të përshpejtuara në fushën digjitale dhe të teknologjive të inteligjencës artificiale mbi realitetin e familjes dhe anëtarët e saj, si dhe sfidat dhe mundësitë që burojnë nga këto zhvillime, përfshirë diskutimin e modeleve novatore dhe përvojave globale në fuqizimin e familjes dhe konsolidimin e kohezionit të saj.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA RIJASETI I BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

Më 18 dhjetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një delegacion nga Rijaseti i Bashkësisë Islame të Bosnje dhe Hercegovinës, i kryesuar nga Remzija ef. Pitić, myfti i Gorazhdës.

Gjatë këtij takimi u bisedua për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, me theks të veçantë në zhvillimin e projekteve të përbashkëta me karakter fetar, kulturor dhe edukativ.

Një vëmendje e posaçme iu kushtua bashkëpunimit në organizimin e ekspozitës me fotografi të xhamive të shkatërruara nga agresori serb gjatë luftës së fundit në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Kosovë. Kjo ekspozitë, synon të dokumentojë dhe të kujtojë dëmet e shkaktuara ndaj trashëgimisë fetare dhe kulturore islame, si dhe të sensibilizojë opinionin publik për rëndësinë e ruajtjes së saj.

Myftiu Tërnavë shprehu gatishmërinë e Bashkësisë Islame të Kosovës për

thellimin e bashkëpunimit me Rijasetin e Bosnje dhe Hercegovinës, duke vlerësuar lart marrëdhëniet ndërmjet dy institucioneve.

Nga ana e tij, Myftiu i Gorazhdës, Remzija ef. Pitić, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe përkrahjen, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë në projekte që ruajnë kujtesën historike dhe forcojnë lidhjet ndërmjet komuniteteve islame në rajon.



KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT

Më 20 dhjetor 2025, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e saj të rregullt, e cila u hap dhe u kryesua nga kryetari i Kryesisë, Myftiu Naim ef. Tërnavë. Mbledhja u zhvillua në frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie institucionale, duke pasur për qëllim koordinimin e aktiviteteve dhe planifikimin e proceseve të rëndësishme organizative.

Gjatë kësaj mbledhjeje, anëtarët e Kryesisë diskutuan në mënyrë të detajuar rreth përgatitjeve për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Bashkësisë



Islame të Kosovës, e cila planifikohet të mbahet më 30 dhjetor 2025. Diskutimet u fokusuan në çështjet organizative, rendin e ditës, si dhe në aspektet

procedurale dhe logjistike që lidhen me mbarëvajtjen e kësaj mbledhjeje të rëndësishme.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AFARISTIN URIM HOXHAJ

Më 25 dhjetor 2025, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim afaristin Urim Hoxhaj, i cili shoqërohej nga imami dhe njëherësh kryetari i Unionit të Qendrave Islame Shqiptare në Baden-Württemberg, Muhamet ef. Havolli.

Gjatë këtij takimi u bisedua për çështje me interes të përbashkët, me theks të veçantë në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë

Islame të Kosovës dhe komunitetit shqiptar në diasporë, si dhe për mundësitë e mbështetjes së projekteve fetare, arsimore dhe humanitare në Kosovë.

Myftiu Tërnavë falënderoi z. Hoxhaj për angazhimin dhe kontributin e tij, si dhe për interesimin e vazhdueshëm të mërgatës shqiptare në ruajtjen e identitetit fetar dhe kombëtar. Ai vlerësoi gjithashtu rolin e Unionit të Qendrave Islame Shqiptare në Baden-

Württemberg në organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve fetare dhe kulturore për shqiptarët në Gjermani.

Nga ana e tij, z. Hoxhaj shprehu gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimin me Bashkësinë Islame të Kosovës, duke theksuar rëndësinë e përkrahjes së nismave që kontribuojnë në mirëqenien e shoqërisë dhe në zhvillimin e institucioneve fetare në vend.



DEPARTAMENTI I GRUAS MBAJTI TAKIMIN PËRMBYLLËS ME MUALIME

Më 29 dhjetor 2025, Departamenti i Gruas i Bashkësisë Islame të Kosovës, ka mbajtur takimin përmbyllës me mualime, në të cilin u diskutua dhe u

vlerësua puna njëvjeçare e mualimeve të këtij Departamenti.

Fillimisht, një fjalë përsëritëse para të pranishmeve e mbajti

udhëheqësja e Departamentit, znj. Vaxhide Bunjaku – Podvocira, e cila falënderoi të gjitha mualimet për angazhimin dhe kontributin e tyre që





janë duke dhënë në mbarëvajtjen e procesit mësimor me fëmijët dhe me gratë nëpër xhamitë anekënd Kosovës.

Ajo më pas paraqiti edhe një raport të punës përgjatë një viti, nga ku edhe tregoi për aktivitete e zhvilluara përgjatë vitit, e me këtë rast edhe përgëzoi mualimet për angazhimin dhe suksesin e treguar.

Në këtë takim, i pranishëm qe edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili përgëzoi mualimet e Departamentit për punën e tyre, duke thënë se mbajtja e ligjëratave fetare si dhe angazhimi i vazhdueshëm në mësimin e leximit të Kuranit,

përbëjnë vetëm një dritare të vogël, por domethënëse nga veprimtaria e gjerë dhe kontributi i çmuar i Departamentit të Gruas.

Myftiu Tërnavë, më pas tha se, ndjehet thellësisht i prekur dhe i gëzuar kur sheh nga afër angazhimin serioz të mualimeve. Ai tha se: “Ky përkushtim i sinqertë në përmbushjen e amanetit hyjnor përbën një shembull të lartë të shërbimit fetar dhe një dëshmi e qartë se fjala e Zotit nuk është lënë pas dore, por është përcjellë me kujdes, urtësi dhe dashuri të mesa e gjerë e popullit.”

Gjatë fjalimit të tij, Myftiu Tërnavë, kërkoi nga mualimet që të reflektojnë

mbi përgjegjësinë e madhe që kanë, duke kujtuar kështu mësimet e të Dërguarit të Zotit. Ai tha se: “Pengesat që iu vunë përpara të Dërguarit a.s. ishin të mëdha dhe të dhimbshme. Ai u fye, u maltretua, u la pa ushqim, u godit me gurë, shokët e tij u rrahën, u vranë, u përdoqën dhe u dëbuan nga vatrat e tyre. Megjithatë ai nuk u dorëzua, e me besimin e palëkundur dhe me durimin profetik e çoi misionin deri në fund.”

Në fund, Myftiu Tërnavë, edhe njëherë rikonfirmoi përkrahjen e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame për aktivitetet dhe punën e mbarë të mualimeve.

KUVENDI I BASHKËSISË ISLAME MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT



Më 30 dhjetor 2025, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës, ka mbajtur mbledhjen e rregullt, në të cilën u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Gjatë kësaj mbledhje u shqyrtua dhe u miratua projektbuxheti i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës për vitin kalendarik 2026, me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryetari i Kuvendit, Ajni ef. Sinani, i cili theksoi rëndësinë e bashkëpunimit institucional dhe funksionimit të rregullt të organeve të Bashkësisë Islame në shërbim të besimtarëve.

Gjatë kësaj mbledhjeje u diskutua edhe për gjendjen e përgjithshme të jetës fetare në Kosovë, si dhe për përgatitjet për muajin Ramazan dhe organizimin e Haxhit.

Me këtë rast, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, falënderoi stafin dhe inkurajoi që përgatitjet të jenë në nivelin e duhur edhe për aktivitet e radhës.

Në këtë mbledhje, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës diskutoi po ashtu një sërë pikash të tjera të paraqitura nga anëtarët e Kuvendit.

SEKRETARI SADRIU MORI PJESË NË TAKIMET E PROCESIT TË AKABËS

Më 10 dhjetor 2025, sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, mori pjesë në takimet e Procesit të Akabës, të mbajtura në Jordani, të organizuara nga mbreti Abdullah dhe kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama.

Takimet, të organizuara nga Jordania dhe Shqipëria, me fokus për herë të katërt te vendet e Ballkanit, trajtuan promovimin e dialogut ndërfaqetor dhe theksimin e pikave të përbashkëta me synim forcimin e paqes dhe sigurisë. Ato u ndoqën nga udhëheqës fetarë myslimanë dhe të krishterë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut etj.

Në përfundim, pjesëmarrësit ranë dakord se sfidat e përbashkëta të komuniteteve në Ballkan kërkojnë promovimin e bashkëpunimit, mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë. U theksua se këto vlera duhet të jenë



shtylla themelore për ndërveprim të përgjegjshëm dhe solidar, si dhe për ndërtimin e së ardhmes së popujve të Evropës dhe Lindjes së Mesme.

Konferenca u fokusua në forcimin e dialogut ndërfaqetor, theksimin e vlerave

të përbashkëta dhe ndërtimin e bashkëpunimit për paqe dhe siguri rajonale. Kjo iniciativë synon gjithashtu forcimin e koordinimit dhe shkëmbimin e përvojave në luftën kundër ekstremizmit.



RAPORTI PËRMBLEDHËS PËR VITIN 2025

USHQIM DHE MJETE HIGJIENIKE 31.680 PAKO	MIELL 361.605 KG	MISH KURBANI 2025 224.450 KG	
SHUJTA NGA KUZHINAT HUMANITARE (PEJË-MITROVICË) 165.350 PERSONA	DYQANET SOCIALE PAKO MUJORE 3100 FAMILJE	IFTARET NË TENDËN E RAMAZANIT PALLATI I RINISË PRISHTINË. 9000 KG / MISH	
MEDIKAMENTE 22.405 €	NDIHMA PËR SHËRIM NË PARA TË GATSHME 47.900 €	NDIHMË MUJORE PËR JETIM 2025 300.000 €	NDIHMË PËR JETIMË (PARA TË GATSHME) 13.010 €
SHTËPI TË NDËRTUARA 9 SHTËPI NË NDËRTIM E SIPËR 4	SIGURIM TË TROJEVE 2 × 2.5 ARI	BLERJET TË BANESAVE 3	RENOVIM TË SHTËPIVE 24
PAGESË TË QIRASË MUJORE 23.450 €	PAGESË E RRYMËS FAMILJEVE NEVOJTARE 2658 €	MOBILE SHTËPIAKE 55 FAMILJE	PARA TË GATSHME 69.240 €
BURSA MUJORE PËR STUDENT 6490 €	PAGESA E BILETËS MUJORE PËR NXËNËS 980 €	PRINTER PËR SHKOLLA 18 COPË	QANTA ME MJETE SHKOLLORE 6250 RASTE SOCIALE 150 JETIM, 65 MEDVEGJË
MJETE PËR HENDIKEP 32 KARROCA KLASIKE 6 KARROCA ELEKTRIKE	HAPJE E PUSEVE (BUNARËVE) 89	TEKNIKË E BARDH (FRIGORIFER, LAVATRIQE) 165 COPË	VESHMBATHJE 29.801 PERSONA
BATANIJE 2895 COPË	LËNDË PËR NGROHJE (DRU) 826 M³.	STUFA (SHPORET) 156 COPË	SETE ME ENË KUZHINE 2120 FAMILJE
APARATA ELEKTRIKE SHTËPIAKE (SHKOLLAT, QERDHET ETJ.) 925 INSTITUCIONE	SHTËPIAT E TË MOSHUARVE (SETE ME VESHJE DIMRI) 159 PERSONA	INSTITUTI SPECIAL I DHE II SHTIME (VESHJE DIMRI DHE JORGAN) 124 PERSONA	BUJANOC - MEDVEGJË BAJRAM CURR (SETE RROBASH DIMRI) 455 NXËNËS
SETE RROBASH PËR TË BURGOSURIT (GJILAN, PRIZREN, LIPJAN, SMREKONICË, HAJVALI, DYZ DHE DUBRAVË) 350 PERSONA	TEPIHA 553 COPË	AKIKA (KURBANA) 323 KRERË DELE	IFTARE 31.310 PERSONA
HURMA 25.000 KG	BUKË TË GATSHME 79,070 COPË	ËMBËLSIRA - TORTE 2310 COPË	DHURATA PËR FESTA 33.860 COPË
PATATE 33,005 KG	FASULE 26.000 KG	QEPË 22.750 KG	PULA 475 COPË

Projekti i vitit: Dyqanet Sociale në Drenas dhe Fushë Kosovë

Ky sukses u arrit në bashkëpunim me organizatat, bizneset, diasporën dhe bëmirësit brenda dhe jashtë vendit.

OJQ SHOOQATA Bereqeti | Banka Ekonomike Sh.a
IBAN: XK05 1401000000813233
SWIFT Code (BIC): EKOMXKPRXX

DITURIA ISLAME • Nr. 422 | JANAR 2026